JOHAN V.

# GËTE



# Kënga e udhëtarit në shtrëngatë

■

*poezi të zgjedhura*

BOTIMET TOENA

821.112.2-1 GOE

GËTE

# Kënga e udhëtarit në shtrëngatë

*Poezi të zgjedhura*

Shqipëroi nga origjinali
*Perikli JORGONI*

BIBLIOTEKA "NIVZI SULEJMANI"
PRISHTINË-PRIŠTINA
Sektori, dega
Nr. 18362-30

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2003

Titulli i origjinalit: Goethes Werke (GEDICHTE) Meyers Klassiker - Ausgaben herausgegeben von Prof. Dr. Ernst Elfter

Botues: Fatmir Toçi
Përkujdesja grafike: Lavdie Cenmurati
Kopertina: Irena Toçi
ISBN 99927 - 1 - 684 - 3

BOTIMET TOENA
Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, Tiranë
Tel.: (355) (4) 240116; 240117
Tel./Fax: (355) (4) 240117
E-mail: toena@icc.al.eu.org
Http://www.toena.com.al

# *Parathënie*

Mbi mermerin klasik të veprës monumentale të Gëtes poezitë janë lule të gjalla, të shumëngjyrshme dhe plot aromë. Ato kanë aromën dhe ngjyrat e jetës, se lindin nga ngjarje të jetuara dhe gjithmonë pasqyrojnë shqetësimet e mëdha të poetit, se – ndoshta jo në mënyrë aq të hapur sa në lirikat e Shilerit, po prapë me forcë – në to ndihet fryma e kohës që i krijoi.

Në të vërtetë, nga fushat e shumta, në të cilat u derdh si ujëvarë e rrëmbyeshme dhe e pashtershme talenti i Gëtes, poezia është më e afërta për shpirtin e tij.

Jo më kot kryevepra e tij, "*Fausti*", e cila që dramë, gjeti shprehje në një formë poetike.

Poezia qe bashkudhëtarja e përhershme e Gëtes, që nga rinia e parë deri në pleqëri të vonë, ajo u ushqye me gjakun e zemrës së tij, me vetë jetën e tij dhe e rrezatoi nga ana tjetër këtë jetë me dritë.

Është shumë e vështirë ta mbyllësh këtë poezi të vrullshme, të larmishme, proteiforme, brenda kornizash të caktuara zhanresh e llojesh; poezi lirike, poezi epike, filozofike, lirika intime, lirika të peizazhit, këngë, balada, elegji, himne, ode, sonete.

Lirizmi dhe epizmi ndërthuren dhe shpeshherë shkrihen. Tema "e madhe" dhe tema "e vogël" depërtojnë gjithnjë te njëra-tjetra. Për një poet të madh, s'ka temë "të vogël", një mjeshtër derdh në çdo temë një problematikë të rëndësishme ku njeriu nuk mund të ndahet në mënyrë metafizike nga qytetari.

Do të përpiqemi ta analizojmë këtë poezi të shumanshme duke pasur parasysh se, si thoshte vetë poeti, bukuria nuk mund të mbyllet në asnjë përkufizim, do të ishte si "të kapësh një flutur dhe ta shposh

me gjilpërë për vëzhguesin kureshtar; insekti i shkretë përpëlitet në rrjetë dhe i humbet ngjyrat e veta të mahnitshme; më në fund mbetet i ngrirë... mungon pjesa thelbësore: jeta, fryma që zbukuron gjithçka". Pra, e bukura nuk mund të kapet në thelbin e saj.

Poezia e Gëtes është e larmishme si nga problematika, ashtu edhe nga format shprehëse. Harmonia midis brendisë dhe formës i dallon poezitë më të bukura të Gëtes si çdo kryevepër; në këto poezi janë shkrirë poeti spontan, mendimtari dhe artisti i formës.

Poeti spontan: Ky poet filozof, ky adhurues i formës është njëkohësisht një poet spontan që niset nga një frymëzim i fuqishëm dhe i gjallë dhe është me të vërtetë e çuditshme se si kjo lavë e zjarrtë frymëzimi derdhet në forma të përsosura, ku çdo temë, çdo motiv gjen formën e vet.

Dhe poezia e Gëtes si një poemë e fuqishme i fundoste thellë rrënjët në realitetin e kohës duke u ushqyer prej tij. Vetë poeti shprehej kështu: *"Të gjitha vjershat e mia janë nisur nga raste të caktuara: realiteti është ai që i ka frymëzuar, aty e kanë bazën, aty marrin ushqim. Nuk kam krijuar kurrë poezi në erë".*

Dhe ky poet gjenial ishte po aq i aftë të kërkonte poezinë në të zakonshmen *("Aftësia e poetit tregohet këtu: të kapë anën interesante, poetike edhe te subjektet më të zakonshme.")* sa edhe të matej me temat e mëdha të kohës së vet.

Një nga këto tema ishte kryengritja kundër botës së vjetër, kundër rendit feudal që po dekompozohej dhe, me kalbëzimin e vet, helmonte tërë atmosferën e shoqërisë gjermane të atëhershme. Paralelisht me këtë temë që shprehte një problem tepër aktual, ishte tema e çlirimit politiko-shoqëror dhe etik të njeriut, e afirmimit të gjithanshëm të mundësive të tij.

Afirmimi i gjithanshëm i mundësive të njeriut ka qenë gjithnjë një ideal i parealizueshëm në shoqërinë e ndarë në klasa. Po çdo klasë, atëhere kur ka luajtur rol përparimtar, ka synuar drejt këtij ideali. Miti i Prometeut kishte shtegtuar ndër shekuj duke ardhur nga lashtësia si mesazh rebelimi kundër tiranëve.

Në një kohë më afër Gëtes e rimerr këtë motiv anglezi Shefterbëri duke e identifikuar Prometeun me poetin, që është sipas tij, krijues i dytë pas hyjnisë. Si simbol të gjeniut që rrëmben shkëndinë hyjnore, figura e Prometeut kishte hyrë edhe në letërsinë gjermane, në mënyrë të veçantë, ky konceptim ishte përgjithësuar nga Herderi në *"Fragmentet mbi letërsinë e re gjermane"* të 1767-ës.

Te Gëtja figura e Prometeut kuptohet në një mënyrë më të avancuar: Prometeu nuk është më i ngjashëm me hyjninë, po është i pavarur, krijon me forcat e veta, madje qëndron më lart se hyjnitë e pafuqishme, simbole të tiranisë.

Prometeu i Gëtes është dyfish kryengritës, në kuptimin filozofik dhe në kuptimin shoqëror-politik: mohon hyjninë e fesë për të pohuar natyrën (konceptimi panteist i Gëtes për botën që ai e ka thithur nga Spinoza dhe është i afërt me materializmin), mohon tiranët, mbretërit dhe feudalët, për të pohuar lirinë e njeriut, e njeriut që punon dhe krijon, që e farkëton lumturinë me duart e veta, e njeriut që e zhvillon vetveten në mundësitë e pakufishme që ka për t'u përsosur vazhdimisht.

Me këtë poezi Gëtja prekte një nga majat e poezisë së vet, të poezisë gjermane bashkëkohëse dhe madje të poezisë botërore.

Në Gjermaninë e kohës së Gëtes vihej re një dukuri paradoksale: realitet tepër i varfër gjerman ku shprehësit e tendencave më përparimtare nuk gjenin një klasë që t'i mbështeste (se borgjezia gjemane, së cilës i takonte në atë kohë kjo detyrë, ishte tepër e dobët dhe e lëkundur) i kishte dhënë jetë një poezie tepër të pasur, tepër të fuqishme, madje ndoshta më e pasur dhe e fuqishme se letërsia e vendeve të tjera në Evropën e atëhershme.

Gëtja qe në krye të lëvizjes letrare dhe ideologjike "*Sturm und Drang*" (Stuhi dhe vrull) shprehte aspiratat e rinisë përparimtare gjermane.

Dhe "*Prometeu*" qe himni më i fuqishëm i kësaj lëvizjeje dhe shprehja më e qartë e iluminizmit gjerman që vihej kështu në pararojë të betejës për progres, jo vetëm në atdhe, po edhe në Evropë.

Nëpërmjet *"Prometeut"* poholeshin parimet e lirisë dhe të barazisë: liria pohohet si një e drejtë e natyrshme e njeriut, jo vetëm e njeriut të jashtëzakonshëm, gjeniut, po edhe e njeriut të zakonshëm. Dhe është tepër kuptimplotë se kjo liri lidhet me veprimtarinë praktike. Gëtja ngre lart kultin e veprimit, kult iluminist dhe humanist, po edhe kult që e dallon çdo lëvizje përparimtare, çdo synim ndaj së resë. Ai u kundërvihet kështu spekulimeve të zbrazëta teorike të filozofisë të kohës. Dhe te figura titanike e Prometeut ne parandiejmë Faustin, mishërimin më të madhërishëm të këtij kulti të veprimit.

Kryevepër mendimi, *"Prometeu"* është edhe kryevepër arti. Për mendime kaq të lira, kaq të fuqishme, për një shpërthim të tillë kolosal idesh dhe ndjenjash, për të vizatuar një hero lirik me përmasa kaq vigane, duhej krijuar një formë e re. Dhe lind një varg që i ngjan vargut të lirë, me ritëm dinamik, të shqetësuar, që herë ngrihet, herë bie, ashtu, si ngrihet edhe mendimi në majat më të larta për t'u kthyer pastaj në realitetin e zakonshëm, ashtu si ngrihen e zëvendësojnë njëra-tjetrën dallgët e krenarisë, të revoltës, të urrejtjes, të dashurisë. Dhe fjalët zotërojnë një potencial të madh shprehës: aty mbizotërojnë emrat konkretë dhe epitetet lapidare, po edhe foljet kanë një ngarkesë të madhe emocionale. Shkurtësia maksimale e disa vargjeve nënvizon karakterin e prerë të mendimit.

Gëtja besonte në aftësitë e pakufishme të mendjes njerëzore për të kapur dijen, në aftësitë e pakufishme të njeriut për të krijuar dhe për të përsosur vetveten. Jetën ai e koncepton si një ecje gjithnjë përpara (*"nuk duhet të **jemi** kurrë, po duhet të duam të **bëhemi** gjithçka dhe mbi të gjitha nuk duhet të ndalemi kurrë"*- shkruante ai në një letër), po edhe lumturinë e koncepton si një proces të pafund krijimi dhe zhvillimi (mishërimin më të lartë të këtij mendimi e gjejmë te *"Fausti"* ku pohohet edhe pakënaqësia e përhershme e njeriut, po edhe mundësia e lumturisë kur kjo pakënaqësi shndërrohet në veprim).

Të gjitha këto ide i gjejmë në embrion te *"Prometeu"*.

Si poet gjenial Gëtja shtron për herë të parë probleme dhe konflikte që do të shqetësojnë një shekull të tërë: konfliktin e individit me botë tepër të gjerë, me mjedisin tepër të ngushtë e të varfër, konfliktin e të shtypurve me sunduesit, konfliktin e idealit me realitetin.

Te "*Prometeu*" mbizotërojnë thekset e sfidës dhe të krenarisë, thekset e besimit te njeriu. Vetë Gëtja ishte i vetëdijshëm për karakterin tepër të avancuar, madje revolucionar të Prometeut të tij. Ai vetë shkruan në një letër që ky dorëshkrim "do të pritet me kënaqësi si një ungjill nga rinia jonë revolucionare".

Te "*Ganimedi*", e po kësaj kohe, pohohet aftësia e mrekullueshme e njeriut për të rrokur në vetvete tërë botën. Kjo vjershë tërë tinguj e ngjyra pohon shkrirjen e njeriut me natyrën që nuk është një arratisje rusoiane nga bota apo një apoteozë e forcës së shpirtit njerëzor, e mprehtësisë së mendjes njerëzore. Shkrirja e njeriut me natyrën përshkruhet me një ngazëllim dehës që shpreh optimizmin e Gëtes. Po realiteti i kohës nuk i jep mundësi personalitetit njerëzor të shpaloset me tërë begatinë e vetive të veta dhe prandaj në poezinë e Gëtes depërtojnë motivet e dhimbjes dhe të tragjizmit. Po pesimizmi i pashpresë është i huaj për të.

Mendimi i Gëtes për marrëdhëniet e njeriut me botën evoluon. Në qoftë se te "*Ganimedi*" pohohej se njeriu është i madh, se arrin ta kuptojë natyrën dhe të shkrihet me të, te "*E hyjnueshmja*', njeriu vihet më lart se natyra në sajë të vetive të tij intelektuale dhe morale dhe pohohet një ideal fisnik, përsosmëria morale, drejt të cilit duhet të synojë njeriu.

Te "*Kushtim*" himnizohet roli i poetit, po edhe preket problemi i marrëdhënieve të individit me kolektivin, të cilin e kemi ndeshur që te "*Prometeu*". Edhe heroi lirik i "*Kushtimit*", vetë Gëtja, po edhe në përgjithësi poeti krijues, flamurtari i një ideali, pohon: "*Kërkova rrugën me aq dashuri/ dhe mos t'ua them vëllezve të mi?!*" Këtu ndihet dëshira e Gëtes për të qenë një poet qytetar, për të gjetur mbështetje, bashkëluftëtarë. Po pikërisht këtu qëndron edhe drama

e Gëtes, dramë që ai e shprehu përmes heronjsh tragjikë si Verteri dhe Tasoja, para të cilëve shtrohet dilema për të mohuar me krenari realitetin, po duke asgjësuar edhe vetveten si Verteri ose për t'u pajtuar me të duke rënë moralisht si Tasoja. Dy zgjidhje njësoj të tmerrshme, njësoj tragjike, po rruga që përbënte vërtet idealin e Gëtes, rruga e Prometeut dhe e Faustit, presupozonte bashkëluftëtarë. Prandaj edhe Gëtja zgjedh në jetën praktike rrugën e Tasos, po në krijimtari i mbetet besnik rrugës së Prometeut dhe Faustit, ndonëse me zigzage e lëkundje. Prandaj ai, ndonëse kishte në vetvete forca të pashtershme dhe besim në jetën, nuk mundi kurrë të jetë i lumtur si i pohon vetë Ekermanit në periudhën e fundit të jetës; ai njohu vetëm momente, në të cilat lumturia e ëndërruar i afrohej si një vegim.

Ai vë re, përreth vetes, jo vetëm mjedisin mbytës, filistin, po edhe mjerimin e popullit, para të cilit ndihet i pafuqishëm si i shprehet në një letër Karlota fon Shtajnit *"Pse njeriu mund të bëjë... aq pak për të tjerët!"*

Para gjashtë vjetëve, më 1766 ai i kishte shkruar Lavaterit: *"Unë jam duke lundruar në dallgën e botës... i vendosur për të zbuluar, për të fituar, për të luftuar, për të dështuar apo për ta hedhur veten në erë"*. Ai aspiron pra për një jetë të plotë, për një jetë me luftë, po nuk i jepet mundësia për një luftë të qartë dhe konskekuente për zgjidhjen e problemeve që e shqetësojnë.

Prandaj edhe poezia e tij ka kontradikta dhe njeh disa faza. Në të gjitha këto faza ekzistojnë disa vatra qendrore: liria, dashuria, natyra. Edhe Gëtja njeh një fazë – në rininë e parë – kur ende s'e ka gjetur vetveten – në fillim shprehet me retorizëm, pastaj ndikohet, si edhe poetë të tjerë të kohës, nga poezia e Anakreontit. - Kjo gjë përbënte një hap përpara, se kjo poezi dallohej nga natyrshmëria; nga ana tjetër gjeniu i ardhshëm ia vuri vulën e vet vetjake edhe kësaj poezie; ai prekte vërtet motivet që ishin në modë, përvetësonte disa veçori stili që ishin të përhapura, po nuk diktoheshin nga nevoja e brendshme e individualitetit të tij krijues, veçse në lirikat e kësaj kohe shpërthente papritur çiltërsia e ndjenjës ashtu si ndodhte në

lirikat kushtuar vajzës së thjeshtë të popullit, Anetë Shënpkofit. Temat trajtohen ende në mënyrë të sipërfaqshme, duke iu dhënë rëndësi gjetjeve formale – po befas ndonjë imtësi (plastike ose emocionale) – të bën të parandjesh poetin e madh të ardhshëm. Veç kësaj edhe në këtë kohë poeti i ri nuk niset nga trillimet e zbrazëta të fantazisë, po nga jeta, veçse zhgënjimet psikologjike që burojnë nga përvoja jetësore humbasin në mes meditimesh të kërkuara ose patosi emocional tretet në tonin hokatar e të lehtë.

Megjithatë ndonjë vjershë shquhet nga të tjerat. Te vjersha *"Nata e bukur"* ka tablo të natyrës që shquhen për një plasticitet të çuditshëm, kontraste tërë dritë dhe hije, dhe nuanca tepër delikate që paralajmërojnë poetin – mjeshtër të peizazhit.

Më vonë ndeshja me poezinë popullore gjermane – që ishte për Gëten një ideal konkretësie e thjeshtësie – e ndihmon të zbulojë individualitetin e vet krijues. Ndikimi nga folklori gjerman qe shkëndija që i dha zjarr talentit të Gëtes. Lirika popullore e dashurisë do të frymëzojë lirikat e tij erotike më të bukura dhe më vonë baladat.

Tani tema e dashurisë merr përmasat e veta të vërteta në krijimtarinë e Gëtes, si një temë jo "e vogël", jo ngushtësisht intime, por si një pjesë e pandarë e shqetësimeve, ku shpreh mendimet filozofike dhe shoqërore. Ndjenja e dashurisë te Gëtja konceptohet si forcë e madhe jetësore, si burim gëzimi dhe energjie, ndonëse nuk mohohet dhimbja njerëzore e ndarjes, e dashurisë pa përgjigje, po kjo dhimbje nuk çon në mohim të jetës, të gëzimit, të vlerave të jetës. Dashuria më se një herë u kundërvihet paragjykimeve shoqërore dhe fetare, si edhe asketizmit. Në disa vjersha forca e ndjenjës nuk i përshtatet formës tepër fluide, po në të tjera harmonia e brendisë me formën është e përsosur. Te vjersha si *"Këngë maji"*, *"Pranverë e parakohshme"*, *"Kristja"* ngazëllimi i dashurisë derdhet si një verë shkumëzuese. Ritmi dhe figura në këto vjersha i ngjajnë një kupe kristali përmes së cilës shkëlqen lëngu i zjarrtë. Te *"Këngë maji"* vargjet e shkurtra, dinamike sikur ndjekin ritmin e një valleje. Te *"Kristja"* dashuria konceptohet në mënyrë tepër të shendetshme si

aspekt i gëzuar i jetës dhe ndihet njëkohësisht koloriti kombëtar. Dallgëzimet e pasionit shkrihen me tablotë konkrete, portreti i vajzës me përshkrimin e gjallë e dinamik të valles.

Gëtja në përshkrimin e dashurisë është realist dhe tokësor, andaj edhe nuk i trembet përshkrimit të realizimit të dashurisë, përshkrim që nuk humbet edhe pse me nota sensualizmi të tepruar (*"Nata e parë"*). Dhe ky poet i pasioneve të vrullshme, që e do dashurinë tokësore dhe konkrete, është i aftë dhe për ndjenja delikate. Kështu te *"Vizita"* heroi lirik e sodit të dashurën në gjumë duke u mahnitur me bukurinë dhe pafajësinë e saj, pa guxuar ta prekë, vetëm duke i lënë disa dhurata të thjeshta. Idenë e kësaj vjershe Gëtja do ta zhvillojë në episodin e njohur të Faustit që hyn në dhomën e Margaritës.

Poeti trajton pothuasje tërë gamën e ndjenjave që zgjon dashuria: pritjen e takimit, vetë gazin e takimit, dhimbjen e ndarjes së përkohshme, ose të përhershme, vuajtjet e dashurisë pa përgjigje, xhelozinë, dhembshurinë, pasionin e flaktë. Lirizmi merr herë tone të vrullshme, të ngazëllyera ose tërë dhimbje, herë tone meditative, të buta e delikate, herë tone gazmore dhe hokatare.

Në poezi herë mbizotëron imtësia, herë figura, herë shkrihen të dyja. Te *"Ankime mëngjesi"* pritja e ankthshme e djalit shoqërohet me imtësi konkrete. Po poeti ka gjithmonë respekt për ndjenjën dhe për gruan e dashuruar, e cila përbën për të një ideal bukurie dhe lumtuie, po është kurdoherë edhe një qenie konkrete me mish e me gjak dhe madje me dobësitë e saj, si Lizeta e vjershës *"Me një gjerdan të artë"* apo vajza lozonjare e vjershës *"Ankime mëngjesi"* ose edhe vetë Lili te vjersha *"Parku i Lilit"*, që i kushtohet Lili Shënemanit.

Ka edhe vjersha, në të cilat poeti e vështron gruan që dashuron si shoqe të mendimeve e të ndjenjave (Sharlota fon Shtajn):

*Ti ma di gjithçka që mbaj përbrenda*
*Dhe përgjon si dridhet, ah, çdo rremb,*
*Me një sy kupton se ç'më fsheh zemra,*
*Duke hyrë në çdo pllajë e kënd,*

*Dhe ma rregullon ecjen në jetë,*
*Gjakun plot rrëmbim ma qetëson*
*Ndiej si ndrit çdo ndjenjë brenda meje,*
*Më fal vrull e prush që më gjallon.*

Pra, nga kulti i gruas në vështrimin e saj si shoqe dhe madje këshilluese e urtë: një konceptim i ri i gruas, tek e cila nuk nënvizohet më bukuria e jashtme, po bukuria e brendshme. Dashuria nuk është më vetëm forcë jetësore dhe burim gëzimi, po edhe një forcë e madhe fisnikëruese.

"*Elegjitë romane*" shënojnë një faqe të veçantë në lirikën e Gëtes. Udhëtimi në Itali bëhet shkak për një rilindje të ndjenjës poetike. Në të vërtetë realiteti prozaik i Vajmarit si një kënetë, synonte t'ia fundoste poezinë, t'ia mbyste atë. Poeti u përpoq të gjente një rrugëdalje në afrimin me idealin e "bukurisë së kulluar" të antikitetit dhe me bukuritë e natyrës. Dhe vajtja në Itali ia rizgjoi ndjenjat poetike. Fryt i këtij rizgjimi qenë "Elegjitë romane", në të cilat Gëtja ndikohet nga poezia e lashtë latine, po duke shprehur gjithnjë individualitetin e vet krijues të fuqishëm, të pakrahasueshëm e të papërsëritshëm. "Elegjitë romane" i përkasin periudhës së të ashtuquajturit klasicizëm të Gëtes, që do t'u jepte edhe tragjedive "*Ifigjenia në Tauridë*" e "*Torkuato Taso*".

Gëtja shkruan me entuziazëm, në një letër të kësaj kohe, se e gjeti përsëri vetveten si artist. Megjithatë poeti e ndjente se tani e tutje për të do të kishte një shpërpjesëtim midis krijimtarisë së tij dhe realitetit.

"*Ajo që është thelbësore* – shkruan me mprehtësi Franc Mehringu,- *është të bësh pyetjen nëse kultura estetike e kulluar, me të cilën Gëtja u mor në mënyrë absolute pas kthimit të vet nga Italia ka qenë synimi i vërtetë i jetës së tij apo nëse ai u kufizua me këtë pas një përvoje të dhimbshme, meqë iu mohua ajo që ai kishte synuar me zjarr në vitet e veta më të mira, domethënë të ishte një njeri që jeton te populli i vet dhe me popullin e vet.*"

Te Gëtja nën ndikimin e mjedisit mbytës pati kontradikta, lëkundje: te ai janë përleshur gjithmonë humanisti dhe poeti i madh me filistinin gjerman. Udhëtimi në Itali, vetëm sa i thelloi më tepër këto kontradikta tragjike në personalitetin e Gëtes dhe në qëndrimin e tij ndaj shoqërisë gjermane të kohës, që Engelsi e përkufizon aq qartë e në mënyrë lapidare, kur e quan "të dyfishtë" dhe pohon se poeti "ngrihet kundër saj,... e mbulon me përqeshjet e hidhura... ose... miqësohet me të, pajtohet, me të." Poeti u mundua të gjente në sferën e artit atë që nuk e gjente në realitet dhe për disa momente besoi se e gjeti. "*Elegjitë romane*" janë një himn i dashurisë së realizuar, konkrete dhe tokësore dhe njëkohësisht një himn për atë bukuri të kulluar që Gëtja shihte në artin e antikitetit. Po ajo bukuri nuk mund të ringjallej, vetëm mund të evokohej për një çast shumë të shkurtër nga poeti për t'u zhdukur mandej si Elena e evokuar nga Faust në kryeveprën e Gëtes.

Për nga vlera artistike "*Elegjitë romane*" qëndrojnë lart.

Brendia – himnizimi i së bukurës në jetë dhe në art dhe himnizimi i ndjenjës së dashurisë nëpërmjet prizmit të artë të së cilës shihet realiteti – ka gjetur formën e vet të përshtatshme. Këto krijime janë të pasura në imtësi konkrete. Çdo gjë emërohet në mënyrë të saktë e lapidare. Figura e së dashurës – Faustinës – për të cilën poeti u frymëzua ndofta nga një e dashur italiane, po edhe nga vajza e popullit Kristiana Vulpius, e cila do të bëhej shoqja e tij e jetës – është vërtet mishërimi i një ideali (ideali i dikurshëm i bukurisë fizike dhe i gëzimit të jetës, të mishëruara te gruaja që rikthehet në një formë të re), po edhe një figurë e gjallë dhe njerëzore. Tek "*Elegjitë romane*" ndihet një konceptim disi epikurian i jetës. Poeti e ndien se kjo lumturi e sapogjetur është e përkohshme dhe megjithatë dëshiron ta përjetësojë.

Pasione të trazuara i përshkojnë përkundrazi vjershat e "*Divanit*" (1817-1820). Romantika e shpirtit të poetit ka çarë digën artificiale të klasicizmit.

Ndoshta kryevepra e lirikës erotike të Gëtes është e famshmja "Elegji e Mariembadit" që poeti i shkuar në moshë shkruante për

vajzën e re Ulrika fon Levecofin. Në këtë vjershë pasqyrimi dialektik i dashurisë arrin kulmin: vargu i shtrirë dhe tepër melodioz ndjek ritmin e stuhishëm të ndjenjave të kundërta: dashuri e thellë edhe në se nuk e ka zjarrin e rinisë: shpresë, dhimbje, dëshpërim. Tepër kuptimplotë është figura e zgjedhur për takimin "trëndafil që s'çeli".

Gëtja diti të japë me penën e vet të fuqishme edhe ndjenjat e një vajze të dashuruar. Te "*Minjoni*" shkrihet dashuria e druajtur e vajzës ende fëmijë, që edhe nuk di të dallojë pasionin nga ndjenja e bijës ndaj atit, me dashurinë për vendin e lindjes, që jepet me ngjyra të gjalla e mishëron edhe idealin e Gëtes për Italinë si vend i poezisë. Te "*Tjerrësja*" nën tonin hokatar fshihet drama e vajzës së gënjyer. Ndërsa te "*Para gjyqit*" sfidohen hapur paragjykimet e kohës nëpërmjet fjalëve të vashës së re që do të lindë një fëmijë të paligjshëm. Ajo mbron pastërtinë e ndjenjës, ndershmërinë e saj duke shprehur kështu mendimin e avancuar të poetit se marrëdhëniet midis burrit dhe gruas i bën të moralshme dashuria dhe jo formalitetet zyrtare. Kjo figurë vajze paralajmëron dramën e Margaritës në "Faustin" që, e ëmbël, e thjeshtë, vetëmohuese, e aftë për një dashuri të thellë e të pastër, shndërrohet nga realiteti i tmerrshëm i kohës në vrasëse të fëmijës së vet dhe mbaron tragjikisht në çmenduri e në vdekje. Po heroina e vjershës "Para gjyqit" qëndron më lart se Gretheni e "*Faustit*" se di jo vetëm të dashurojë me gjithë shpirt, po edhe të sfidojë në mënyrë të ndërgjegjshme paragjykimet në emër të ndjenjave si grua dhe si nënë. Presioni i përfaqësuesve të së vjetrës (kryetari i gjyqit, prifti) nuk e bën as të pranojë të poshtërojë veten si mëkatare, as të padisë të dashurin, as të përpiqet të zhdukë fëmijën që është krijesë dhe fryt i dashurisë së saj. Pra konflikti i saj me shoqërinë është vetëm i jashtëm, ndërsa Margaritës i duhet të ndeshet jo vetëm me përfaqësuesit e filistinizmit, po edhe me paragjykimet që mjedisi i ka rrënjosur në ndërgjegje.

Pozita tepër e vështirë e gruas që gjendej nën pushtetin patriarkal të burrit ose të njerëzve të saj, pasqyrohet me forcë tronditëse edhe në vjershën e frymëzuar nga poezia popullore "*Këngë vajtimi e gruas*

*fisnike të Hasan Agait*". Në këtë vjershë gruaja braktiset pa asnjë faj nga i shoqi, trajtohet nga i vëllai si plaçkë, ai mund ta martojë me kë të dojë, pa pyetur fare për ndjenjat e saj. Tërë vjersha është një luftë e kësaj gruaje për të mbrojtur të drejtën e vet si bashkëshorte e si nënë, po një luftë pasive se mjedisi nuk i jep mundësi për luftë tjetër. Dhe mbarimi i saj tragjik është një akuzë kundër realitetit tragjik.

Lirizmi i Gëtes tani është shkrirë me momente epizmi ose me vetë parimin epik.

Te baladat shkrihen në mënyrë origjinale epizmi, dramatizmi dhe lirizmi. Elementi fantastik te Gëtja është gjithnjë funksional, ka gjithnjë një përmbajtje njerëzore. Më e fuqishmja e tyre është "*E fejuara prej Korinti*", në të cilën Gëtja ka derdhur urrejtjen e vet për asketizmin, për paragjykimet fetare që mohojnë ndjenjat e gjalla, gëzimet e jetës. Subjekti është rrëqethës: vajza, e mbyllur në manastir pa dashjen e saj dhe e vdekur në lulen e rinisë ngrihet nga varri për të afirmuar të drejtën e vet për jetë dhe për dashuri. Po ajo është tashmë një fantazmë që nuk mund të dashurojë më si njeri i gjallë, mund vetëm ta tërheqë në vdekje djalin që dashuron dhe që i përgjigjet.

Veprimi zhvillohet me natyrshmëri dhe me tension dramatik duke arritur kulmin me tragjicitetin e fundit. Fjalët e vajzës së re janë një akuzë e tmerrshme kundër obskurantizmit e fanatizmit dhe një pohim i së drejtës për liri dhe për jetë. Tronditëse është edhe "*Perëndia dhe bajadera*" ku dashuria jepet si forcë fisnikëruese dhe rigjeneruese. Dashuria e thellë dhe vetëmohimi që rrjedh prej kësaj dashurie e ringjallin moralisht gruan e zhytur në vese (këtu është riti fetar që e shndërron gruan e re në plaçkë). Fundi fizik i gruas shënon rilindjen e saj morale, prandaj tragjizmi gjen këtu një katarsis nëpërmjet madhështisë së ndjenjës. Elementi fantastik, rilindja nga flaka e djalit që mban në krahë të dashurën – shpreh simbolikisht rilindjen morale të saj dhe shpërblimin për vetëmohimin e saj që jep jetën për të ndjekur pas njeriun e dashur.

Besnikëria në dashuri si dhe besnikëria deri në fund, në përgjithësi, himnizohet përmes baladës "*Mbreti i Tulës*" që dallohet nga mbizotërimi i elementit lirik dhe melodioziteti.

"*Këngëtari*" është një himnizim i lirisë së poetit që konceptohet si i pavarur prej të fuqishmëve dhe prej pushtetit të parasë, pavarësi që i vjen nga epërsia e tij morale. Këtu ndihet idealizimi romantik i misionit të poetit, po edhe koncepti i lartë i Gëtes për artin ku tema e vjershës afrohet me motivet e rinisë së tij.

Te "*Gërmuesi i thesarit*" pohohet - kësaj radhe me optimizëm – dashuria për jetën dhe për gëzimet e saj.

Në baladën "*Djali i pabesë*", rikthehet motivi i ngritjes nga varri dhe ka një ngjashmëri me baladën e njohur të Byrgerit "*Lenore*", po ngjashmëria qëndron thjesht në motivin, se te Byrgeri ideja është: mbrojtja e fesë përballë dashurisë së një vajze që mallkon hyjninë, e cila i mori të dashurin, ndërsa te Gëtja dënohet qëndrimi mendjelehtë ndaj dashurisë i djalit, dhe mbrohet ndjenja e sinqertë e vajzës. Nga tone ironike përshkohet balada, "*Kalorësi Kurt shkon të martohet*", ku satirizohet rendi feudal. Po kjo ironi e shoqëruar me një fantazi të pasur përshkon baladën "*Nxënësi i magjistarit*", një satirë e mprehtë kundër imituesve në art ose në shkencë.

Elementi fantastik te Gëtja, pra, nuk ka asgjë mistike, ka më tepër karakter figurativ dhe simbolik duke përforcuar idenë.

Te "*Peshkatari*" floçka e bukur që e shtyn peshkatarin në lumë, simbolizon pasionin e rrëmbyer që e shtyn njerinë në greminë.

"*Mbreti i pyllit*" është në të vërtetë dramë e fëmijës së sëmurë që vdes para kohe dhe të atit që s'mund ta ndihmojë, ndonëse e ka në krahët e vet. Xhindet janë në të vërtetë një shprehje e përçartjeve të fëmijës, e frikës së tij nga errësira.

Baladat e Gëtes e kanë të theksuar ngjyrën kombëtare duke qenë frymëzuar më të shumtën e herës nga folklori gjerman dhe duke pasur në qendër ato figura fantastike që janë të njohura në poezinë popullore gjermane. Ato kanë njëkohësisht një domethënie të thellë njerëzore që i kalon caqet kombëtare.

Subjektet e baladave të Gëtes janë në vetvete tërheqëse dhe intriguese, po poeti nuk synon të tërheqë vëmendjen e lexuesit me to, ai madje nuk përpiqet as për ndonjë origjinalitet në trillimin e intrigës, që, si skemë, është pothuajse gjithmonë e huazuar, nga poezia popullore dhe kulte, nga krijime poetike gjermane ose të huaja. Gëtja synon për të përçuar ide dhe ndjenja të fuqishme. Tragjizmi te baladat e tij nuk ka asnjë lidhje me efektet pas të cilëve do të jepeshin aq shumë romantikët, sidomos romantikët pasivë dhe reaksionarë. Subjekti i baladës "E *fejuara nga Korinti*" ose "*Mbreti i pyllit*" jepte mundësi për një kult të së tmerrshmes, ndërsa Gëtja, i përqendruar te drama njerëzore e protagonistëve, e ka shmangur këtë gjë. Tragjizmi është pasqyrim objektiv i një tragjizmi objektiv dhe jepet nga poeti me një ndjenjë të admirueshme të masës. "2 *Epigramet veneciane*" u shkruan pas udhëtimit të dytë në Itali. Dhe në këto poezi të fuqishme greke, si edhe tek "*Elegjitë romane*", tek odet apo tek krijimet e tjera të këtij lloji, lënda që na sjell nga realiteti është kaq e bollshme, e gjetur me kaq mprehtësi dhe derdhur me kaq intensitet emocional dhe elegancë, sa i bën këto një kronikë realiste të jetës së Venedikut e të biografisë së vet. Në to fshikullohet injoranca e sundimtarëve, kulti fanatik i shenjtorëve, zbulohet fytyra e varfërisë dhe e mjerimit, goditet luksi dhe jeta pa kokëçarje e shtresave të pasura; por në to gjen pasqyrim dhe dashuria e poetit për jetën, ajo shtysë e përhershme e tij për t'u lidhur me gëzimin që të fal jeta e gjallë në mes njerëzve, përsiatjet mbi ngjarjet që tronditën shekullin, humanizmi dhe mendimi i thellë filozofik i poetit mbi gjithçka që vëren e jep gjykime e bën përgjithësime.

Poezia e Gëtes dallohet për pasurinë e figuracionit ku shkrihet fantazia dhe konkretësia, për pasurinë e imtësive të gjalla dhe njëkohësisht për një muzikalitet të jashtëzakonshëm. Ai poet gjenial që e trajtonte me aq mjeshtëri vargun e përzier, pararendës i vargut të lirë tek "*Prometeu*", "*Ganimedi*", "*E hyjnishmja*", di të derdhë aq mendime dhe aq ndjenja në caqet e një poezie të rregullt, madje edhe të formave të vështira si soneti. Muzikaliteti i vjershave të Gëtes me

tonet e veta, herë të ëmbla, herë të ashpra, i përshtatet brendisë, ndjek ritmin e brendshëm të saj.

Poezia e Gëtes përbën një dukuri të veçantë në poezinë gjermane dhe botërore. Në këtë poezi filozofi, poeti spontan, i çiltër si fëmijë, madje naiv me atë naivitet që, sipas Shilerit, i dallon gjenitë, dhe artisti gjithnjë i pakënaqur i formës, i kanë dhënë dorën njëri-tjetrit. Gëtja pati thënë me modesti: "*Vepra ime është fryt i një kolektivi dhe mban emrin Gëte*", duke njohur kështu ndikimin nga mjeshtrat e mëdhenj të kohëve të ndryshme dhe nga thesari i poezisë popullore dhe duke u nisur ndoshta edhe nga vetëdija se çdo poet i madh është zëdhënës i popullit. Dhe prapëseprapë nuk ka ndoshta poet që ta ketë shprehur aq shumë vetveten si ai në poezinë e vet në mënyrë të tillë sa kjo poezi mund t'i quhet ditar i jetës. Ai ka shkrirë krejt në këtë poezi mendjen dhe zemrën, duke i dhënë një freski dhe origjinalitet të pakrahasueshëm.

Cilit drejtim letrar i përket kjo poezi?

"*Sturm und Dangu*" ka qenë pararendësi i romantizmit dhe në bazë të poezisë së Gëtes gjejmë vërtet romantikën e pakënaqësisë nga realiteti dhe aspiratën ndaj një ideali jashtë këtij realiteti, madje gjejmë edhe tipare të tjera që do ta dallojnë drejtimin letrar të romantizmit, kultin e ndjenjës, kultin e natyrës, adhurimin dhe ndikimin nga poezia popullore, pirjen ndaj së jashtëzakonshmes, (të shkrirë megjithatë me një aftësi për të zbuluar poetikën në të zakonshmen), pirjen për t'i thyer rregullat e ngurta.

Klasicizmi i Gëtes përputhet me çka më të mirë pati drejtimi letrar i klasicizmit, harmoni, sens mase, ekuilibër, po lidhet më tepër me ndikimin e drejtpërdrejtë e krijues nga poezia antike, gjithashtu nuk shënon tek ai një shkëputje të plotë nga romantizmi.

Të gjitha këto veçori të poezisë së Gëtes i japin asaj freskinë dhe origjinalitetin e pakrahasueshëm dhe ia kanë ruajtur vitalitetin ndër shekuj.

**Klara KODRA**

PRISHTINË-PRISHTINA

# Amadisi i ri

Kur çunak e çamarrok
Më mbyllën, për dreq,
Më kaluan shumë mot
Si në çark, sa keq,
Në mjerim e lot!

Larg s'më ndejte ti aspak,
O moj fantazi!
Isha si hero me fat,
Princ i madh Pipi,
Botën brodha qark!

Mjaft kështjella ngrita lart,
I shemba përdhe.
Vrava sprijë e lugat
Në vrull e hare,
Me ç'guxim, ç'inat!

Dhe princeshën – peshk, perri,
Munda ta shpëtoj,
Në tryezën plot stoli
Bujarisht më ftoi.
Oh, ç'kënaqësi!

Mjaltë puthjet që më dha,
Vera si rubin!
Ah, e desha sa më s'ka,
Dielli plot shkëlqim
Derdhej drejt prej saj!

Kush ma mori, ç'tinëzar!
Si nuk e pengoi,
Lidhje e shpirtit ndezur zjarr?!
Thomëni nga shkoi?
Ç'rrugë, pra, të marr?

# Hënës

Mbush kaçube edhe lug
Heshtas me shkëlqim,
Ma çliron shpirtin në fund
Nga çdo lloj mundim!

Fushës ç'dritë që vërshon
Nga vështrim i saj,
Si sy miku që përgjon
Fatin tim çdo skaj!

Ndiej në zemër çdo tallaz
Që gjëmon tani,
Edhe rroj me dhimbje e gaz
Në këtë vetmi!

Rridh, o rridh, lumë në breg,
Gjumë nuk kam më.
Ç'dhimbje, ç'puthje që më djeg
Ikën përgjithnjë!

Edhe unë njoha kaq net,
Ç'më gëzoi fort,
Dhe ky shpirt për vrer të vet
S'i harroka dot!

Rridh o lumë e mërmëri
Lugut pa pushim,
Mbushma plot me melodi
Shpirtin, zërin tim!

Dhe kur dimrit shungullon
Vrullshëm zemërak,
Dhe kur majit mërmëron
E gonxhet spërkat!

Sa i lumtur kush e lë
Botën pa një hall,
Dhe në gjoks një shok gjithnjë
E pushton me mall!

Atë që s'e di njeri
Dhe s'e merr me mend,
Na shpërfaqet mu në gji
Natës nga çdo kënd!

# Pranverë e parakohshme

Ç'erdhët papritmas
Ditë plot gaz,
Diell po më falni
Pyll dhe shpat!

Rrjedh plot rrëkeja
Në breg, ndër zhukë,
Po ato fusha,
Po ai lug?!

Ç'qiell kaq i bruztë,
Ç'fllad, ç'lartësi!
Shkasin liqenit
Peshq si flori!

Zogj ngjyra-ngjyra
Pyllit zhurmojnë,
Ç'këngë e ç'tinguj
Ngrihen, kumbojnë!

Poshtë blerimit,
Nën gjeth e bar,
Bletët zukasin,
Mbledhin nektar!

Drithmë e lehtë
Ajrin përshkon,
Ç'vrull i magjishëm,
Ç'erë fërrmon!

Befas dhe fortas
Fryn me rrëmbim
Flladi, ndër shkurre
Humb, s'fëshfërin!

Porse në gjoks
Fryn përsëri,
Si mund të mbakam
Kaq lumturi?!

Thomëni, Muza,
Ç'më ndodh kështu?
Miken, moj motra,
E kam këtu!

# Në liqen

Marr jetë e vrull e gjak të ri
Nga bota pa mbarim,
Natyra ç'gaz e ç'lumturi
M'i fali gjoksit tim.
Lëkundet lundra përmbi valë,
Lopata ujin rreh,
Edhe na dalin ne përballë
Malet me mjegull, re!

Sy, or sy, përdhe ç'shikoni?
Ëndrra të arta mos kërkoni?
Ëndërr pa largomu, ti,
Dhe këtu ka dashuri!

Ndrijnë përmbi valë
Yjet plot me dritë,
Mjegulla ngadalë
Po fsheh largësitë.
Flladi mëngjezor
Fryn përmbi liqen,
Pasqyron, pa zor,
Frutin që shkëlqen!

# Shpëtimi

Më la pra vajza, ç'pabesi,
Dhe kjo mërzi më vrau shumë,
Ahere shkova tek një lumë,
Por ujët rridhte qetazi.

Pa fjalë ndenja, shpirtfarmak,
Dhe si i pirë më errej mendja,
Se mënt në ujë u hodha brenda,
Më vinte dheu rreth e qark!

Dikush më thirri, mbajta vesh,
Kur për këtu isha drejtuar,
Më tha një zë kaq i kulluar:
"I thellë lumi, kij kujdes!"

Shpejt gjaku më vërshoi ndër dej,
Dhe shoh se ish një vajzë e bukur,
I them: Si quhesh ti, moj flutur?
"Katinë!" - Ç'gaz, s'mund ta rrëfej!

Nga vdekja më shkëpute sot,
Dhe jetën time ma shpëtove,
Por shumë pakëz më dhurove,
Më fal pak lumturi ti dot?

Dhe i tregova ç'më mundon,
Përdhe i uli sytë e shkruar,
E putha, më puthi e malluar,
Dhe vdekja s'vjen, se më s'guxon!

# Bunacë

Ç'qetësi sundon mbi ujë,
Tundje deti bën gjer larg,
Lundërtari i shqetësuar
Sheh rrafshirën rreth e qark.
Erë s'fryn nga asnjë anë,
Ç'heshtje vdekjeje, sa tmerr!
Në krejt këtë hapësirë
Asnjë valë frymë s'merr!

# E dashura Terezë

E dashura Terezë,
Ç'më therin si një presë
Dy sytë që ti ke!
Sylidhur, fare lehtë,
Më gjete me të shpejtë,
Po pse më kape, pse?!

Më kape, më shtrëngove,
Më mbajte, ç'më trazove,
Të rashë përmbi gji!
Por kur t'i zgjidha sytë,
Pa gaz mbeta dhe tytë,
Më shtyve, akull ti!

Po ec si me të shtytur,
Si i shembur e i ndrydhur,
Edhe kushdo më tall.
Në s'kam për t'u përfillur,
Do shkoj si me sylidhur
Se ç'jetë, pa pak mall!

# Nxënësi i argjendarit

Kjo fqinja, sa më robëroi,
Ç'e dashur, ç'pastërtore.
Sa hap punishten e vështroj
Si shet në tregëtore!

Sajoj me fije ari plot
Unaza e zinxhira.
Mendoj do bëj unazë dot,
Ta mbajë Katerina.

Dhe sa kanatat hap, gjithnjë
Vërshon qyteti brenda,
Kërkon e blen ai çdo gjë
Prej mallit që i ka ënda!

Ia nis lëmimit me durim,
Për mall mbi fill të artë.
Zot i dyqanit ulurin,
Bërtet e bën shamatë!

Kur blerës s'ka, fillon ajo
Të tjerrë me dëshirë.
Kuptoj se ç'gjë të thuri do
Kjo vajzë kaq e mirë!

Kur këmbë lehtë ec plot gas,
Për të mendoj nga malli
Një zhartier, mendoj një çast,
Kësaj vajze t'ia fali!

Ndër buzë perin e përshkon,
Se do që ta provojë,
Të isha pe, mendja më shkon,
Ta puthja mu në gojë!

# Kam dashur, po dua tani...

Kam dashur, po dua tani më me zjarr,
Kam qenë shërbyes, tani jam një skllav,
Me ç'zell më ndezi kjo mike besnike,
Dhe nis ma shpërblen çdo dhimbje fisnike,
Për mua s'ka tjetër si kjo!

Besova, tani besoj me pasion!
Në shkon jeta mbarë a barra ngarkon,
Besimi prej meje s'mërgohet!
Po ngryset kaq shpesh, po erret e nxin,
Shtrëngon keqas brenga, rreziku arrin,
Por qielli nis prapë kthjellohet!

Kam ngrënë, tani po ha sa për tre,
Më ndriti krejt shpirti e zemra më rreh,
Gjithçka më zjen, bërtas e gajas,
Kam mall që të shtrohem ndër vende plot gas,
Ngjeroj, më shijon fort ushqimi!

Kam pirë më parë, tani s'lë sapllak,
Dhe vera na ngre, na bën më çakmak,
Dhe gjuhën na zgjidh nga zinxhirat!
Nga vozat po zbrazet e rrjedh me rrëmbim,
Na ndez kaq dëshira, na ngjall kaq besim,
S'na ndalin hendeqet, rrëpirat!

Në valle jam hedhur, në valle marr zjarr,
Asnjë shilarthar dhe asnjë valltar
S'erdh rrotull në valle si flutur!
Dhe kush shumë lule ia doli të thurë,
Dhe kurrë s'i ndau, s'i shkeli në turr,
I mbeti kurora e bukur!

Ta thurim kurorën! Mos kini ngurrime!
Kush merr trëndafilin plot vesë e shkëlqime
E çjerr veç pak gjembi i mprehtë.
Si dje edhe sot shkëlqejnë fort yjet,
Por larg mjaft i rrijnë kujt frikshëm ul kryet
Dhe ngrys po gjithnjë po një jetë!

# Bashkëshortë të lumtur

Pas këtij shiu prilli,
Që pritëm me kaq gaz,
Nuk sheh, grua, tërfili
Si fushës ngre tallaz!
Nën këtë qiell të kthjellë
Që syrin ta tret larg
Se ç'dashuri e thellë,
Se ç'lumturi pa cak!

Një çift pëllumbash sulet
Rrëmbimthi, ja, atje
Ku vjollca po përkulet
Plot gjethe mbi rrëke.
Atje ne mblodhëm bashkë
Sa lule me gëzim,
Dhe zemra mori flakë
Nga malli pa mbarim!

Dhe ja mu tek altari
E shtrenjta: "Po!" më tha.
Mes çiftesh, degash lari,
Bekimin prifti dha!
Dhe ç'diell, ç'hënë e ç'yje
Do kemi ne gjithkund!
Ky dhe plot male e pyje
I yni gjer në fund!

Dhe qindra vula, firma
Ka për këtë bashkim,
Në pyllin tek kodrina,
Luadhit plot blerim,
Ndër zgavra, ndër gërmadha,
Ndër plasa ku s'mbin bar,
Amori ku hedh hapa,
Me hark e me pishtar!

Ne brodhëm të gëzuar,
Kënduam plot hare.
Po ja, si pakuptuar,
U bëmë befas tre.
Dhe katër, pesë e gjashtë
Rreth vorbës që valon,
Nën strehëzën me kashtë,
Ku jeta shteg kërkon!

Dhe në atë rrafshirë
U ngrit një strehë shpejt,
Me plepa e çahirë,
Me gardh e me hendek.
Kush lodhet deri vonë
E çlodhet pak në lis?
Me gruan tok gjithmonë,
Kush, veç shtatlartit Fric?

Dhe ku shkëmbenj e shkrepa
Ngushtojnë lumin fort,
Shkumon grykash plot thepa,
Karroca tej s'ik dot!
Për mullitaren ç'fjalë
Të thonë në çdo vend.
Kjo vajza jonë e rrallë,
E bukur e plot shend!

Dhe ku blerimi kishë
E park rrethon ngado,
Ku e qëmotshmja pishë
Mes resh ngrihet, shiko,
Të vdekurit pushojnë,
Ç'i korri vdekja e shkretë!
Dhe sytë na vështrojnë
Tek qielli lart, përpjetë!

Shkëlqejnë pushkë e topa
E kodra shungullon.
Ec udhës plot me gropa
Ushtria që s'ndalon.
Kush mban një shenjë nderi,
Kush shkel krenar mbi ledh?
Shih, Karli, syskifteri,
Në prag sërish na erdh!

Të gjithë miqtë tanë
Gostit nusja plot hir,
Me këngë e këmbanë
Vu rreth me xhevahir.
Në vallen dora-dorë
Kërcen i ri dhe plak.
Stolisur me kurorë
Po vijnë tre çunakë!

Me fyell e zamare
Po nis një kohë e re,
Porsi ky çift sa zjarre
Në shpirt mbanim dhe ne!
Kaq vite fluturojnë,
Po gazi s'na u fik!
Në pagëzim po shkojmë
Me djalë e me nip!

# Takim dhe ndarje

Zemra më rreh. Vrik përmbi kalë!
Nxitoj edhe s'qëndroj gjëkund.
Nata u rras gjer lart në male
Dhe mbrëmja tokën e përkund.
Një lis në mjegull veshur ngrihet
Si një vigan krenar atje,
Ku errësirë e dendur shtrihet,
Me një qind sy të zinj të sheh!

Që prej një kodre resh kjo hënë
Me pikëllim poshtë vështron,
Era i tund krahët si pendë,
Në vesh, për tmerr, më shungullon.
Mijëra hije pjell kjo natë,
Por gjë s'e trand guximin tim:
Në dej të mi se ç'zjarr, se ç'flakë!
Në zemrën time, ç'përvëlim!

Të shoh dhe një shkëlqim hareje
Të shket ndër buzë e ndër sy,
Krejt zemra ime pranë teje,
Çdo frymëmarrje ta fal ty.
Një kuqëlim i trëndafiltë
Ta rrok fytyrën rreth e qark,
Dhe ç'ëmbëlsi më çmpin kërcinjtë!
Më ngjan se s'më takon aspak!

Por ah, tani sa zbardh agimi
Në zemër ndarja më shtrëngon:
Në puthjen tënde ç'det gëzimi!
Në syrin tënd ç'dhimbje mundon!
Po shkoj, përdhé sheh e malluar,
Me sy më ndjek, nga era mardh:
Po ç'gaz të jesh i dashuruar,
Të dashurosh ç'gëzim i madh!

# Belindës*)

Oh, përse më grish si pakuptuar
Në atë shkëlqim?
Djalë i ri, i mirë, atë natë
A s'kishte gëzim?!

Heshtur rrija mbyllur mu në dhomë,
Dergjesha në shtrat,
Nën këtë ndriçim të butë hëne
Flija fillikat!

Ndjeja nëpër ëndërr i gëzuar
Ç'dritë e ç'mrekulli!
Pamja jote e dashur m'u fut thellë
Vetvetiu në gji!

Jam ai që në tryezë loje
Prapë e mban, ç'hall,
Që mes pamjesh që të kallin krupë
Ti e ve përballë?!

Nuk ia ndjej magjinë dot pranverës,
Gaz s'kam në fytyrë.
Ku je ti, e dashur dhe e mirë,
Ku je ti, Natyrë!

---

** Belindës – Me emrin Belinda Gëtja i ka kënduar së fejuarës së vet, vajzës së një bankieri nga Frankfurti, Lili Shenemanit.*

# Këngë nëntori

*Shigjetari*[1], jo kush u mplak,
Nga pas diellit i shkon,
Edhe fytyrën me duvak
Prej resh në qiell mbulon!

Por çunit[2] këngë i thur plot gaz
Mes lulesh që baret,
Që na përgjon e vjen një çast
Në zemër na godet!

Për atë nata plot stuhi,
Për tjerët gjëmë e tmerr,
Ne na sjell miq edhe gosti
Dhe gra me shtat mermer!

Imazh i tij tani në qiell
Mes yjeve qëndron,
Në amëshim për ne si diell
Agon e perëndon!

---

*1) Në muajin nëntor dielli i afrohet Yllësisë së Shigjetarit.*

*2) Simbol i Amorit, që përfytyrohet si një çunak me shigjetë.*

# Lotes

Në rrëmujë gazi e mundimi,
Nëpër dallgë zemre që të dhemb,
Të dy bashkë në flakë perëndimi
Të kujtojmë, o Lote, përnjëmend.
Na dhe dorën neve miqësisht
Dhe në mes të fushës me blerime,
Në gji të natyrës plot shkëlqime
Ne na preke gjer në mallëngjime,
Kur na hape shpirtin çiltërisht!

I kënaqur që nuk jam mashtruar,
Që të njoha që në çast të parë,
Me atë që ndrin në shpirt si zjarr,
Drejtas edhe mirë të kam çmuar.

Heshtas e të lidhur bashkë ngushtë
Ne na hedhin me vërtik në botë,
Përmbi valë me gjëmim e shkulmë,
Na magjepsën e na ngjallën lotë!

Rritur heshtas, qetas e shtrënguar
Nëpër botë u hodhëm menjëherë.
Ç'dallgë u sulën duke rrapëlluar,
Ç'gaz e ç'dhimbje patëm ne ngaherë!

Edhe për çdo grimë si një shtjellë
Na përkundi ndjenjë e paqetë,
Ndjemë fort e çfarë ndjemë thellë
Turma mospërfillëse flak shpejt.

E di mirë se më kap gjithmonë
Ndonjë dhimbje, shpresë a hare.
Lote, kush e njeh mundimin tonë,
Zemrën tonë, Lote, kush e njeh?
Ah, do desh të njihej, të kalojë
Tek ndonjë krijesë tjetër shpejt,
Dhe dyfish pa droje të shijojë
Gaz e dhimbje që na fal kjo jetë!

Dhe kërkon shpesh syri me të kotë
Rreth e qark e ndoshta gjen diçka,
Motet më të bukur pa një shqotë,
Pa gëzime e hove të mëdha!
Për mërzinë që të bren përherë,
Ç'të tërhoqi dje, të shtyn sot tej,

Mund t'ja falësh botës plot poterë,
Që mjaft të gënjeu gjithandej;
Dhe në dhimbjen tënde e lumturinë,
Do të mbesish risht plot qetësi?
- Ja u zmbraps ky shpirt, duron vetminë,
Ndërsa zemra mbyllet heshtazi!

# Lundrim në det*)

Mjaft kohë ngarkuar më qëndroi anija,
Duke pritur erën rrija me shokët besnikë,
U mbaja gjallë durimin e guximin
Tek limani!

Zienin nga padurimi e më thonin:
"Duam të nisemi shpejt për në udhë,
Mallin dëng ngado po e pret bota.
Tek të dashurit plot mall të kthejmë,
Shpërblimi – yti!"

Herët në mëgjes, ah, se ç'rrëmujë!
Flakën gjumin, thirrën marinarët,
Se ç'gëlim, ç'lëvizje në çdo anë,
Me të parën erë të lundronin!

Velat fryheshin nga erë e mbarë
Dhe dielli plot dritë larg të joshte,
Hiqnin velat e lart rendnin retë,
Gjatë bregut seç ia morën këngës,

---

*) Lundrim në det – *Me timonierin që qëndron me guxim tek timoni, ka parasysh veten e vet. Kunati i Gëtes, Shloseri, vuri në kopjen e kësaj poezije këtë mbishkrim karakteristik: "Kur miqtë kishin frikë se Gëteja nuk do të ambientohej në Vajmar, ai u dërgoi si ngushëllim këto vargje".*

Këngës shpresëmirë. Në të ndihej
Gazi i lundrimeve të largta,
Por dhe yjet e së parës natë!

Befas që nga largësi e vdekur
Tinëz çapi lehtazi shtërngata.
Klithën zogjtë, ulen për skaj ujit,
Shpirt i gjindjes mënt u shtyp nga ndrydhja.
Ajo erdhi! Para rrapëllimës
Kapiteni mblodhi gjithë velat.
Porsi me një top të lemerisur
Me anijen luan dallga e era!

Po atje matanë bregut zbehur
Miqtë e dashur dridhen fort nga frika:
"Ah, përse këtu ai nuk mbeti!
Do na mbytet miku në fund detesh?
Ah, sikur të mundet të shpëtojë!"

Tek timonieri rri ai si burrë,
Me anijen lot dallga dhe era,
Dallga, era dot nuk lot me zemrën,
Plot pushtet vëren honin që çmendet,
Ia beson dhe humbjen dhe shpëtimin
Forcave hyjnore!

# Si, erdhe ti?

Si, erdhe ti?! Plot mall sytë s'i ngrita
Dhe s'të dallova, kur u ktheve, jo!
O çast i lumtur e që s'kthehesh! Ç'prita?
Mos jam i verbër? Si më ndodhi kjo?

Ti mua do më japësh pak të drejtë,
Në do mundohem të të ngushëlloj.
Kur afër je nga sytë më shket lehtë,
Kur ndodhesh larg, më shfaqesh para, moj!

# Këngë nate e artistit

Sulmi i brendshëm krijimtar
T'i derdhë të gjitha furitë,
Dhe një tablo plot vrull e zjarr
Të pikturojnë gishtërinjtë!

Veç fërgëlloj, veç belbëzoj,
Dhe s'të braktis e s'jam i qetë.
Të ndjej, natyrë, të kuptoj,
Dhe pse s'të rrok dot prush i nxehtë.

Kaq mote që s'më kthehen më
Lëngoi i kyçur shpirti i gjorë,
Si një djerrinë pa një zë,
Po rrodhën krojet argjendtorë.

Ç'gëzim, natyrë, më fal ti,
Mike e dashur, besëtare,
Je shatërvan plot bukuri
Me qindra gryka buçimtare!

Dhe forcën që tek mua rron
E kthjellëson, i jep më jetë,
Dhe qenien, rrojtjen ma zgjeron
Me amëshim pa fund, për jetë!

# Shpresa

Gjithnjë bëni papërtuar
Me gëzim punën, o duar!
Lodhje s'ndiej e s'ndiej të plakur,
Se nuk është ëndërr e zbrazur.
Këto pemë e degë hardhie
Do të japin frut e hije!

# Këngë mëngjezi e shtegtarit

*Lilas*

Mjegulla e mëngjesit, Lila,
Ta ka mbështjellur pirgun e kështjellës.
Duhet
Të mos e shoh për herë të fundit?!
Por rreth më fluturojnë
Mijëra imazhe
Prej kujtimit të lumtur
Që rron në zemrën e ndezur.
Ajo ngrihet
Si dëshmitare e mallit,
Ku për herë të parë të huajin
Plot angushtim dashurie
E takove,
Dhe menjëherë
Flakë të përjetshme
I hodhe në shpirt.
Vërshëlle, erë e veriut,
Me mijëra gjuhë gjarpërinjsh
Mbi kokën time!
Nuk mund të ma kërrusësh!
Mund të përkulësh
Vetëm degët e njoma të majave,
Që u mungon prania

E diellit atëror!
Dashuri e kudopranishme,
Më ndeze flakë!
Përballë rrebeshit ngre ballin,
E përballë rrezikut gjoksin.
Ti më derdhe
Në zemrën që m'u lëndua që herët
Jetë të dyfishtë,
Gëzim për të jetuar
Dhe kurajë!

# Gëzime

Mbi kroje pa përtesë
Endet kjo pilivesë,
Kaq fort ç'më ngazëllon!
Si mug e plot shkëlqime,
Porsi kameleon,
Purpur apo e kaltër,
E kaltër a e blertë!

Të mund ta shoh nga afër
Këtë ngjyrim të pastër!

Zukat, nxiton e s'njeh pushim,
E qetë ndali mbi një shelg.
E kapa, befas, fluturim!
Tani nga afër e hetoj,
Një blu të errët i dalloj!

Kështu të ndodh dhe ty që deshifron gëzimet!

# Sharlota Fon Shtajn*)

Pse vështrimi yt i mprehtë, i thellë,
Mund ta shohë fatin tonë krejt,
Për të kapur, në do të jetë i kthjellë
Malli ynë e jeta që na pret?
Fat i egër, pse na u dha dhuntia,
Ta zbulojmë zemrën gjer në fund,
Edhe pas çdo kthine fshehtësia
Më intime mos na fshihet kund?

Mijëra që nëpër terr vërtiten,
Pa qëllim, pa shpresa, shteg më kot
Po kërkojnë, lodhur e sfilitur,
Por as zemrën nuk e kqyrin dot!
Dhe dalldisen, nëse shkrep agimi,
Nga gëzim i zbehtë, si në terr,
Veç tek ne në zjarre përqafimi
Lumturia qesh e frymë merr.
Do të duhemi, si pakuptuar,
Dhe do shohim çka nuk është më,
Gati për çdo gaz të ëndërruar,
Për çdo grackë që përgjon pa zë.

Sa i lumtur kush mbart ëndrra boshe
Edhe parandjenja fare s'ka
E një rrojtje bredh qoshe më qoshe
Pa kuptuar ç'barra ka gjithkah.

---

*) Sharlota Fon Shtajnit – *Sharlota Fon Shtajni gruaja e një oborrtari të rëndomtë të Vajmarit, zonjë nderi e dukeshës Ana Amalia, ka qenë mike e Gëtes për shumë vjet me radhë.*

Pa më thuaj fati ç'na gatuan,
Si me mua ti u lidhe fort?
Mos ndër ëndrra sytë të vështruan,
Motra ime e shoqe ndjenjaplot?

Ti ma di gjithçka që mbaj përbrenda,
Dhe përgjon si dridhet, ah, çdo rremb,
Me një sy kupton se ç'më fsheh zemra,
Duke hyrë në çdo pllajë e kënd.
Dhe ma rregullon ecjen në jetë,
Gjakun plot rrëmbim ma qetëson,
Ma fashit çdo dhimbje teh të mprehtë,
Më fal vrull e prush që më gjallon.
Dhe mes duarsh dritë edhe erë
Zemrën ma miklon e ma përkund.
Ndiej magji që s'ndjeva asnjëherë,
Gaz që asnjë shqotë s'e lëkund!
Ndiej si zemra më rreh pranë teje,
Nën vështrimin tënd plot mirësi,
Ndiej si ndrit çdo ndjenjë brenda meje
E si gjaku rrjedh më qetazi!

Nga e gjitha kjo veçse kujtimi
Rrotull zemrës si i verbër bredh,
Gjithçka qe plot flakë përvëlimi
Ende rron, por çasti vrer na vjell.
Ndaras rrojmë jetë jo të plotë,
Dita më me dritë bëhet mug,
Por sa gaz, ky fat që ngre kaq shqotë,
Dot të na ndryshojnë nuk po mund!

# Minjoni

A e di vendin plot limonj dhe lar,
Ku portokajt ndriçojnë porsi ar?
Nga qielli era fryn e shket ndër gjeth,
Dafina çel e kroi ëmbël rrjedh.
A e di ti?
  Atje! Atje!
Atje i  dashur do të shkojmë ne!

E di shtëpinë? Ngrihet në çati
Mbi shtylla, dhoma, salla, ç'madhështi!
E çdo shtatore nis më pyet sot:
Ç'u bëre vajzë e mjerë ti kaq mot?!"
A e di ti?
  Atje! Atje!
Të dy, o mbrojtës, le të shkojmë ne!

E di ti malin, shtegun nëpër re,
Ku nëpër mjegull mushka mezi sheh?
Ndër shpella rrojnë të lashtit dragonj,
Rrëzohet shkëmbi, uturon përronj!
A e di ti?
  Atje! Atje
Shkon, o atë, udha që do marrim ne!

2.

Do hesht, të flas nuk ma ka ënda,
E fshehta fort më detyron,
Do të tregoja ç'mbaj përbrenda,
Por fati mua s'ma lejon.

Kur koha vjen, shkon dielli plot me gaz,
Dhe terr i natës ndritet, bëhet ditë,
I forti shkëmb e hap gjoksin një ças,
Burimi rrjedh, shpërthen nga thellësitë!

Gjithçka në krah të mikut gjen pushim,
Aty zemrën e hap e i rrjedh loti,
Por buzët m'i ka mbyllur një betim,
Dhe për t'i hapur s'mundet dot, as zoti!

3.

Veç kush mallin e njeh
E di ç'lëngime
Më heq zemra gjithnjë,
Që s'ka gëzime!
Shoh qiellin pa kufi
Nëpër çdo anë,
Kush ndjeu kaq dashuri
S'më ndodhet pranë.
Më vjen mendja vërdall
Me ditë e muaj,
Kush njohu dot kaq mall
E di sa vuaj!

4.

Kështu më lini, sa të zbres nën tokë,
Dhe mos ma hiqni veshjen bardhë borë!
Që nga ky dhe i bukur, luleplotë,
Mu në qivur do dergjem përgjithmonë.

Do prehem, pak, mes heshtjes si e ngrirë,
Një jetë e re më shfaqet në vegim,
Tej do ta flak mbështjelljen e dëlirë,
Këtë kurorë, këtë brezin tim!

Çdo qenie shtathedhur e qiellore,
Pa pyetur jam burrë apo grua,
Pa rrobe, kinda, stringla e rrypore,
Me dritë trupin do ma veshin mua!

Më s'do të ndiej më brenga e mundime,
Por dhembja do më therë në gji risht!
Që herët mplakur nga kaq shqetësime,
Do rrah të jem e re përjetësisht!

# Felina

Nuk këndohet, kur ke lotë
Në mes natës plot vetmi.
Jo, moj vajzë magjiplote,
Ti do gaz e shoqëri!

Porsi gjysmë e bukurisë
Burrit gruaja iu dha,
Edhe natë e dashurisë
Gjysma që më mjaltë ka!

Mundet pak të lehtësohet
Ditës kur ka gaz gjithnjë.
Këto vlejnë të hutohesh,
Dhe për asnjë tjetër gjë!

Nëse në të natës orë
Llamba ëmbël dritë derdh,
Edhe goja gojës prorë
Veç shaka e fjalë i hedh,

Nëse djali, harrakati,
Që veç bredh e ik pa fre,
Shpesh për trill e për dhuratë
Mu në mes lojën e le,

Në dashnoreve bilbili
U këndon me mall në maj,
Burgjeve ku kris zinxhiri
Tingëllon si gjëmë e vaj!

Më çfarë drithme ngazëllimi
Ndjej këmbanën si kumbon,
Krismë e saj e tingëllimi
Paqë e siguri premton!

# Harpëtari

## 1.

Kush rrojti gjatë në vetmi,
I vetëm prapë do jetë.
Ju rroni, bëni dashuri,
Atë dhimbja e pret!

Më lini me brengën farmak,
Të drejtë a s'kam pak,
Të jem një herë fillikat,
S'kërkoj, jo, tjetër fat!

Si një dashnor që rri përgjon
Mos mikja vetëm rri,
Kështu çdo ditë sheh e sulmon
Kaq keqas vrer i zi.

Ah, ky mundim që s'rresht,
Do mundet që të hesht!
Do jem i vetëm përgjithnjë,
Veç kur të fle nën dhe!

**2.**

Do pres heshtaz mbledhur shuk
Prapa dyersh tinëzisht,
Mos më japin pakëz bukë,
Udhët do t'i marr sërisht!

Dikujt buza do t'i qeshë,
Kur t'i shfaqem në vegim,
Lot do derdh e s'do marr vesh,
Pse lëngoj me ngashërim!

**3.**

Kush bukën s'e njomi me lot,
E s'njohu ankth e zore,
E heshtas s'qau në shtrat dot,
Për ju s'di gjë fuqi qiellore!

Në jetë e prini ju gjithnjë
Të mjerin, ç'dallgë ka mbi kokë!
Mes dhembjesh e fshikni atë,
Sepse çdo faj lahet mbi tokë!

# Natë e bukur

Le kasollen e vetmuar,
Miken që më ndenj në gji,
Bredh çaplehtë dhe i menduar
Nëpër pyll e shkretëti.
Hëna shket mbi lis e plepa,
Fryn zefiri që më deh,
Dhe baloshet ulin lehtë
Degë e fletë gjer përdhe!

Ç'më gëzon ky fresk, kjo verë,
Dhe kjo natë plot magji!
Gaz si ky mjaft rrallë herë
Më vërshoi brenda në gji!
Natë e bukur si përrallë,
Po një mijë si këtë,
Mbaji, qiell, veç të më falë
Vasha ime vetëm një!

# Këngë nate e gjahtarit

Ndër fusha ec me vrazhdësi
Me pushkën përplot mbushur,
Më shfaqet para sysh të mi
Imazhi yt i bukur!

Tani ti shkon me vrull e gaz
Në fushë e lug fryn erë,
Vegimi im vetëm një çast,
S'të del ty veç një herë?

Njeriu që botën pa mbarim
E bredh plot helm e brengë,
Nga Lindja gjer në Perëndim,
Si mund të të heq nga mendtë?!

Kur të sodis, ti më ngjason
Si hëna që çan retë,
Një paqë shpirtin ma pushton,
Si ndodh, s'e di as vetë!

# Nevojë dashurie

Kush më ndien? Ah, kujt mund t'i ankohem?
Kush do ndjente, do ma qante hallin!?
Ah, kjo buzë që kaq det gëzimesh
Pat shijuar edhe pat blatuar,
Keq m'u plas e ka dhimbje të shumta
Dhe ajo aspak s'është plagosur,
Se m'u sul kaq egër dashuria,
Ëmbël më kafshoi të sigurohej,
Se do të shijohej fort nga miku!
Jo! Kjo buzë e brishtë m'u pat çarë
Se thëllimet përmbi brymë e ngricë
Më përplasën mjaft keqas, padashur!
Dhe tani fisniku lëng i rrushit
Me lëngun e bletës pranë zjarrit
Duhet të më lehtësojë pakëz.
Ah, ç'dobi, kur vetë dashuria
Nga balsam i saj s'më fal një pikë!

# Orakulli i pranverës[1)]

Kukëzë, zog profetik,
Më dëgjo, dëgjo një çikë!
Po të lutet çift i ri,
Në të bukurën rini,
Zog i dashur e dëgjon?!
Të shpresojmë, mos kumbon,
Thirrma jote ku-ku-ku-ku!
Dhe gjithnjë ku-ku-ku-ku!

Dëgjon ti? Një çift plot zjarr
Gjithë mall pret në altar.
Në rininë plot shpërthim
Ka virtut e ka besim!
Por nuk erdh ora ende?
Thuaj sa do presim më?
Na dëgjon, moj kukëzë?
Por ti hesht e s'thua gjë?

---

*1) Edhe në folklorin gjerman, si dhe në folklorin e shumë popujve, qyqja apo kukëza me këngën e saj përcakton vitet e jetës së njeriut. Kujto për këtë vjershën e bukur të poetit arbëresh Z. Serembe, me titullin "Kukëza". Poezia "Orakulli i pranverës" është poezi tipike për periudhën e parë krijuese të Gëtes dhe njëkohësisht është një model i mbështetjes në mënyrë krijuese në gurrën e pashtershme të poezisë popullore, së cilës nisi t'i kushtojë vëmendje të veçantë, pas njohjes dhe miqësisë me Herderin.*

Por ne s'kemi fare faj,
Në dy vjet duron pastaj!
Por këtej kur të kalojmë,
Pa-pa-pa-pa do të kumbojnë!
Dhe sa shumë na gëzon,
Kur shumë vjet profetizon!
Kukëzë – ku, kukëzë – ku,
Ku-ku, ku-ku, ku-ku, ku-ku-ku!

Jeta festë gjithë gaz,
Kur s'të shemb asnjë tallaz!
Do më mbetesh pranë, mike,
Kaq e dashur e besnike?
Po ta di se kjo mbaron,
Do më shkas gjithçka në hon!
Kukëzë – ku, kukëzë – ku,
Ku-ku, ku-ku, ku-ku, ku-ku-ku!

# Elegji për vdekjen e vëllait të mikut tim

Në pyll të zymtë, atje tek lis i çarë,
Që keq rrufeja pat qëlluar,
Vëllanë tënd këndova zemërvrarë,
Që larg, në dhe të huaj kanë mbuluar!

Në mes shkëlqimit të rinisë
Për veprat priti një shpërblim,
Por vigu pandalim mes zisë
E mori me nxitim!

Nuk qave ti? Ty ndarja kaq e gjatë
Ta vodhi shpresën, s'do ta shohësh më.
Ta mori Zoti tej në qiell të lartë,
Ti s'di për ç'gjë zili ta kesh atë!

Por pa dëgjo! Ç'është ky zë,
Që më buçet, më kap llahtari?
Nxitoj e shoh, me të zemra gjithnjë
U kall nën plloça varri!

S'lëngoi një zemër dot kaq shumë,
Zot, shih përposh ç'dhimbje pa skaj,
Dhe fal për shkak lutjesh pa zhurmë
Ti jetën a vdekjen e saj!

O Zot ndëshkove dashurinë,
Ti që na ke kaq mirësi?
Nuk mundet për fatkeqësinë
Të ketë fat kjo dashuri!

Shpresoi me rroba martesore
Me të të vinte në altar,
Ia shkule, princ, me mllef prej dore,
Ç'tiran, ç'barbar!

O princ ti mund njerinë e mjerë,
Ta detyrosh jetën ngaherë
Të rroja për ty, në varfëri!
Por ti do shpirtin nën zinxhirë,
Për ty t'u dridhet me pahirë,
Kjo zgjon veç shqotë e mëri!

... "Si bir i tokës kokëfortë,
I yti, s'jam!" – foli ai –
"Nga frika vdekja ime të çliroftë,
Se më s'më mbet besnikëri!
Po shkoj, le të më qajë me lotë
Çdo shpirt i brishtë që e prek kjo gjë!
Krenare tirani, farmak,
Që të durova kot më kot,
Për vdekjen ti m'u bëre shkak,
E pafuqishme, mbathja larg!

# Ergo Bibamus[1)]

Këtu jemi mbledhur për qejf e gëzim,
Vëllezër, pra, *Ergo bibamus!*
Çdo gojë po hesht, çdo gotë tingëllin,
Pa rrokuni! *Ergo bibamus*!
E vjetër kjo fjalë e plot mençuri;
Ia vlen për fillim, vazhdim në gosti,
Shpërthen një kumbim nga ky vend tani,
Një e madhërishme, *Bibamus!*

E pashë miken time, më pa dhe ajo,
Mendova pra: *Ergo bibamus!*
Bri meje më rri, po shpejt fryn nga do,
Rënkoj dhe mendoj: *Bibamus!*
Dhe kur puthje e saj ndër zemra zgjon mall,
Dhe kur brengë e hidhur nën dhe ment iu kall,
Gëzohuni: *Ergo bibamus!*

Ky fat larg nga shokët më shtyn s'di për ku,
Pra ejani! *Ergo bibamus!*
Po ndahem e trastën mbështes pak mbi gju,
Dy heras pra: *Ergo bibamus!*

---

*1) Kjo poezi shpreh dashurinë për jetën. Tingëlloi si një kritikë e ashpër kundër asaj poezie që vërshonte ngado në Evropë e që ishte e mbytur nga ngashërimet dhe lotët. Jeta duhet gëzuar, sido që të vijë, thërret poeti.*

*Ergo bibamus, shprehje latine, që do të thotë* "le të pijmë"*! Pra, le ta gëzojmë jetën, sa të jemi gjallë.*

Koprraci ta fsheh në xhep çdo para,
Gazmori gazmorin huan, or vëlla!
Vëllezër, pra: *Ergo bibamus!*

Ç'të themi, mor shokë, më tepër për sot,
Do thoja veç *Ergo bibamus!*
Kjo ditë s'i ngjet një tjetre, miq, dot,
Prandaj dhe një herë: *Bibamus!*
Në ndjeni veç gaz, e hapur po rri
Kjo derë, dhe qielli shëndrit plot freski,
Na ndrit një fytyrë[1)] krejt gaz, dashuri,
Ne pijmë e këndojmë: *Bibamus!*

---

*1) Fytyra e perëndisë së gëzimit dhe e verës.*

# Festa e epifanisë[1)]

Tre mbretër të shenjtë, një yll u shkëlqen,
Po hanë, po pijnë, pagimin s'kanë qejf.
Po hanë me qejf, po pijnë me qejf,
Po hanë e po pijnë, pagimin s'kanë qejf!

Tre mbretër të shenjtë këtu erdhën sot,
Ata janë tre, katër, s'bëhen dot!
Sikur treshi katër të ishte, vëlla,
Një mbret krejt të tepër do kishim ndër ta!

Së pari isha i bardhë e perri,
Më shih në dritën e ditës flori!
Por, ah, megjithë erëzat që kam
Asnjërën nga vajzat s'e josha dot pranë!

Pastaj për kaq ditë e net në bojë kafe,
I dhënë pas këngësh e grash plot hare,
Në vend të erëzave u fala ar,
Kudo u prita me mall e me zjarr!

---

*1)* Festa e epifanisë – *Adhurim i magjistarëve. Gëtja paraqet këtu jo magjistarët ungjillorë, por studentët që këndonin dhe dëfrenin. Kjo poezi është plot thumba e satirë kundra fesë. Në të i këndohet gëzimit të jetës.*

Së fundi i zi, i pakët në shtat,
Porse gjithë gaz edhe harrakat!
Për qejf po ha, po pi plot me qejf,
Po ha e po pi e pagimin s'kam qejf!

Tre mbetërit e shenjtë po bredhin çdo kënd,
Të birin dhe nënën kërkojë në çdo vend.
Ku ndodhet Josifi, do ndodhet atje
Gomari dhe kau mbi kashtën përdhe!

U sjellim mirrë,[1] u sjellim ar,
Temjan për gratë plot nur e plot zjarr,
Dhe kemi verë safi e rubin,
Dhe pijmë të tre, sikur gjashtë po pijnë!

Na mblidhen kaq burra e gra tërë nur,
Gomarit e kaut s'i gjetëm kund gjurmë!
Kështu dot s'e gjetëm të shenjtin vend,
Ndaj udhën rish marrin të shkelim çdo kënd!

---

*1) Rrëshirë me erë të mirë.*

# Djali i pabesë

Na ish një djalë krejt pa turp,
Nga Franca kishte ardhë.
Një varfanjake, ah, se ç'çupë,
Shpesh grykas kishte marrë.
E kishte puthë e përkëdhelë,
Si i fejuar ishte sjellë
Pastaj e kishte lënë!

Kur e kuptoi vajza e mjerë,
I lojti krejt fiqiri,
Vajtoi e qeshi pikë e vrer,
U fik porsi qiriri.
Dhe sapo vajza na mbaroi,
Një frikë djalin e pushtoi,
Mbi kalë fort e hodhi!

Ia nguli shporret, edhe gjatë
U sul nëpër çdo udhë,
Këtu – atje, përposhë e lartë,
Pa gjetur prehje kurrë.
Plot shtatë ditë e shtatë net
Vrapon, gjëmon, veton, ç'qamet!
Nga brigjet ujrat dalin.

Rend. Vetëtimat ndizen zjarr.
Ç'rrënoja! Qull i ziu!
Lidh gjokun, brenda hiqet zvarr,
Të mbrohet pak nga shiu.
Dhe teksa ec e s'di nga shkon,
I çahet dheu si një hon
Dhe vrikthi shembet poshtë!

Dhe kur nga shembja u përmend,
Tri dritëza ndriçojnë.
Mbledh veten, s'i pëlqen ky vend,
Por dritëzat larg shkojnë.
Gabim e prijnë në çdo shteg,
Zbret, ngjit çdo shkallë e çdo hendek,
Bodrumet shkretë fare!

Dhe ja në sallë menjëherë.
Plot miq atje qëndrojnë,
Me sy të zgavërt, përngaherë,
Në festë po e ftojnë.
Dhe vajzë e bukur atje rri
Me tis të bardhë e plot stoli
Edhe i kthen kurrizin!

# Mbreti i pyllit

Kush ik nëpër pyll në natë e stuhi?
Ai është ati me çunin e tij!
E mban të shtrënguar e ngrohtë në krah
Merak e kujdesje për të mjaft po ka!

"Mor bir, pse fytyrën e fsheh tërë tmerr?"
- Baba, s'e sheh mbretin e pyllit në terr?!
Mbretin e pyllit me kurorë e kaftan? –
"Është mjegull, bir, e sjell era kaq pranë!"

"Fëmijëz i dashur eja gjer aty,
Se ç'lojëra do mund të luaj për ty,
Ç'lloj lulesh që ka atje në atë breg,
Nëna ime po të qep prej arit një petk!"

- Baba, or baba, baba s'dëgjon gjë,
Çka po më premton me ngulm e gjithnjë?! –
"Mos u gënje, i qetë rri, o bir,
Ndër gjethe fryn era, si qen ulurin!"

"S'do vish, ti, mor djalë, tek unë, tek shtëpia?
Me ç'mall po të presin ty bijat e mia!
Bijat që mes natës pa brengë e maraz
Vallëzojnë e këndojnë për ty plot me gaz!"

- Baba, or baba nuk sheh ti atje
Të bijat e pyllit krejt gaz e hare?! –
"Mor bir, mor bir, mjaft qartë po shoh,
Se ç'shelgje të vjetër e ç'lloh nëpër to!"

"Ta dua kaq tepër fytyrën, çun, unë!
Në s'vjen me të mirë, të marr me përdhunë!"
- Baba, or baba më kapi, ah, ç'tmerr,
Se ç'dhimbje, ç'llahtar në zemër më ther. –

Babai rrëqethet e kalin e shpon,
Shtrëngon fort fëmijën që hesht e rënkon,
Arrin mu në prak me mund e gulçim,
Pa frymë dergjej djali, pa zë e ankim.

# Peshkatari

Ujë fërrmon, ujët gufon,
Në breg i heshtur rri,
I qetë grepin e vështron,
Në zemër ndien freski.
Dhe si po rrin, përgjon e pret,
Më dysh ca kreshta vale,
Nga ujët që shkumon e shket
Del qull një shtojzovalle!

Ajo këndon, ajo i flet:
"Pse peshqit m'i rren ti,
Tek flakë e vdekjes ç'm'i thërret
Me lajka e dredhi?
Ta dije se me ç'gaz në fund
Rron peshku e noton,
Do bije, sikur je, bëlldumb,
Mes ujit që s'pushon!

A s'përtërihet diell i zjarrtë
Dhe hëna nëpër det?
A s'kthehen prapë në qiell lart
Më me shkëlqim e jetë?
A nuk të josh ty qiell i thellë,
I kaltër, i freskuar?
S'të josh fytyra jote e kthjellë
Në vesën e amshuar?"

Ujët fërrmon, ujët gufon,
Ia lag këmbën e zbathur.
Një mall në zemër e mundon
Si bri vajzës së dashur,
Ajo këndon me ëmbëlsi,
Dhe ja ç'ndodh, më në fund,
Pak ndjell ajo, pak shket ai,
Dhe më s'u pa gjëkund!

# Lulja më e bukur

*Kënga e kontit të burgosur*

KONTI

Unë njoh një lule plot freski,
Që shpirti fort ma don.
Me vrap do sulesha tani,
Por burgu s'më lejon.
Nga dhimbja vendi nuk më nxë,
Kur bridhja në liri gjithnjë
E kisha pranë meje!

Nga kjo kështjellë në rrëpirë
Vështrimin hedh përqark,
Dhe s'e kap lulen erëmirë
Që nga kjo kullë e lartë.
Kush do ma sjellë atë në dorë,
Kalorës apo shërbëtor,
I afërt do më jetë!

TRËNDAFILI

Po çel plot hir, gjithçka dëgjoj
Nëpër këto frengji.
Tek unë mendja mos të shkojë,
Kalorës që heq zi?
Kuptim të lartë ti po ke,
Më e bukura e luleve
Qëndron në zemrën tënde!

KONTI

Purpuri në të blertën veshje
I denjë për nderim,
Të duan vajzat ty pareshtje
Si perlën plot shkëlqim.
Kurora ndrin nga bukuria,
Por ti s'je lulja, mendtë e mia
Një tjetër adhurojnë!

ZAMBAKU

Krenar, i fryrë trëndafili,
Gjithnjë për lart synon,
Po një dashnor me zë bilbili
Zëmbakun e lëvdon.
Kujt na i rreh zemra në gji
Dhe është plot dëlirësi
Më çmon më tepër mua!

KONTI

Veten e ndiej krejt të dëlirë,
Pa faje të këqija,
Por lidhur në këto zinxhirë
Fort më mundon vetmia.
Ti je i qarti shëmbëllim
I vajzës që nuk ka ngjasim,
Kam tjetër më të dashur!

KARAFILI

Pra, do jem unë karafili,
Në kopshtin e rojtarit.

Për të kujdeset plak i mjerë
Edhe në mes të acarit.
Në rreth plot bukuri e fletë,
Plot kundërmim, freski e jetë,
Dhe me të gjitha ngjyrat!

KONTI

As karafili nuk përçmohet,
Rojtarit ç'gaz i sjell!
Tani në dritë e nxjerr të ngrohet,
Tani e mbron në diell!
Ajo që kontin lumturon,
S'është shkëlqimi që verbon,
Porse një lule e qetë!

VJOLLCA

Rri kryeulët dhe e fshehur
Dhe ndodh të mos flas gjatë,
Por duhet sot, krejt papandehur,
Për pak heshtjen ta çart.
O trim, sikur të jem, ah, unë!
Më vjen kaq keq e vuaj shumë,
Që dot s'ta çoj aromën!

KONTI

Të mirën vjollcë e çmoj tepër,
Me droje rron gjithnjë,
Dhe ç'erë ka, porse një tjetër
Do dhimbja që s'më lë.
Po ju rrëfej ç'më lodhi gjatë,

Nëpër këto shkëmbinj të thatë
Të dashurën s'e gjej!

Por atje poshtë, bri përroi,
Bredh më besnikja grua,
Dhe pshon, gjersa të më shikojë
Të lirë prapë mua!
Këput një lule që përdhé:
"Mos më harro!" thotë gjithnjë,
Unë larg kaq fort e ndiej!

Por edhe larg ndihet fuqia,
Kur fort duhen dy vetë,
Prandaj mes territ tek qelia
Kam mbetur plot me jetë!
Dhe kur të dhembi zemra nis,
"Mos më harro!" zë pështëris,
Dhe rish me jetë mbushem!

# Kalorësi Kurt shkon të martohet*)

Plot gëzim për në martesë
Dhëndri Kurt mbi kalë nget,
Të arrijë pa vonesë
Tek kështjellë e mikes shpejt!
Por mes shkrepave të shkretë
Një armik i del përballë.
Egër ndizet luftë e rreptë,
Pa ngurrim edhe pa fjalë!

Gjatë zjeu dallgë e luftës,
Gjersa Kurti qeshi pak.
Dhe ik tej me mallin ngutës,
Ngadhnjimtar e gjithë gjak!
Por ç'po sheh atje, papritur,
Mes kaçubesh, ç'zbardh e ç'del?
Me një foshnje, yll i ndritur,
Një shtathedhur pyllit shkel!

I bën shenja që nga vendi:
"Mos rend kaq e ndalo pak!
Fali, o imzot, gjësendi
Djalit tonë njomëzak!"
Zjarr i ëmbël dashurie,

---

*) Kalorësi Kurt shkon të martohet – *Bazën e baladës e përbën një udhëtim i vërtetë, që na e përshkruan në kujtimet e veta baroni francez Basompjerr (Shekulli XVI).*

Që s'e kishte ndjerë kurrë,
Nis e djeg, nën gjeth, nën hije,
Ngjan mëndesha plot me nur!

Po dëgjon, bie borija,
Befas nusen sjell ndër mend,
Dhe çan udhë e çan dëllinja,
Festë, tregje në çdo kënd.
Ndër dyqane nis të zgjedhë
Pengje për miken e vet,
Por një zhgan çifutësh erdh,
Kërkon borxhet e bërtet!

Mjaft pengesa nxjerr gjykata,
Gjyqet zgjaten pa kufi.
Ah, ç'dreq histori të gjata,
Ç'jetë plot me trimëri!
Duhet sot zjarr të mos marrë?
Ç'shqetësime të mëdha!
Borxhe, gra e kundërshtarë
S'ka kalorës që nuk ka!

# Këngë dasme

Ia morëm shpesh këngës e folëm me zjarr
Për kontin që më këtu s'ndodhet.
Në dasmën e nipit të tij kanakar
Për gaz e gosti miqtë mblodhëm.
Në luftën e shenjtë luftoi gjer larg,
Dhe nder na fitoi me mund e me gjak,
Dhe gjokun kur ndali plot mall mu në prak,
E gjeti kështjellën e vetë
Pa njerëz, pa kamje, të shkretë!

Por ja tani, kont, ti je në shtëpi,
Shtëpinë mjaft keq e ke gjetur,
Dritareve era gjëmon, ç'batërdi,
Ndër dhoma vrapon si e çmendur:
"Si mundet t'i shtyj dot netët vjeshtake?
Mjaft keq e kam pasur në shi e batake,
Por zbardhte e qielli s'kish re zemërake...
Pra, shpejt, teksa hëna ndrin jashtë
Në shtresa, në shtrat, përmbi kashtë!"

Dhe ndërsa dremiste me ëndje, nën shtrat
Lëvriu diçka si fllad ere.
"Ky mi do të jetë! – mendoi – se ç'fat
Të kishte një copë kothere!"
Vështron, ja po ngrihet një burrë imcak,

Një xhuxh me një llambë që ndrin rreth e qark,
Me gjeste e fjalë të urta si plak,
Te këmbët e kontit të mekur,
Që s'flinte, por desh për të fjetur!

"Ne festat i bëmë këtu varg e varg,
Që kur ti braktise shtëpinë,
Dhe duke besuar që ti endesh larg,
Menduam të nisim gostinë.
Dhe nëse pranon e ke pak dëshirë,
Do mblidhen shpejt xhuxhat këtu për të pirë,
Për nderin e nuses të pasur, të mirë!"
Dhe konti në gaz ëndërrimi:
"Këtu le të krisë dëfrimi!"

Dhe ja tre kalorës mbi kuaj dori,
Që poshtë nën shtrat po qëndronin,
Pastaj ia beh kori plot këngë e stoli,
Plot hoka që gjindjen gëzonin.
Karroca karrocën e ndjek, nget e nget,
Sa mendja vërdallë të vjen fare lehtë,
Kaq veç tek kështjella një mbret mund të ketë!
Pastaj në koçinë e praruar
Erdh nusja e miqtë e ftuar!

Të gjithë vërsulen me turr e galop
Një vend për të zënë në sallë,
Dredhojnë e kthehen, kërcejnë një hop,
Të zgjedhin për valle një dasmë.

Vjoli e zurna, gjëmim, bubullim,
Trokitje e thirrje, plot shfrim, pështjellim,
Që vijnë e shuhen e rish me tërbim
Shpërthejnë. Sheh konti i shkretë
Si kapur nga ethet, i zbehtë!

Përplasje, gajasje, rrëzim, çmenduri
Nga banka, tryeza, karrike.
Secili kërkon në këtë gosti
Të ketë ndaj vetes një mike.
Dhe sjellin proshutka, dhe sjellin sallam,
Dhe mish, edhe peshk, dhe shpezë me nam,
Dhe verë të shijshme nga çdo damixhan.
Gjëmime, miklime, gjer gjatë,
Në fund kënga mbyll këtë natë!

Por ne do këndojmë se ç'ndodhi më tej.
Të heshtë ky harbim, kjo rrëmujë!
Ç'ka pa kaq të vogël më parë këtej,
E rron të zmadhuar, plot bujë!
Trumpeta, fanfarë, zurna edhe kor,
Karroca, kalorës, rrëke me dasmorë,
Vërshojnë, përkulen krejt nur në oborr,
Pa numër, se ç'njerëz gazplot,
Po ikin dhe vijnë dhe sot!

# Gërmuesi i thesarit*)

Qesezbrazur, zemërthyer,
Zvarras heq ditët e mia,
Ç'helm e vrer kjo varfëria,
Pasuria çan çdo prak!
Brengën copash për ta shqyer,
Shkoj, rëmoj, kërkoj thesare:
"Shpirtin tim ta fal për fare!",
Shkrojta ja këtu me gjak!

Dhe kaq rrathë i vizova,
Dhe nga kocka e fije bari
Mori hov e shkrepi zjarri,
Shpejtas bëra përbetim.
Pas mënyrës që mësova,
Mora shat për të rëmuar
Mu në vendin e shënuar,
Nxinte nata plot gjëmim!

Dhe nga larg shoh, i mahnitur,
Ç'vjen si yll dhe ç'përparon,
Poshtë nën qiell që bubullon,
Ora dymbëdhjetë ra!

---

*) Gërmuesi i thesarit - *Te balada "Gërmuesi i thesarit", shkruar në Jenë më 1797, poeti vë përballë njohjeve të errëta dhe antishkencore besimin e thellë në punën e përditshme dhe në gëzimet e thjeshta të jetës.*

S'isha fare i gatitur,
Ndriti terri i nemitur
Nga një kupë rrezendritur
Që një çun në dorë e ka!

Ç'mirësi sy i dëlirë,
Ç'lule balli i menduar!
Ja, me kupën e praruar
Po më hyn këtu në rreth!
Më grish ëmbël për të pirë,
Tek mendoj: "Ky çun që vjen
Me dhuratën që shkëlqen,
S'është djalli që na ngjeth!"

"Pi guxim e vrull gazplot!
Veç kështu kupton mësimin,
Mos u kthe me përbetimin
Plot me ankth në këtë vend!
Mos gërmo kot e më kot!
Ditë punë e natën miq!
Larg magjira e të liq!
Këto fjalë i ngul në mend!"

# Gjahtari i minjve*)

Pra, jam i njohur fort si këngëtar,
Por shpesh i njohur fort dhe si gjahtar,
Që ky qytet i madh edhe i vjetër
E ka të domosdoshëm si asnjë tjetër,
Dhe le të ketë minj edhe më shumë,
Dhe nuselalet le të vijnë lumë,
Nga to krejt vendin e pastroj mjaft mirë,
Dhe bredh pastaj me gaz edhe dëshirë!

Ky këngëtar që fatin e përqesh,
Edhe gjahtar fëmijësh bëhet shpesh.
Fëmijtë e prapë zap i bën në çast,
Përralla kur u thotë buzagaz!
Dhe le të ketë çuna shpirtkrenarë,
Dhe le të ketë vajza prush e zjarr,
Porsa ia prek pak telat harpës lehtë,
Pas meje sulen, turren me të shpejtë!

---

*) Gjahtari i minjve – *Poeti e shkroi këtë baladë për një balet fëmijësh. Balada ka lidhje me legjendën e njohur gjermane që tregon për një djalosh, i cili me fyellin e tij shpëtoi një qytet prej minjsh. Por, mbasi nuk i dhanë shpërblimin e premtuar, ai, për hakmarrje, mori të gjithë fëmijët e qytetit dhe i humbi duke i magjepsur me fyellin e vet. Saga është shumë e vjetër. Poeti me këtë baladë na ka dhënë një parodi të lehtë gazmore të kësaj sage.*

Ky këngëtar që  bredh dimër e verë
Dhe vajza gjuan me trysni mjaft herë,
Dhe s'gjen këtej asnjë qytezë  dot,
Ku gjurmën nuk e la ky çamarrok!
Dhe le të ketë vajza ndrojtëtare,
Dhe le të ketë gra si akull fare,
Të gjitha ndjejnë flakë dashurie,
Sa këngën zë, sa harpës nis i bie!

# Tradhtia e mullinares

Nga vjen pa ikur dritë e yllit,
Pa zbardhur dita në agim?
Mos ish në kishëzën mes pyllit,
Në kaq të ftohtë e thellim,
Çuditet lumi përtej vreshtit,
Tek zbathur rend e pluhur ngre,
S'përfill të mirat e mëngjezit,
Ndër krepa bore gjithë re!

Ah, po! U hodh nga shtrat i nxehtë,
Kur tjetri ta përtalli desh
Mos kish këtë mantel të lehtë,
Do turpërohej, djali keq!
Na e mashtroi ai zuzari,
Ia mori teshat pabesisht,
Dhe doli ku të pret acari,
Porsi Adami lakuriq!

Dhe u zvarrit ndër këto vraga,
Prapa dy mollësh plot freski,
Që në mulli si te parajsa
Ngrihen me gaz e bukuri!
S'do bëjë më këto shakara,
Nga kjo shtëpi shpëtoi, për fat,
Zë flet e mënt e kap e qara,
Tek rend mes gërxhesh shpat më shpat!

"S'lexoja ndër sytë plot zjarre
As dhe një shenjë për tradhëti,
Pas meje sikur çmendej fare,
Por kish në mendje poshtërsi!
A mundej vallë kush të besonte,
Se kish në gji kaq zi e llum,
Ajo Amorin e vononte,
Ai plot hir sillej gjithkund!

Të ma shijonte dashurinë
Krejt natën që s'mbaronte dot,
Të zgjonte nënën e shtëpinë,
Veç kur erdh agu rrezeplot.
Brenda m'u sul krejt farefisi,
Një zhgan plot fjalë të mëdha,
Se ç'kushurinj, ç'teto bitisën,
Erdh një vëlla e një xhaxha!

Bërtitnin egër e harbonin
Si bisha gjithë hakërrim,
Lulet e vashës i kërkonin
Drejt e përdrejt nga trupi im!
Pse turren porsi të shkalluar
Mbi djalin që s'ju ka një faj?
Ai thesar për t'u fituar,
Duhej një shkathtësi pa skaj!

Amori erdhi plot pekule,
Ta luajë lojën e vet
Dhe në mulli të tilla lule
S'i lë shtatëmbëdhjetë vjet!

M'i morën krejt rrobat e mia,
Por deshën dhe këtë mantel.
Si mundi të zinte shtëpia
Kaq zarbo, nga mendja s'më del!

Plot me tërbim e menjëherë
U hodha, mos më ndalnin dot.
E pashë atë edhe një herë,
Dhe ah, ish prapë e bukur fort!
Plot mllef i zmbrapsa, me sfilitje,
Po fjalë e tyre ende ther,
Dhe me të shara, me bërtitje,
Unë u shkëputa nga ky ferr!

Do ndenjur nga ju vajza fshati,
Nga ju vajza qyteti larg,
Shërbyesit rrobat nga shtati
T'ia çveshin zonjat në pallat!
Veçse në paçi pak nevojë,
Në s'njihni asnjë detyrim,
Dashnorët i përdorni prorë,
Por t'i tradhtoni ah, ç'mallkim!"

Kështu këndon nëpër shtërngatë,
Ku bar e gjeth kund nuk bleron.
Ia tall e qesh të thellat plagë,
Që ky aspak s'i meriton.
Dënim si ky marrtë shpirtnxiri,
Fisniken mike që gënjen,
Dhe natën ngjitet tek mulliri,
Si Amor kallp vjen e dëfren!

# Kambana që ecën*)

Ish një çunak që s'desh aspak
Në kishë që të shkonte,
Dhe çdo të diel na gjente shkak
Ndër ara të vraponte.

Nëna i thosh: "Këmbana ra!
Kjo urdhër le të jetë!
Nëse s'dëgjon, nuk bëj shaka,
Zbret, të të marrë vetë!"

Djali mendon: Këmbana rri
Mbi tra, s'e shkul as shqota,
Dhe fushës merr plot gaz në gji,
Sikur po ik nga shkolla!

Tani këmbana s'ndihet më,
Keq nëna desh të tallet.
Ai, ç'tmerr, sheh, prapa, ajmé,
Këmbana rend e s'ndalet!

---

*) Kambana që ecën – *Frymëzimi për këtë baladë i erdhi Gëtes nga një shaka që i biri, Augusti, dhe kujdestari i tij, Rimeri, kishin bërë me një djalë të vogël, i cili frikësohej nga zëri i kambanës. Balada ka një ton tregimi për fëmijë, një farë toni didaktik. Por së bashku me këtë ton didaktik ka edhe frymën e një vjershe-shaka, aq të zakonshme në shumë krijime të Gëtes.*

Lëkundet shpejt, sa dot s'beson,
Ç'llahar! I erdh tek ana!
Vrapon, si nëpër ëndërr shkon,
Po e mbulon këmbana!

Po shket e del e sulet vrap
Me turr mbi bar e shpendra.
Çan pyje, fusha, pellg e trap
Dhe hyn në kishë brenda.

Dhe çdo të diel e çdo kremtim
Gjithçka e kujton mirë,
Sa nis këmbana me gjëmim,
Nuk pret kush për ta thirrë!

# Ekarti besnik*)

"Të ecnim, të ishim tani tek shtëpia!
Po vijnë, vjen hija e natës, lubia!
Ato janë motrat shpirtliga!
Përbri na kaluan, këtu, ja mbërrinë,
Krejt birrën që morëm me mund do na pijnë
Dhe bosh do na mbetet çdo shtëmbë!"

Kështu folën çunat, u strukën, papritur,
Por para u doli një plak zemërndritur:
"Të qetë, fëmijë, të qetë!"
Po kthehen nga gjahu plot etje ato,
Në lini secilën të pijë sa do,
Shpirtligat do bëhen shpirtmira!"

Ç'u tha, shpejt u bë! Dhe ja po vjen hija,
Plot etje, e zymtë, ç'të zë lemeria!
Thëthin e përpin e dot s'nginjet.
U zbraz krejt çdo shtëmbë, nuk mbet pikë birrë,
Ushtri e tërbuar bredh në errësirë,
Vikat nëpër lugje e male!

---

*) Ekarti besnik – *Ashtu si balada "Kambana që ecën" edhe kjo ka tonin didaktik të një tregimi për fëmijë. Subjektin e saj ia tregoi Gëtes sekretari i vet. Ky tregim ishte i njohur në atë kohë dhe kalonte gojë më gojë. Ekarti është një figurë kreshniku dhe mirëbërësi e nxjerr nga sagat heroike. Fantazia populloree paraqet si plak me mjekër të bardhë që, kur turma e shpirtrave të këqinj zgjohet në netët me furtunë dhe u fut tmerrin njerëzve ngado që kalon, ai prin para saj dhe i lajmëron të gjithë ata që takon rrugës, të ikin ose të rrinë të qetë.*

Fëmijtë po kthehen tek strehët me vrap,
Ekarti nga pas i ndjek çap më çap:
"O kukllëza, mos u trishtoni!
E marrim me vete çdo sherr e të çjerrë,
Mjaft mirë do shkojë çdo gjë këtë herë,
Veç heshtni e hiç mos bëzani!

Kush ju këshillon, kush ju urdhëron,
Fëmijtë i do, me ta shpesh lodron, -
Ky është besniku Ekart!
Për të mjaft çudira dëgjuat përherë,
Por s'patët gjer sot një provë një herë,
Tani ju e kini ndër duar!"

U kthyen ndër vatra me shtëmbat në krah,
Çdo prindi secili me frikë ia dha
Dhe prisnin goditje dhe sharje!
Dhe njeri ia priti: "Se ç'birrë flori!"
Dhe tri katër herë me radhë e pi,
Dhe shtëmbës s'i gjendej dot fundi!

Dhe zgjat kjo çudi sa zbardh nëpër kreshta,
Dhe pyeti kush s'iu shua kureshtja:
"Ç'po ndodh kështu sonte me shtëmbat?!"
Dhe qeshën fëmijët e heshtën një ças,
Pastaj dërdëllitën e folën çapraz
Dhe befas shterroi çdo shtëmbë!

Andaj kur, fëmijë, me sy plot besim,
Babai e ndokush ju flet plot shpresim,
Dëgjoni e bëni ç'ju thonë!
Mos lini ju gjuhën çdo gjë për të shirë,
Dërdëret të dëmshme, heshtja ç'gjë e mirë!
Dhe birra s'do shterri ndër shtëmba!

# Nata e parë e Valpurgës

NJË DRUID

Ja, maji erdh
Në pyll përreth
S'ka akuj, pellgjet s'ngrijnë.
Bora u shkri,
Në lug e vërri
Kaq këngë oshëtijnë!
Por bora, a sheh,
Ndrin majave,
Atje le të nxitojmë!
Ta nisim, miq, të lashtin rit,
Tënzot të lavdërojmë!
Mes tymit flaka çan e ndrit,
Kështu zemrat gufojnë!

DRUIDËT

Mes tymit flaka çan e ndrit,
Ta nisim, miq, të lashtin rit,
Lavdi atit të shenjtë!
Përpjetë e më përpjetë!

NJË NGA POPULLI

Përse kaq shtrembër po veproni?
Doni pas vdekjes që të shkoni?!
S'i njihni ju ligjet e rrepta
Të xhelatëve barbarë?!
Rreth e qark hodhën kaq rrjeta

Për paganë e mëkatarë.
Ah, mbi ledhe bëjnë kërdinë
Përmbi gratë e fëmijtë!

KORI I GRAVE

Përmbi ledhin e fushimit
Po na therin bijtë tanë.
Ah, ç'mizorë e shpirtkatranë!
Na pret çasti i mbarimit!

NJË DRUID

Kurbanin sot
Kush s'e çon dot
Kërkon vargonj e pranga!
Se ç'pyll këtu,
Pa sillni dru,
Që mos na shuhet flaka!
Të fshihemi,
Mos njihemi,
Nën gjeth ditës, të qetë!
Për roje të zgjedhim një trim,
Kujdes për ne të ketë,
Pastaj detyrën plot gjallim
Do ta përballim vetë!

KORI I ROJAVE

Përhapuni, o burra trima,
Nëpër krejt pyllin plot me kthina,
Edhe përgjoni ju gjithkah,
Detyrën të mbarojnë ata!

Për paganë e mëkatarë.
Ah, mbi ledhe bëjnë kërdinë
Përmbi gratë e fëmijtë!

KORI I GRAVE

Përmbi ledhin e fushimit
Po na therin bijtë tanë.
Ah, ç'mizorë e shpirtkatranë!
Na pret çasti i mbarimit!

NJË DRUID

Kurbanin sot
Kush s'e çon dot
Kërkon vargonj e pranga!
Se ç'pyll këtu,
Pa sillni dru,
Që mos na shuhet flaka!
Të fshihemi,
Mos njihemi,
Nën gjeth ditës, të qetë!
Për roje të zgjedhim një trim,
Kujdes për ne të ketë,
Pastaj detyrën plot gjallim
Do ta përballim vetë!

KORI I ROJAVE

Përhapuni, o burra trima,
Nëpër krejt pyllin plot me kthina,
Edhe përgjoni ju gjithkah,
Detyrën të mbarojnë ata!

NJË ROJE

Këta priftërinj trutharë
Me mashtrim t'i heqim zvarrë
Dhe me djallin që na tallin
Frikë e tmerr në gjak t'u kallim!
Ejani, me cfurk e shatë,
Me vravashka, me purteka,
Bëni zhurmë nëpër natë
Ndër ngushtica e ndër shkrepa.
Kukuvajkë e ti huti,
Tok me ne fort uluri!

KORI I ROJAVE

Ejani me cfurqe e shata
Porsi djalli plot mandata,
Me shkopinj e me purteka,
Ndër ngushtica e ndër shkrepa!
Kukuvajkë e ti huti
Tok me ne fort uluri!

NJË DRUID

Ç'mëkat, o atë,
Që nëpër natë
Ty fshehtas të këndojmë!
Po dritë e gaz
Dhe në tallaz
Ka zemra që blatojmë!
Armikut sot
Madje dhe mot
Ti mund t'i japësh ndihmë!

Nga tymi u dëlir kjo flakë,
Na e dëlir besimin!
Dhe në u vodh zakon i lashtë,
Kjo dritë s'ta zbeh ndriçimin!

NJË ROJE E KRISHTERË

Ndihmë, ndihmë, luftëtarë!
Ah, se ç'ferr edhe ç'llahtar!
Të magjepsur, si ndër ëndrra,
Në mes flakësh po shkëlqejnë
Ç'burra ujq e ç'gra kuçedra,
Që pareshtur vinë e venë!
Ah, ç'potere e ç'llum moçali,
Luani, një shteg të gjejmë!
Flakëron e klith lart djalli!
Dhe nga dheu
Ç'duhmë ferri që shpërtheu!

KORI I ROJAVE KRISHTERE

Të magjepsur, si ndër ëndrra,
Burrat ujq e gra kuçedra!
Ah, ç'poterë e ç'llum moçali!
Shih si flakëron tej djalli,
Dhe nga dheu
Ç'duhmë ferri që shpërtheu!

KORI I DRUIDËVE

Nga tymi u dëlir kjo flakë,
Na e dëlir besimin,
Dhe pse u vodh zakon i lashtë,
Drita s'ta zbeh shkëlqimin!

# E fejuara prej Korintit

Nga Athina në Korint nxitonte
Një djalosh, që nuk njihej ende,
Një banor atje desh të takonte,
Etërit u deshën, lidhën be.
Në gosti e gaz
Thanë djalë e vajzë
T'i martojmë që kërthi sot ne!

Në nderimin s'do ta blejë shtrenjtë,
Do ta presin plot gëzim e zjarr?
Vajza dhe të sajët të krishterë,
Kurse ky pagan mbet si më parë.
Mbin besimi i ri,
Besë e dashuri
Shkul nga zemra si të keqin bar!

Dhe tani shtëpia hesht e qetë,
Baba, vajza ranë, nëna s'fle,
Buzagaz e pret mikun e shtrenjtë
Dhe e çon në dhomën më të re.
Verë dhe ushqim
I sjell pa përtim.
"Bëfsh gjumë të lehtë!" i flet nën zë.

Por as dhe mes gjellëve të mira
S'e ngacmon uria, s'gjen rehat.
Lodhja s'sheh të ngrëna e të pira,

Rrobeveshur shtrihet në krevat.
Dhe si ra të flerë.
Sheh diçka në derë,
Që çaplehtë shkel e s'rri në prak!

Dhe vështron nën dritë llampe qartë
Si me rroba e me tis dëborë,
Me një rrip në ballë, të zi e të artë,
Hesht një vajzë yll dhe e përkorë!
Dhe sapo e sheh
Dorën lart e ngreh,
Trembur, plot habi në kraharor!

"Kaq e huaj qenkam në shtëpi,
Sa nuk ditkam – thotë – se kush vjen?
Ah, sa kohë pshoj në burg të zi!
Dhe këtu një turp keq më mbërthen.
Çlodhu e pusho,
Në krevat qëndro,
Ika, sikur hyra, si veri!

"Rri, moj vajzë e bukur!" thërret djali,
Dhe nga shtresat ngrihet me të shpejtë.
"Këtu Ceres,[1] Baku[2] gjithçka fali,
Dhe ti dashuri më sjell në jetë!
Mos u zbeh kështu,
Eja, rri këtu,
Të shijojmë ç'gaz nis e çel fletë!"

---

*1) Ceresi – perëndesha e drithit, e bukës;*
*2) Baku – perëndia e verës.*

"Rri larg meje, djalë! Më nuk mundem
Që të ndiej mall e ngazëllim!
U hodh hap i fundit, dot s'lëkundem,
Që kur nëna dergjur në lëngim
Jetë dhe rini,
Me betim, kllapi,
Zotërve m'ia fali për shërim!

Dhe vargan prej zotërsh të dikurshëm
Strehën tonë la krejt në harrim,
Lart në qiell sundon një i padukshëm,
Që në kryq i bën turma nderim.
Ndër kurbane s'ka
Qingja apo ka,
Por flijime njerëzish, ç'trishtim!"

Zë e pyet dhe peshon çdo fjalë,
Dhe nuk lë asnjë t'i humbë kot.
"Mundet vallë befas të më dalë
Ja, këtu, eh, nusja hireplot?
Je e imja ti,
Ç'gaz e ç'dashuri,
Besë e etërve na lidhi fort!"

"Mos më mbaj këtu, djalosh i mirë,
Motrën të blatoj! Por ç'po ke ti?!
Tek lëngoj në burg e lagështirë,
Më kujto, kur tjetrën rrok në gji!
Kush për ty mendon,
Digjet dhe të don,
Tokë e ftohtë shpejtas e bën hi!"

"Jo! Për këto flakë të betohem.
Himeni[1] shpirtdritë na ndrit ne!
Gaz do kesh, shpejt hijet do mërgohen,
Në shtëpi të tatës, nuse e re!
Rri, e dashur, rri,
Tok plot dashuri,
Të festojmë dasmën plot hare!"

Shpejt këmbejnë shenja, ndrit krejt vendi,
Vajza një zinxhir prej ari i fal.
Dhe ai një kupë prej argjendi
Me art të punuar e të rrallë!
"Jo, kjo s'bën për mua,
Nga flokët e tua
Një baluke premë ti, o djalë!"

Porsa ora ra, ik natë e shkretë,
Ngjan sikur veç gaz në sy i ndrit!
Plot lakmi e etje gojë e zbehtë
Vetëm verë ngjyrë gjak gëlltit!
Por nga bukë e grurtë
Që ky djalë i urtë
Na e lut të marrë, çapë s'shqit!

Djali kupën ia lëshon në dorë,
Si ajo pi etshëm plot lakmi,
Dashuri mes darkës kërkon prorë
Dhe plot mall i rreh zemra në gji.

---

*1)* Himeni – *perëndia e martesës.*

Ajo kundërshton,
Dhe pse lutet, pushon,
Gjersa ra në shtrat me lot në sy!
Ajo vjen, i hidhet nëpër krahë!
"Ah, me ç'helm ta shoh dhimbjen! Ajmé!
Plot me tmerr do ndiesh se ç'po të fsheh!
Bardhë si dëborë,
Akull kraharorë
Mikja jote që përbri e ke!"

E shtrëngon mes krahëve të fortë,
Vrull i dashurisë e rrëmben!
"Dhe sikur të vish nga varr i ftohtë,
Pranë meje flakë malli ndien!
Puthje, ngazëllim!
Ndjenja në vërshim!
Ç'digjesh, kur ndër dej zjarr më shpërthen!"

Të dy tok i lidhi dashuria,
Pikë lot vesojnë nëpër gaz.
Lakmitare prej buzësh të tija
Flakë thith e s'nginjet as një çast!
Vrullshëm kjo dëshirë,
Ngroh gjakun e ngrirë,
Por në zemër s'ngre asnjë tallaz!

Dhe ndërkaq ngadalë si çdo natë
Nëna vjen edhe andej kalon.
Po përgjon tek dera, përgjon gjatë,
Ç'zëra të çuditshme po dëgjon!

Mbushet me maraz,
Se ç'lëngim, se ç'gaz,
Ç'belbëzim pasioni që harbon!

Rri në derë e shtangur prej habie,
Do të bindet se ç'po ndodh atje,
Dhe dëgjon betime dashurie,
Fjalë ledhatare, ç'ndoht, ajmé!
"Hesht, gjeli këndon!"
"Kur të perëndojë,
Prapë eja, moj nuse e re!"

Nëna gjatë dot s'e mban tërbimin,
Bravën çel me ngut si erë e rreptë:
"Paskam vajza që sjellin çnderimin,
Që të huajit iu jepkan lehtë?!"
Sulet, hyn në derë,
Zbehet menjëherë,
Sheh, për tmerr, atje vajzën e vet!

Dhe djaloshi në trembjen e parë,
Me tisin e saj e me qilim
Do të fshehë miken ledhatare,
Por ajo shkëputet me rrëmbim.
Si shpirt plot fuqi,
Ngrihet, ç'bukuri,
Mengadal nga shtrati pa shtangim!

"Nënë! Nënë!" zëdrobitur thotë
"Ti ma prishe natën plot gëzim?!
Më dëbon me mllef nga vendi i ngrohtë!

Mos kam lindur veç për dëshpërim?!
A nuk ju mjafton,
Që kaq shpejt, të njomë,
Mu në varr më kallët, pa ngurrim?!

Por dhe nga ngushtica më mizore
Ligj i jetës lart shtyn me vërtik.
Lutja edhe kënga priftërore
S'ka fuqi mbi zemrën asnjë çikë!
Dhé e kripë kot
Mos trazo se dot
Toka s'ma fik zjarrin që zhurit!

Më premtuat mua këtë djalë,
Kur Venusin mbanin në altar,
Nuk e mbajtët ju të shenjtën fjalë,
Besë e rreme lidh e iu heq zvarr.
S'ka një zot askund,
Të dëgjoka kund,
Sesi nëna qenka shpirtacar!

Dal nga varr i ftohtë e i nxirë,
Të kërkoj gëzim e dashuri,
Burrin tim të humbur e të mirë
Edhe gjak të pi nga zemra e tij.
Kur me të mbaroj,
Tek një tjetër shkoj,
Dhe sa djem që shemb nga kjo furi!

Djalë i hijshëm s'do të rrosh më gjatë,
Do të dergjesh shpejt në këtë vend!

Ty të dhashë një zinxhir të artë,
Vetë mbajta kaçurrelin tënd!
Shihe mirë ti,
Nesër – ngjyrë hi,
Por siç qe do duket, mik, njëmend!

Nënë ma dëgjo të fundit lutje,
Ndizna turrë drush, pa ngashërim,
Arkëzën ma hap, pa tutë e ngutje,
Në mes flakësh shpirti gjen pushim!
Nëpër tym e hi
Lart do ngjitemi
Tek të lashtët zotër me nxitim!"

# Elegjitë romane

## I.

Flitmëni, o gurë dhe hapni gojën pallate të larta,
Rrugë, nxirrni një fjalë! Genius, s'po bëhesh i gjallë?
Po, një shpirt e ka çdo mur i yt i shenjtë,
O Romë e përjetshme! Po për mua gjithçka po hesht!
Kush më pështpërit, në cilën dritare e shoh
Krijesën e bukur që më ngroh e më përtërin?
Nuk kam asnjë kujtim nga udhët ku shpesh e më shpesh
Shkoj e vij tek ajo dhe kohën e çmuar e bjerr?
Shoh kisha dhe pallate, rrënoja dhe kollona,
Si një njeri me mend që nxjerr nga to disa mësime.
Shpejt do të shuhet gjithçka, por një tempull do të ngrihet,
Tempulli i **Amorit,** ai që pret të lumturit.
Një botë je ti, o Romë, por pa dashuri
Bota nuk është botë, as Roma nuk është Romë!

## II.

Nderoni kë të doni? As që e çaj kokën për këtë!
Zonja të hijshme dhe ju zotërinj kokoroshë e mondanë!
Më pyetët boll për ungjin, për tezet dhe për farefisin,
Dhe me këtë lojë sikur doni të shtyni kohën.
Po iki larg, larg jush, qarqe të vogla e të mëdha,
Që shpesh ma vratë shpirtin dhe dëshpërim m'i kallët.
Përgojoni ndonjë nga mendimet e mia politike,
Për të cilat të ndjekin me tërbim nëpër Evropë.

Kështu e ndiqte kënga "Malbruh" shtegtarin britan,
Nga Parisi në Livorno, nga Livorno në Romë,
Madje deri në Napol. Të kish vozitur për në Izmir,
Malbrohu, do t'i qepej dhe në liman do ta mbërthente.
Kështu m'u desh dhe mua në çdo çap të dëgjoja
Sharjet e turmës dhe sharjet e hidhura të mbretit.
Tani, kaq shpejt mos më zbuloni në strofkën ku jam futur,
Ku Sovrani Amor më fal mbrojtjen mbretërore
E më mbulon me flatrat e dashura romane,
Nuk ndien as grimë frike nga gali zemërak;
Nuk më bezdis për lajme, por përgjon me përkujdesje
Çdo lloj dëshire burri, të cilit i jepet,
Çdo gaz i saj – dhe yti, shtegtar i huaj e i lirë
Që i tregon për malet, për dëborën dhe kasollet,
Që nga flakët që të ndezi në shpirt ngrohet dhe vetë,
Dhe gëzohet që s'e çan kryet për paratë si romanët.
Tryeza e saj rri shtruar sot më mirë se çdo herë,
Dhe s'i mungojnë as veshjet, as karrocat për në opera,
Nënë dhe bijë gëzohen për mikun nordik të tyre
Dhe barbari ndihet zot mbi gjoksin e trupin e romanes.

**III.**

Mos u pendo, e dashur, që kaq shpejt mua m'u dhe!
Besomë, për t'y s'mendoj as me keqdashje e as me përbuzje!
Shigjetat e Amorit s'veprojnë një lloj, ndonjë gërvisht,
Nga helmi i ngadaltë me mote zemra heq e vuan.
Tjetra më e fuqishme, me majë sapo të mprehur,
Depërton gjer në palcë dhe vrullthi ta ndez prush gjakun!
Në kohërat e heronjve, kur dashuroheshin zotat.
Dëshira ndiqte vështrimin, dëshirën kënaqësia.
Kujto, gjatë nuk mendoi për dashurinë perëndesha,
Kur në pyllin e Idës Ankizin pëlqeu një ditë.

Po të vononte Hëna bariun plot hir ta puthte,
Shpejt e me zili Aurora kishte për ta zgjuar.
Heros e pa Leandrin mes festës dhe me nxitim
Dashnori i zjarrtë u hodh mes dallgëve të natës.
Rea Silva, vajza virgjëreshë e mbretit, sapo zbriti
Në Tiber të mbushte ujë e rrëmbeu vrikthi Zoti.
Kështu të bijtë lindi Marsi. Pijnë bonjakët
Tek ulkonja, dhe Roma quhet mbretëreshë e botës!

**IV.**

Ç'dashnorë të mjerë jemi, heshtas nderojmë dhe demonët,
Dhe të mirën ia duam çdo zoti e perëndeshe.
Juve ju përngjasim ne, ngadhnjyes romakë. Perëndive
Të të gjithë popujve u dhatë ju strehim,
Qofshin të zinj e të vrazhdë nga krepat e lashtë të Egjiptit,
Qofshin bardhë e borë e të hijshëm nga mermeri i Greqisë.
Mos u ofendoni, të përjetshëm, kur të kapulluar
Nga flakë e perëndishme, djegim nga temjami më i çmuar.
Po, ju njohim mirë, prandaj lutjet dhe shërbimet
Tona të përditshme një perëndie ia blatojmë,
Dhe pse tinëzakë, plot etje për qejfe e të vrazhdë
Fshehtas kremtojmë edhe pas gjurmëve Erinitë me krime
I joshim e herë guxojmë të vuajmë dënimet e Zeusit
Mbi rrotën mundimtare që sillet a mbi gunga shkëmbi,
Në vend që nga kulti i hijshëm ta drejtonim shpirtin.
Kjo perëndi quhet Rastësi, mundohuni ta njihni!
Ajo ju shfaqet dendur, por gjithnjë me pamje të ndryshme.
Mund të ketë lindur nga martesë e Tetit me Proteun,
Metamorfozat e tyre kanë gënjyer dhe heronjtë.
Kështu e mashtron lehtë njerinë e drojtur e pa përvojë,
Dhe tallet me gjumashët, por ia mbath nga ata që s'flenë!
Veç njeriut të shkathët i dorëzohet, dhe me të,

E urtë lozonjare, e butë plot hijeshi.
M'u shfaq dhe mua një herë si vajzë e zeshkët, flokët
E errët e të dendur i derdheshin sipër ballit,
Nuk i shtrohej vizimit floku rrebel e krrela-krrela,
Kaçurrela të vegjël i përdridheshin rreth qafës, -
U shtira sikur s'e njihja, e kuptoi tinëzarja
E ëmbël dhe e dashur, dhe ma ktheu me puthje e përqafime.
Oh, sa i lumtur isha. Por hesht! Kjo kohë iku tej,
Teksa sot jam mbërthyer keq nga ju, o leqe romane!

## V.

Një ngazëllim më kap në këtë dhe klasik të dashur,
Më fort e më bukur më flet bota antike e moderne,
Ndjek këshillën t'u shfletoj veprat autorëve të rinj,
Por netëve Amori më mban për punët e veta.
Dhe kur arrij ndopak të mësoj, dyfish më është gëzimi.
Por a s'është mësim, nëse gjoksit të dashuruar
Format ia zbuloj gjer tej ijet me dorën e lehtë?!
Veç ahere arti i mermerit i qartë më bëhet.
Shoh me veshë që dëgjojnë e ndiej me sy që vështrojnë,
Se po qe se mikja më vjedh disa orë nga dita,
Më zhdëmton, duke më kthyer disa orë nga nata.
Jo krejt nata shkon me puthje, shpesh nisin dhe biseda,
Dhe kur e merr gjumi, dergjem e humb në mendime.
Shpesh poezi kam thurur dhe në krahët e saja,
Dhe masën hekzametrit lehtas me gishtat e dorës
Ia kam matur në shpinë, tek frymë mirrte në gjumë.
Fryma e saj e ngrohtë i futej gjoksit deri thellë;
Ndërkaq Amori rriste flakën dhe mendonte kohët,
Kur triumviratit të vet i bëja të tilla shërbime!
.....

## VII

Sa të lumtur e ndjej veten në Romë, dhe pse mendoj
Se shpejt në Veri do më mbështjellë një ditë e hirtë,
I zymtë dhe i rëndë do më rëndojë qielli,
Bota do të më shpaloset pa linja dhe pa ngjyra
Dhe duke u munduar t'i gjej në vetvete udhët
E shpirtit të pakënaqur do të mendoj të hesht.
Shkëlqimi i gjallë i eterit më ndriçon ballin,
Dhe hyjnori *Feb* kudo të shfaq forma edhe ngjyra,
Natën yjet shkëndijojnë, dhe ç'këngë, ç'këngë dridhen
Dhe hëna ndrin më kthjellët sesa ndër viset nordike!
Ç'gëzim e ç'lumturi që kam! Mos jam në ëndërr vallë?
Shtëpinë për miqtë hape, o ati Jupiter!
Këtu ngulem dhe rri dhe drejt gjunjëve të shtrij
Duart e mia plot lutje: O atë, ti pranomë!
Si munda që të vij këtu nuk di ta them as vetë.
Heba më mbërtheu dhe më solli në këtë vend.
Ndoshta e urdhërove ndonjë hero këtu të të sillte?
E bukura u gënjye? Lemë ta gëzoj këtë gabim!
Bija jote, Fortuna dhurata e madhërishme
Siç i teket i ndan, si ti, sikur është çupërlinë.
Ti je zoti mikpritës? Mos e dëbo atëherë
Nga Olimpi yt mikun tënd këtu në këtë tokë!
"Poet për çfarë po të bluan mendja?" Mua falmë,
Për ty Olimp i dytë është kodra e Kapitolit
Dhe pasi këtu ndodhem, Zeus, thuaji Hermesit,
Të më çojë tek varri i Cestit, atje poshtë në Ork!

## VIII.

Kur më thua, mike, se kur ishte fëmijë s'u pëlqeje burrave
Dhe se ty nëna jote nuk të çmonte dhe aq shumë,

Gjersa nise hodhe shtat dhe u bëre më e madhe,
Të besoj e të mendoj si vajzë jo të rëndomtë.
Dhe lules së rrushit i mungojnë ngjyrat dhe linjat,
Po kokrra piqet dhe vera do të dehë njerëz të zotë!

**IX.**

Vjeshtë. Ndrin flaka në vatrën fshatarake, mikpritëse.
Kërcëllin, shkrepëtin, brumbullin rrëmbimthi mes degësh.
Kjo mbrëmje më gëzoi, se pa u kthyer në thëngjinj
Kapica e druve e ta varroste nën të hiri,
Më erdhi vajza e dashur, degë e trungje flakëritën.
Dhe kjo natë aq e ngrohtë ish një festë e ndritshme.
Ajo e la shtratin e dashnorit në mëngjes herët,
Dhe nga hiri vetëtinë sërish gjuhëza flake.
Ledhatareve Amori u jep si dhuratë,
Të zgjojnë gëzimin që të mos heshtë si nën hi zjarri!

**X.**

Aleksandri dhe Qerazi, Henriku e Federiku,
Të mëdhenjtë do të më jepnin gjysmën e lavdisë,
Sikur dhe për një natë jatakun tim t'ua lija,
Por këta të mjerë i mban nën kular të vet Oriku,
Prandaj gëzoje jetën ti që jeton në mes të gjallëve,
Përpara se të t'i akullojë kërcinjtë vala e Lethes!

**XI.**

Për ju, o Hire, poeti shkruajti këto fletë,
Mbi të pastrin altar i la me këto gonxhe
Trëndafili me shpirt të qetë. Artisti gëzohet,
Sa herë punishtja i merr pamjen e një panteoni.
Zeusi e uli ballin, ndërsa Era e ngriti,
Erdhi Febi, duke tundur kokën me flokëkaçurrela,

Përdhe pa Minerva e ftohtë dhe Hermesi sylesh
I vinte i përtallur plot ëmbëlsi rrotull,
Bakut epshor dhe ëndërrimtar ia nguli Citera
Plot me lakmi sytë e lagësht edhe të kthjellë.
Ju kujtua përqafimi i saj me Zotin dhe m'u duk se pyeti:
A nuk është biri ynë ky që na rri përbri?!

## XII.

Dëgjon voglushe, thirrjet plot gaz në rrugën Flaminia?
Janë korrësit, po kthehen në shtëpi vonë natën.
Mbaroi fare mbledhja e duajve për romanin.
Ai kurorë Cereres[1)] s'dëgjon t'i thurë me duar.
As festë tjetër s'i kushtohet të madhes perëndeshë.
Që në vend të lendeve na fali drithëra të arta.
Ne dimë që të dy të kremtojmë festën në heshtje,
Nëse dy dashuri vlejnë sa për një turmë të tërë.
Nuk ke dëgjuar ti kurrë për këtë rit mistik,
Që nga Kleusi një kohë ndoqi gjer këtu ngadhnjimtarin?
Grekët e krijuan edhe në muret e Romës,
Po grekët thërritën: "Eja me ne në natën e shenjtë!"
Profanët u ankuan dhe në pritje dridhej neofiti?
I mbështjellë në të bardha, simbol dlirësie.
Neofiti lajthiti në mes kaq figurash të çuditshme,
Sa i dukej se luhatej nëpër ëndrra, se këtu
Përdhe përdridheshin gjarpërinjtë, dhe duke mbajtur
Mbi krye kuti të kyçura, me kallëza drithi,
Ecnin vajza. Plot simbole ishin gjestet e priftërinjve!
Plot padurim dhe ankth dishepulli priste dritën.
Veç pas mjaft provash e shqyrtimesh vinte e i zbulohej
Ç'i fshihte rrethi i shenjtë mes figurash të çuditshme.

---

*1) Demetra.*

Dhe ç'ishte e fshehta? Kjo, që mbretëresha Demetra
Pranoi dhe ajo dashuritë e një heroi,
Si një moti, kur Jasoni, mbreti kreshnik i Kretës,
I fali hijeshinë e trupit të vet të pavdekshëm?
E lumtur Kreta, shtrati i martesës gufonte nga kallëzat
Dhe të mbjellat rriteshin kudo të mbara ndër fusha,
Por bota skuqej nga turpi e ankohej se Cereres
E rrëmbyer nga dashuria e kish harruar misionin.
Neofiti duke e kuptuar thellë thelbin e ritit,
Mikes i bëri shenjë... as ti s'po m'i kujton shenjat?!
Ai mirt i gjethësuar i bën hije një vendi të shenjtë.
Dhe gëzimi ynë ndonjë dëm nuk do t'i sjellë botës!

**XIII.**

AMORI është mjaft tinëzak, kush i beson
Gënjehet. Me pamje shtinjake erdh: "Besomë mua,
Të duan të mirën. Jetën dhe poezinë tënde,
Që kaq mirë i njoh i kam si kult i shenjtëruar!
Siç e sheh edhe vetë gjer në Romë të kam ndjekur!
Në këtë dhé rrihja të bëj diçka që të të pëlqejë!
Kushdo që udhëton ankohet se ka fjetur keq,
Atë që e dërgon Amori, gjen bujtje të mirë.
Me çudi përreth vështron këto rrënoja të lashta,
Dhe nis edhe mendon për këtë vend të shenjtëruar.
Ti dhe më shumë i nderon këto relike veprash
Artistësh të mëdhenj që plot me ngazëllim kam parë.
Këto figura i kam bërë vetë, s'po të mburrem,
Ndjemë, gjithçka që të them është krejt e vërtetë!
Tani po më shërben me plogështi, ku ikën pamjet
E bukura, ngjyrat, drita e zbulimeve të tua?
Mendon, mik, ende të modelosh?! Shkolla e grekërve
E hapur është ende dhe koha s'ia kyçi dyert.
Jam përjetësisht e re, dhe të rinjtë dashurojnë,

S'ta dua mençurinë e plakut. Gëzim dua! Kuptomë,
E vjetra ngjante e re, kur fatlum ishin në jetë.
I lumtur rro dhe do të jetosh gjithë shekujt që shkuan.
Ku ta gjesh lëndën për këngët? Tek unë ec e merre!
Të lartin stil ta mëson vetëm dashuria!"
Kështu foli sofisti. Kush mund ta kundërshtojë!
Detyrohem që t'i bindem, kur imzot më urdhëron.

Tinëzakja e mban fjalën, më jep lëndë për këngët,
Po më rrëmben dhe kohën, dhe forcën, dhe vetëdijen!
Shijime e shtrëngim duarsh, puthje e fjalë të ëmbla
Në mënyrë tepër të këndshme shkëmben një çift dashnorësh.
Dhe pëshpëritja bëhet dërdëllitje, dhe belbëzimi
Bisedë e ngrohtë dashurie. Një i tillë himn
Kumbon e shuhet pa asnjë farë prozodie.
Aurorë, si mund ta njohësh ndryshe këtë shoqe Muze?
Ndoshta dhe ty pas vetes të ka joshur Amori çapkën?!
Tani më ngjason si mikja e tij dhe më zgjon
Në altarin e vet për ditë feste të bukura.
Në gjoksin tim janë krrelat e tua. Kokën tënde
Ta pushton krahu im, ta shtrëngon lehtë rreth qafës.
Ç'zgjim të gëzuar patët për mua, orë të qeta,
Në kujtim të ëndjes që më përkundi nëpër gjumë...
Një shtrëngim dore dhe rishtas hapen sytë hyjnorë...
Oh, jo! Lemëni të sodis pamjen e saj i qetë!
Rrini mbyllur, sy! Ju më hutoni edhe më dehni!
Herët ma rrëmbyet kënaqësinë e soditjes.
Sa të madhërishme format, sa të derdhura gjymtyrët!
Në Ariana, në gjumë, do të ishte kaq e bukur,
A do të mundje që të ikje larg saj, o Teze?
Një puthje buzëve! Edhe tani, Teze, ik tutje!
Shih, u zgjua! Do të të mbajë fort ty përngaherë!

## XIV.

"Ndize dritën, çun!" – "Ende ndrit, imzot! Kot pse të digjen
Fitili edhe vaji. Kurtinat s'mbyllen kaq herët!
Prapa shtëpish u zhduk dielli e jo prapa malit,
Dhe gjysmë ore ka, sa të bjeri këmbana e natës."
"Zuzar, këputja dhe bindu! Po pres miken e dashur
Dhe ndërkaq ngushëllomë, llambëz, lajmëtare nate!"

## XV.

S'do ta ndiqja Qezarin gjer te britanët e largët,
Por pa mundim Flori do të më kish çuar në tavernë.
Mjegullat e Veriut më bezdisin mjaft më tepër
Sesa grumbulli i pleshtave që sjell era e jugut.
Ju përshëndes plot ngazëllim sot, o pijetore,
Dhe ju *osteri,* siç ju quan me të drejtë romani,
Se më shfaqët miken të shoqëruar me xhaxhanë.
E mira më mashtroi mjaft gjersa e bëra timen.
Këtu ndodhej tryeza jonë përplot me gjermanë,
Ajo kërkonte vend pranë nënës përballë meje.
Banga lëkundej shpesh, kaq mirë ishte mbështjellur,
Sa më zbulohej veç gjysma e fytyrës dhe qafa.
Fliste me zë të lartë siç flasin këtu romanët,
Qeraste, kthehej nga unë dhe shihte, dhe rrokullisi
Mbi tryezë gotën. U derdh vera, me gishtin e hijshëm
Nisi të vizatojë nëpër dhoga rrathë të lagur.
Emrin tim pranë emrit të saj e shkruajti, plot zili
Ia ndiqja lëvizjet e gishtit, gjithçka kapte prej meje.
Së fundi ajo bëri shenjën e pesës romake,
Dhe një vizë i shtoi përpara, shpejt, sa të shihja,
Dhe katra e çmuar më mbeti e ngulitur tek sytë.
I heshtur rrija ulur, buzën që digjej kafshova,

Hem nga dëshira, hem nga malli e hem nga lakmia.
Kishte edhe mjaft të ngrysej e të vinte ora katër.
O diell i madhërishëm, ndalo dhe shiko për pak Romën,
S'ke parë e s'do të shohësh gjë më të bukur kurrë,
Siç profetizoi Horaci në flakë frymëzimi,
Por sot të lutem mos u vono dhe ktheje vështrimin
Më herët e më me dëshirë nga të shtatë kodrat!
Shkurtoja poetit këto orë të madhërishme,
Që me sy plot lakmi i shijon piktori i lumtur,
Duke shkrepur shiko përmbi këto fasada të larta,
Mbi kupolat, mbi shtyllat e mbi obeliskun poshtë,
Dhe me rrëmbim rrëshqit mbi det gjersa në aq të shohësh
Atë që prej kaq shekujsh të shkakton gëzim hyjnor!
Këto brigje të lagta ku kaq fort rritet kallami,
Këto lartësira plot hije pemësh e kaçubesh,
Në fillim të shfaqin pak kasolle, pastaj verën
Si këtu lëvrin e rron një popull cubash të gëzuar.
Një botë sheh të lindë e një botë sheh në rrënim,
Dhe nga rrënimi ngrihet një botë dhe më e bukur,
Dhe gjersa të bredh e të sodis rrezet e dritës sate,
Ma thurni plot mençuri, Parka, mua fillin e jetës!
Po ju me vrap çapni këtu, o orë të bukura!
Ç'gëzim! Po dëgjoj gjë?! Sapo ra ora tre!
Të dashura, të shtrenjta Muza, ma lehtësoni pakëz
Këtë pritje të gjatë që më ndan nga mikja.
Po iki, lamtumirë, s'kam frikë se ju mbetet hatri,
Krenare, gjithnjë ia lini radhën dashurisë!

## XVI.

Përse, o mik i dashur, nuk erdhe sot tek vreshti?
Vetëm të kam pritur gjatë, pas fjalës që të dhashë.
"E dashur, atje isha, por pashë xhaxhain tënd,

Në mes bisqesh hardhish tek vërtitej u ktheva vjedhtas."
Nuk kishte veç një dordolec, që ty të paska tutur,
E qepëm ne me lecka e me copa kallami.
Me ç'zell që i kam ndihur, por ç'dhimbje që më solli?
Dëshira e plakut u përmbush se ia doli të trembë
Zogun më të besdisshëm që i çukiste kopshtin edhe mbesën!

## XVII.

Mjaft tinguj më bezdisin, por lehjet e qenve
I urrej mbi çdo gjë tjetër, ato m'i çjerrin veshët.
Veçse një qen mund ta dëgjoj shpesh me kënaqësi,
Kur e leh e angullin, qenin e fqinjit tim.
Se i lehu një herë vashës tek vinte plot ndrojtje
Të më takonte, sa mënt të fshehtën ma pikasën.
Tani kur ia dëgjoj lehjen, mendoj se ajo po vjen,
Apo mendoj kohën kur e pritura më erdhi!

## XVIII.

Ka gjëra që më mërzisin më fort sesa të tjerat,
Dhe ka të tjera që më ngjallin tmerr e më shkallmojnë nervat,
Vetëm t'i mendoj. O miq dua që t'ju hapem:
E kam bezdi të fle i vetëm në shtrat natën,
Por ç'tmerr udhës së dashurisë të të frikësojnë
Gjarpërinjtë dhe helmi nën trëndafilat e gëzimit.
Kur me gjestet më të hijshme i jepemi ngazëllimit
Në kokën tënde që varet vjen e pështpërit dhimbja.
Prandaj Faustina përbën gëzimin tim, shtratin
Plot dëshirë e ndan me mua e ma ruan besën.
Pengesa joshëse kërkon rinia e vrullshme,
Porse unë dua në paqë t'i gëzoj të mirat.
Ç'lumturi! Të dy bashkë këmbejmë të zjarrta puthje,

Dhe pa droje thëthijmë nga jetë e njëri-tjetrit.
Kështu mbruhet ngazëllimi nga netët e gjata,
Dhe gjoks më gjoks mbajmë vesh shtrëngatën, shiun, rrebeshin.
Dhe kështu na gjen dritë e mëngjesit, orët na sjellin
Të freskëta lule, dhe për festë stolisin për ne ditët.
Lemëni, Kuiritë, të gëzoj këtë fat, secilit
Ia lëntë Amori të parën e të fundit, të mirë të dheut!

## XIX.

E vështirë ta mbash emrin të panjollosur, *Fama*
Me *Amorin,* imzot, janë në grindje të përhershme.
Po përse kaq tepër urrehen a e di ti vallë?
Kjo është histori e vjetër, të ta them, prit pakëz!
Perëndesha e plotfuqishme dhe në shoqëri zotash
S'honepset, pse kërkon të sundojë veç fjala e saj.
Kështu prej kohësh, perëndesha me zërin prej bronxi,
Në gostinë e zotërve të mëdhenj e të vegjël,
S'është parë me sy ledhatarë e të mirë.
Një ditë u lëvdua kaq shumë, sa tha se kishte bërë
Skllav të bindur vetë birin fisnik të Zeusit:
"Herkulin tim do të ta sjell përpara teje, o atë!
Thirri plot ngadhnjim – Të rrojë jetë krejtësisht tjetër!
Herkuli nuk është po ai që lindi Alkmena!
Nderimi për mua e ka bërë zot përmbi tokë!
Kur hedh vështrimin drejt Olimpit, beson se sheh gjunjët
E tu të fuqishëm. Gabohesh, nëpër ter
Ai më kërkon mua. Vetëm për të më fituar,
Këmba e tij rreh udhët që askush nuk i ka rrahur.
Para i dal dhe unë në udhë, emri i tij
I njohur është bërë, dhe pse s'ka nisur nga bëmat.
Me të do më martosh. Ngadhnjimtari i Amazonave
Do të jetë dhe imi, do ta quaj plot gaz burrë!"

Heshtnin të gjithë, ta ngacmonin kujt nuk ia kish qejfi,
Se kur është me kacabunj, s'ta kursen fare talljen.
Po ajo nuk e pa Amorin, që u përvodh tinëz
E nën zgjedhë të më së bukurës e vu heroin.
E maskoi çiftin, lëkurën e luanit së hijshmes
Ia hodhi mbi shpatulla dhe në dorë ia la topuzin,
Dhe flokët porsi gjemb trimit ia stolisi me lule.
Dhe një furkë i ngjeshi krahut që u përkul me tallje.
Dhe si sajoi këtë lodër qesharake, ia mbathi
Nëpër Olimp, duke bërtitur: "Po ndodhin çudira!"
Toka, qielli dhe dielli i palodhur s'kanë parë kurrë
Në udhën e tyre të përjetshme mrekulli të tilla!"
Vrapuan të gjithë, se e besuan këtë çapkën
Të shthurur, se e kish me gjithë mend, nuk mbeti pas as Fama.
Po kush qeshi, kur pa heroin kaq hidhur të tallur?
Ua kap kaplloqja? Era, i buzëqeshi Amorit!
Porse Fama e turpëruar dhe e dëshpëruar
Në fillim ia plasi gazit: "Këto janë veç maska!
E njoh heroin tim! Do të na tallin tragjedianët!"
Pastaj me dhimbje vikati: "Qenka vetë ai!"
As grimën e këtij dëshpërimi s'pati Hefesti,
Kur pa gruan me mikun e tij të ulur nën rrjetë,
Që në çastin e duhur papritmas fort i mbërtheu,
Duke i mbajtur të shtrënguar në gaz të përqafimit.
Ç'ngazëllim për djemtë e rinj, për Mërkurin e për Bakun,
Të dyve u shkrepi në mendje të prehen mbi gjoksin
E kësaj gruaje të madhërishme, prandaj iu lutën:
"Mos i liro, Hefest! Kështu t'i shohim edhe njëherë!"
Dhe plaku që iu vunë brirët më fort e shtrëngonte,
Ndërsa Fama plot mëri me rrëmbim u largua.
Që ahere armiqësia s'u shua mes tyre.
Sa Fama zgjedh ndonjë, sakaq, Amori pas i qepet,
Dhe me fisnikëri kur ka, më egër e sulmon.

Në rreket që të ikë, zvarras e tërheq Amori.
Vajza ofron, plot çmenduri Fama ia përbuz.
Duhet t'ia durojë shigjetat mizore të harkut
Dhe njeriu për njerinë ndizet me epsh kafshëror.
Dhe kur prej Amorit ka turp, më tepër heq e vuan.
Shtinjakut i jep gëzim-farmak mes krimesh e hallesh.
Por dhe Fama e ndjek Amorin me sy e me veshë.
Një herë me të të të shohë, të bëhet armike,
Të kall tmerrin me sy e me pamjen gjithë përbuzje,
Dhe nam të keq i nxjerr shtëpisë ku vjen shpesh *Amori*
Kështu më ndodhi dhe mua. Vuajta dhe unë pakëz.
Perëndesha më ndoqi e më përgjoi të fshehtën.
Por ka një ligj të lashtë, atij i bindem në heshtje,
Se grindjet mes mbretërve grekët si unë i sheshuan!
**XX.**

Nëse njerinë e zbukuron forca dhe karakteri,
Një e fshehtë e ngulur thellë më tepër i jep hije!
O ti pushtonjëse qytetesh e mbretëreshë popujsh,
Perëndeshë e dashur që më udhëhoqe në jetë,
Ç'fat m'u desh të përball! Duke tallur rrekej Muza
E Amori plot dinakëri të më çkyçnin gojën!
Tepër e zorshme të fshehesh të metat e mbretërve,
Shërbëtori më besnik e zbuloi veshin e Midës,
Dhe e fshehta e shtypi dhe i rëndoi në gjoks.
Në tokë do desh ta varroste, prej saj të çlirohej,
Por as dheu kallkan s'e mban një të fshehtë të tillë.
Mbi ujë kallamet, fëshfërijnë dhe ia thonë erës:
"Mida! Princi Mida ka veshë të gjatë gomari!"
Më të rëndë e kam që po mbaj një të fshehtë të bukur!
Ah, gjithçka kam në zemër vetiu më rrjedh ndër buzë.
As një mikes s'ja them dot, se keqas do më shante,
As një miku s'ia shfaq, se miku veç dëm do më sillte,

Dhe nuk jam më aq i ri e as aq i vetmuar,
Sa t'ia rrëfej korijes e shkëmbit tingëllimtar.
Ty heksametër, ty pentametër po ta them;
Si ajo më gëzon ditën e më lumturon natën.
Ajo nga shumë e lakmuar u shmanget leqeve,
Që guximthi ia ngre trimi e tinëzisht dinaku.
E zgjuar, e çaplehtë shket dhe i di mirë udhët,
Vono të dalësh, hënë, që të mos ma shohë fqinji,
Ti, erë, zhurmo mes gjethesh, mos i dëgjohet hapi!
Rrituni e lulëzoni ju këngë të dashura,
Përkundmëni në frymën tuaj të ngrohtë e të ëmbël,
Dhe ua thoni Kuiritëve, si ato kallamishte
Llapazane, të fshehtën e dy dashnorëve të lumtur!

# Elegji

# Aleksi dhe Dora

Ah, pa pushim çdo çast anija përpara gjithnjë sulet,
Mes dallgëve me shkumë për larg çan e për më larg,
Dhe bashi lë një vazhdë të gjatë ku delfinat
Përhidhen dhe e ndjekin, sikur pas presë shkojnë.
Udhëtim të mbarë gjithçka paralajmëron, lundërtari
I qetë lëviz e mundohet të drejtojë velën.
Shpirti i lundërtarëve ndehet si flamurth direku,
Veç njeri, mbështetur te direku sheh me trishtim prapa.
Sheh si ngjyhen në të kaltër malet që i largohen,
Sheh sesi kridhen në det e çdo gaz me to humbet në ujë.
Dhe për ty iku kjo anije që të mori, Dora,
Mikun, Aleksin tënd, të fejuarin e dashur.
Dhe megjithatë ti më kot sheh nga unë dhe zemrat
Akoma rrahin fort njëra për tjetrën, por jo pranë.
Veç një vështrim mbi ty dhe më shpërblen për gjithë ditët
Që dikur zvarriteshin me pezmatim të akullta.
Në guaskën e vetvetes mbyllem, sepse dua
Të kujtoj kohën, kur mikja më shfaqej për çdo ditë.
E mundur të shohësh bukurinë e të mos ndjesh?
Kjo magji qiellore a nuk vepron në shpirtin tënd?
Mos më akuzo kaq ashpër!... Kështu u hedh poeti
Njerëzve të mbledhur në një kuvend enigmën,
Sikush u gëzohet imazheve plot hir, por ende
Nuk është thënë fjala që t'u zbërthejë kuptimin.
Dhe kur fuqishëm tingëllon, në çdo shpirt hedh një dritë
Që u ndihmon të kapin një kuptim dyfish të bukur!
Ah, përse kaq tepër vonë, Amor, më heq nga sytë

Fashën, me të cilën m'i mbajte të lidhur tash sa kohë?!
Anija e ngarkuar priste të fryjë erë e mbarë,
Dhe së fundi fryu era nga toka drejt detit.
O kohë e bjerrë e rinisë, o ëndërra të kota,
Ju fluturuat, por më mbet kjo orë e tanishme.
Po ajo mbet, dhe me të fati im, të të mbaj, o Dora,
Dhe shpresa, Dora, nuk më shfaq pamje tjetër, veç sates
Shpesh të shoh si shkon në tempull veshur e stolisur me rroba feste,
Dhe nëna jote e mirë të ndjek me çap solemn.
Me ç'shkathtësi edhe sa shpejt i çon frutat në breg e në krua,
Me t'u kthyer, ç'të tundet mbi krye anfora.
Me ç'krenari ahere të spikat qafa e zverku,
Dhe sa i hijshëm ritmi i çdo lëvizjeje tënde!
Dhe shpesh mendoj se shtëmba do të rrokulliset poshtë,
Por ajo qëndron e mbërthyer fort me brez pëlhure.
Kështu, moj fqinjë e bukur, të kundroja me mall,
Siç vështrojmë yjet e sodisim hënën
E u gëzohemi dhe përbrenda shpirtit të qetë.
S'rreh flatrat asnjë dëshirë për të të zotëruar!
O vite ç'më ikët ju kështu! As dhe njëzet hapa
S'ndanin shtëpitë tona, por prakun s'ta shkela kurrë!
Dhe tani na ndajnë këto dallgë të tmerrshme! Dallgë,
Dallgë ju nuk jeni veç imazh i rremë i qiellit!
Të kaltrit e mahnitshëm, për mua ngjyrë e natës!
Gjithçka ish në lëvizje. Një çunak erdhi me vrap
Tek shtëpia e atit dhe më thirri për në breg:
"Ja, u ngritën velat dhe po fryn era" – më thoshte
"Dhe me furi e shkuli spirancën e ngulur në rërë;
Eja, Aleks, eja!". Atëherë ati i dashur
Me fisnikëri ma vuri dorën në kryet plot krela,
Dhe plot përkujdesje nëna më solli një bohçe,
Që shpejt e përgatiti: "Ardhsh i shëndoshë!" më thanë.

Dhe tek nxitoja gjatë murit me bohçen e vogël
Nën krah, të takova tek heshtje e shtangur te dera
E kopshtit tënd. Buzëqeshe dhe më the: "O Aleks,
Kjo gjindje zhurmëtare mos është shok i udhës sate?!
Brigje të huaja do të shkelësh e mall të çmuar
E stringla do të sjellësh për zonjat e pasura të qytetit!
Por, mos harro, dhe mua sillmë një zinxhir të hollë.
Dhe do të të jem mirënjohëse fort për këtë!"
Qëndrova dhe e pyeta si kanë zakon tregëtarët,
Për formën, madhësinë dhe peshën e zinxhirit.
Me maturi më pyete për çmimin, teksa shihja
Qafën tënde të denjë për stoli mbretëreshe.
Një zë gjëmoi me rreptësi që nga anija,
Dhe ti më the: "Merr edhe më nga këto fruta kopshti!
Merr nga fiqtë e bardhë e nga portokajtë më të pjekur,
Deti s'ka fruta, dhe asnjë vend s'ka si këto!"
U futa brenda. Ajo në fustanin e shpërvjelur
Nisi të mbledhë këtë ngarkesë të artë frutash.
T'u luta. Mjaft! Por ti dhe një kokërr më të mirë
Me përkujdesje e lehtas ma hodhe në dorë.
Më së fundi u ngjite mbi pjergull, dhe atje gjete
Një shportë, mbi ne zgjaste degët mërsini plot lule.
Dhe në heshtje nise që të m'i rregulloje në shportë,
Në fillim portokalli plot lëng, si një top prej ari,
Pastaj fiku i lehtë që shtypej nga çdo ngjeshje,
Mersini e mbuloi edhe stolisi dhuratën!
Por s'e mirrja, qëndroja. Ne shihnim njëri-tjetrin
Në sy, dhe mua m'u mjegullua fare vështrimi.
Ndjeve se u shtrëngove në gjoksin tim dhe zverkun
Ta mbërtheva me krahë e ta putha qafën kaq herë!
Mbi shpatulla m'u var koka jote, dhe krahët e tu
Më rrokën përreth me dashuri, tek qeshje e lumtur.
Ndjeva si flatrat e dashurisë na shtrëngonin

Dhe në ajrin e kthjellë jehuan tri herë e pastaj
Prej sysh na rrodhën lotë, qaje ti, qaja dhe unë.
Mes dhimbjes e gëzimit as donim t'ia dinim për botën.
Gjithnjë e më fort më thirrnin gjatë bregut, por këmbët,
Nuk më bënin të shkoja tutje. Dora, drita, Dora,
A nuk je, a nuk je ti me të vërtetë e imja?
Dhe ti m'u përgjigje lehtë dhe ëmbël: "Po, po
Përngaherë jotja!" Atëhere lotët më ngjau,
Sikur i fshiu me dorë një fllad hyjnor!
Gjithmonë e më pranë gjëmonte vikama: Aleks, Aleks!
Dhe çunakun që më kërkonte me ngulm e pashë
Sesi hyri brenda portës. Sesi e kapi shportën!
Si shtyheshim! Si të shtrëngoja sërishmi dorën!
Si mundëm të arrinim gjer atje, tek anija?
E kam të qartë, duhej të dukesha si i dehur!
Kështu iu duka shokëve, ndaj ma falën vonesën.
Një tis mjegulle e mbuloi qytetin që largohej!
Përngaherë! Më pështëriste, Dora, dhe këto fjalë
Më shungullonin ndër veshë si gjëmimet e Zeusit!
Pranë Zeusit e bija, perëndesha e dashurisë
Dhe anash Hiret! Aleanca ishte hyjnore!
Shpejto, moj anije, dhe fryni erëra të mbara!
Karenë çaji tallazet që ngado shkumëzojnë!
Më shpini vrik në ndonjë liman të huaj që unë,
Ta porosis argjendarin për pengun e çmuar!
Po, zinxhiri do të të bëhet hallkë vargoi!
Nëntë herë, duke u vërtitur, do ta rrethojë qafën!
Por dhe stringla të tjera do të sjell, nga më të ndryshmet,
Byzylyk ari duhet ta stolisë kyçin e dorës.
Do të ndeshen në garë rubini me smeraldin,
Safiri i dashur me arin edhe me perlën.
Do të lidhin me hallka të hijshme gurët e çmuar!
Ç'endje kjo, të zbukurosh vetë të fejuarën!

Kur shoh perla, mendoj për ty, çdo unazë më sjell
Para syve imazhin e duarve të hijshme.
Shkëmbime e blerje do të bëj, që ti të mundesh
Të zgjedhësh nga gjithë pirgu që do të kesh përpara.
Për ty s'do të blej vetëm stringla e byzylykë,
Por dhe ato që i pëlqejnë një gruaje shtëpie!
Kuverta të leshta me thekë ngjyrë purpuri,
Që një shtrat i butë të na shtrohet mike, për prehje.
Copa pëlhure. Do të ulesh e do të qepësh,
Rrobe për ty e mua dhe për atë që do të vijë!
Ma ndritni zemrën time ju imazhe të shpresës!
O perëndi ma qetësoni zjarrin që digjet
E brumbullon furishëm brenda në zemrën e njomë!
Dhe pranë vetes thërras ato gëzime të dhimbshme,
Kur e akullt e mizore më afrohet angushtia.
As vravashkat e *Erinive* dhe as lehjet e qenve
Të skëterrës s'e kanë trembur kaq tepër mëkatarin
Në mbretërinë e errët pa asnjë rreze shprese,
Sa më tromaksin hijet e qeta që nga larg
Më ngjajnë të bukura. Akoma dera e kopshtit
Qëndron e hapur? Mos brenda në to po hyn një tjetër?
Mos për një tjetër po këputen frutat, dhe fiku
Vetëm atij i fal mjaltin që pikon nga ëmbëlsia?
Mos ajo e josh atë në drejtim të pjergullës?
Mos ai po e ndjek? O zotër, verbomëni sytë,
Dhe fshihmëni nga mendja fytyrën e çdo kujtimi!
Po, ajo është vajzë dhe gjersa joshet nga njeri,
Edhe nga dikush tjetër mund të joshet fare lehtë!
Mos qesh këtë herë, Zeus, me besën e thyer!
Gjëmo më për tmerr dhe qëllo, por përmbaji rrufetë!
Shpërndaji dhogat përreth, dallgëve të tërbuara,
Falja mallin, dhe trupin tim hidhua delfinave!
Tani mjaft, o muza! Kot rrekeni të përshkruani

Si me zemrën e dashuruar lot gazi dhe dhimbja!
S'i mbyllni dot plagët që shkaktoi dashuria,
Por lehtësimi na vjen veç nga ju, o të mira!

# Eufrosina

Dhe nga majat e akullta të maleve të larta
Po ik purpuri dhe ari i diellit që u shua.
Nata mbuloi lugjet e shtigjet e udhëtarit,
Që nxiton të arrijë vonë në kasollen e vet.
Drejt cakut të ditës, drejt banesës baritore
Dhe gjumi hyjnor para tij ngarend të ndodhet.
Le të ma kurorëzojë edhe sot mua ballin
Me lulekuqet e freskëta e të shenjta të fushës.
Por ç'vetëtin atje poshtë shkëmbinjve për drejt meje,
Duke përndritur avujt e përroit plot me shkumë?
Mos rrëzëllin dielli mes krepash e plasash të fshehta?
Se s'është shkëlqim prej toke ky që po bredh atje!
Afrohet duke u rrokullisur një re dhe përflaket.
Shikoj i shtangur këtë mrekulli të natyrës.
Kjo rreze mos bëhet befas një figurë me shpirt?
Çfarë perëndeshe më afrohet? Dhe çfarë muze
Po kërkon mikun besnik nëpër humnerën e tmerrshme?
Moj perëndeshë e bukur shfaqmu dhe mos m'u zhduk,
Duke ma lënë shpirtin dhe mendjen të turbulluar!
Thuama, në mundesh, mua të vdekshmit emrin tënd,
Nëse nuk mundesh, shkundmë nga këto ëndrra të kthjellta,
Që të gjej se cila je nga bijat e përjetshme
Të Zeusit, dhe poeti të të lëvdojë në këngë!
Nuk po më njeh, i dashur? Është po ajo pamje
Që ti dikur ke dashur e që po e sheh si një tjetër!
Prej kohësh nuk i përkas më tokës dhe shpirti im
Me dhimbje po shtegton drejt gëzimit të rinisë.

Shpresova që pamja të më mbetej e gjallë tek miku,
Që akoma e ndjen thellë dhimbjen e dashurisë.
Vështrimi yt i mallëngjyer mes lotësh më thotë:
Eufrosina për mikun ende është e afërt.
Shih si ikën mes pyjesh e malesh të lemerishme,
Dhe kërkon udhëtarin nëpër vendet e largta.
Kërkon mësuesin, atin, mikun, sheh dhe një herë
Në vargun e gëzimeve që prapa saj mbetën.
Lemë të kujtoj orën dhe çdo imtësi të vogël,
Ah, kush nuk e thërret me mall atë që më s'na kthehet!
Ah, këtij grumbulli ditësh të bukura mbi dhe,
Kush mund t'ua çmojë sa duhet vlerën fluturake?
E vogël shfaqet, por s'mbetet e vogël për zemrën,
Dashuria dhe arti çdo vogëlsi e zmadhojnë!
A të kutjohet çasti, kur nga skena e teatrit
Më drejtove nëpër shkallët e artit më fisnik?
Isha fëmijë, fëmijë plot ndjenja, më thirre Artur,
Tek mua pe imazhin e një poeti britanik!
Të mjerët sy me një flakërim mizor m'i kanose,
Pastaj i rrejtur tej e hodhe vështrimin e përlotur!
Sa i mirë ishe në jetën time të trishtuar,
Gjersa të ndau prej meje një arrati e guximshme!
Mes krahëve më more mua, gjymtyrëdërrmuarën,
Që shtihesha e vdekur duke t'u ngjeshur në gjoks.
Dhe befas hapa sytë dhe të pashë të heshtur,
Të zhytur në mendime e të përkulur mbi mua.
Dhe u hodha si fëmijë drejt teje, të putha duart,
Dhe një puthje të falën buzët e mia të ëmbla.
Të pyeta: Ç'je kaq i menduar? Mos luajta keq?
Mësomë, pra, sesi mundet të luaj më mirë!
Më përqafove e më shtrëngove në mes krahësh,
Asnjëherë tjetër, s'm'u drodh në gji kështu zemra!
Asnjë mundim s'më lodh, një pjesë apo të gjithën

Jam gati ta përsëris, mjafton që ti të më drejtosh!
Jo, vogëlushe, thirre. Të gjithë a një pjesë,
Sikur e lojte sot, shfaqe nesër përpara qytetit!
Preki, siç më preke, të gjithë dhe, mes brohoritjes,
Lotë të rrjedhin nga habia dhe nga sytë e tharë!
Por fort e preke mikun tënd që të mbante në krahë,
I tmerruar, nga pamja e parakohshme e kufomës!
Natyrë, me ç'madhështi e siguri na i shfaq të gjitha!
Qielli e toka ndjekin një ligj të fortë e të përjetshëm!
Viti e ndjek vitin, vera i zgjat dorën vjeshtës së begatë.
Të paepur ngrihen shkëmbinjtë, dhe ujët gjithnjë
Shpërthen nga plasat duke buçitur e shkumëzuar!
Pishat blerojnë, por dhe vetë kaçubja pa gjethe,
Në mes të dimrit ushqen fshehtas nëpër degë gonxhet.
Gjithçka lind e vdes pas ligjit, por në jetën e njeirut,
Në gjënë më të çmuar, sundon fati i paqëndrueshëm!
Jo gjithmonë më i riu ia mbyll kapakët e syve
Më të vjetrit që u ul përdhe pa brengë në zemër.
Por shpesh fati, ajme, e kapërcen radhën e ditëve,
Pa ndihmë pranë më kot qan plaku fëmijë e nipër,
Dhe rri si trung me degë të thyera,
Që nga gjithë anët breshëri ia ka ulur poshtë,
Kështu fëmijëz, më fute në mendime të thella,
Kurse i vdekur m'u vare përmbi krahët e mia!
Por me gaz të shoh ty, që mes shkëlqimit të rinisë,
Të më ngjeshesh përsëri plot me gjallëri në zemër!
Shko, hidhu nga gëzimi, ti, që lojte rolin e djalit,
Vajzë do të rritesh për ngazëllimin e botës,
Ndiq me ngulm udhën tënde dhe farkëto talentin
Në çdo çap të jetës me besim të madh në vetvete!
Gëzimi im më qe, dhe para se t'i mbyll sytë,
Do të doja të shihja përsosjen e talentit tënd!
Kështu fole, s'do ta harroj këtë çast solemn kurrë.

Në interpretimin e fjalës sate zhvillohesha.
Me ç'ëndje ia thoja popullit fjalët plot me ndjenjë,
Që ua besove buzëve të mia fëminore!
Sa të kërkoja mes spektatorëve të çuditur,
Unë që u formova nën vëzhgimin tënd të zgjuar!
Dhe sërisht atje do të ikësh, por Eufrosina
S'do të të shfaqet për ta kthjelltësuar vështrimin!
S'do t'ia dëgjosh më zërin nxënëses sate
E pajtohet me vendin që ti i ke përcaktuar,
Dhe s'ta kursen tundimin edhe zellin gjer në grykë
Të varrit, do të bënte një flijim të madhërishëm!
Do të kujtohem, ahere, dhe do të më thërresësh:
Eufrosinë më dil përpara syve si e gjallë!
Mjaft gjëra ende do të të thoja, por ndarja s'duhet
Të shtyhet, një zot despotik ma urdhëron çdo çap.
Lamtumirë! Pas tij më tërheq një vrap kalamendas.
Pranomë një dëshirë dhe përmbushma me shpirt miku!
Mos më le të gremisem pa lavdi në mes hijeve!
Veç muza mund t'i japë vdekjes shkëndijëza jete.
Se në mbretërinë e Persefones enden turma
Pa pamje, hije që nuk kanë dot as dhe një emër.
Por atë që përmend poeti, me pamjen e vet
Endet dhe në korin e heronjve vjen e bashkohet!
Prandaj futem me gëzim prej këngës sate e njohur;
Dhe syrin perëndesha ma ngul në sy me ëndje.
Me dhele më pret dhe më pyet si e kam emrin
E shenjë u bën grave të fisme që i mblidhen shpesh rreth fronit.
Më flet më besnikja nga gjithë gratë, Penelopa,
Dhe Evdna, mbështetur tek burri i saj i dashur,
Më afrohen gra më të reja që zbritën këtu
Mjaft shpejt dhe më ankohen për fatin tonë të njëjtë.
Nëse vjen Antigona, më e afërta nga motrat,
Nëse vjen Polikseni, ende me shpirt të turbullt,

Për shkak të vdekjes së hidhur të të fejuarit,
Më vështrojnë si motër e më pranojnë mes tyre,
Se janë krijesat më të hijshme të tragjedive.
Dhe mua më skaliti poeti dhe nëpër këngë
Gjallon ajo që jeta ma mohoi për fare!
Kështu flet, buza i lëviz për të më folur prapë,
Por zëri i ëmbël i shuhet në një vërshëllimë.
Sepse prej reve fluturake në ngjyrë purpuri
Zbret zoti i madhërishëm, i patundshmi, Hermes.
M'i gëlltisin këto dy figura pëpara syve.
Më e thellë bëhet nata rreth meje dhe ujërat
Uturojnë më me forcë nëpër shtegun rrëshqitës.
Një zi e rëndë më kap dhe dhimbja m'i mpin krejt forcat,
Do të shembesha përdhe, por më mban një shkëmb me myshk,
Trishtimi ma shqyen çdo fijëz të zemrës, dhe lotët
Më rrjedhin vetiu. Por në pyll nis e zbardh agimi!

# Nikias

Nikias, njeri i zot, mjek i trupit dhe i shpirtit,
Jam sëmurë, mjaft të forta i ke ilaçet!
Nuk mundem më që të ndjek këshillat që më jep.
Madje, dhe miku më duket kundërshtar i egër!
S'mund të të hedh poshtë, gjithçka e murmuris me vete,
Dhe fjalën më të hidhur e më fshikulluese,
Që ti nuk ma thua, guxoj e ia përplas vetvetes.
Porse ah, ujërat derdhen me rrëmbim nga shkëmbenjtë,
Dhe valët e rrëkeve s'e ndalojnë melodinë.
A mundet ta ndalosh stuhinë? A nuk vërtitet
Nga maja e zenitit në thellësi të detit?
Dhe natyra përreth po kështu më thotë: Nikias
Dhe ti do t'u nënshtrohesh ligjeve të rrepta të jetës!
Mos e mrrol ballin, miku im, dhe më dëgjo se ç'të them.
Dëgjo ç'më mësoi ajo pemë atje tek përroi!
Pak kokrra mollë jep, por dikur ish mbushur përplot!
Tani, vështroje, kulpri e ka mbështjellë ngado!
Mora një thikë të mprehtë, me tehun si me hark,
Dhe nisa t'ia këpusja atij çdo loz e çdo degë.
Me një të fshame të thellë e gjithë ankime,
Me fëshfëritje gjethesh, më pëshpëriti pema:
"Mos më plagos, ah, mos më plagos mua, miken tënde!
Kur ishe fëmijë, sa gëzime të kam dhuruar!
Tok me këtë thurimë që më mbështjell keq më gjymton
E më shkallmon me vrazhdësi mjaft keqas vetë jetën!
A s'e ushqeva vetë, dhe as u rrit për mua?

A nuk janë mpleksur gjethet e kulprit me të miat,
Sa nuk mundem t'i dalloj dot nga njëra-tjetra?
Si mos e dua pemën që mbahet vetëm tek unë,
Që në heshtje e me lakmi rrotull meje mblidhet?
Mijëra loze lëshoi, dhe mijëra rrënjë,
Që futen thellë dhe ngjizen me jetën time!
Duke ma marrë lëngun ushqyes, duke më përpirë
Atë të domosdoshmen, më thëthin palcën dhe shpirtin!
Më kot vazhdoj të ushqehem, rrënjët e fuqishme
S'arrijnë t'ua përçojnë lëngun të gjitha degëve.
Sepse miku i rrezikshëm, i dashur për mua,
Rend e më vjedh udhës forcën e frutave të vjeshtës!
Tek kurora s'arrin gjë, thahen degët anësore,
Nisi të fishket dhe dega që tundet mbi përrua.
Kështu tradhtari me ledhatime më rrëmben jetën,
Më përlan të mirat, forcën rritëse dhe shpresën,
Dhe vuaj vetëm për atë, i ngazëllohem vetëm
Stolisjes vdekësore të gjetheve që fishken.
Flake thikën, Nikias, dhe ndiej pak dhembje për të mjerën,
Që veten ia bën fli pasionit të vrullshëm e mbytës,
Kush në dashuri ra, a mundet ta kursejë veten?

# *Epigramet veneciane*

# Epigramet veneciane*)

**Venedik 1790**

*Si humbet kohë e para,*
*Ju tregon ky libërth pra!*

1.
Sarkofagët dhe urnat i stolisnin me pamje jete
Paganët; përreth valle faunësh kore bakantësh
Sajojnë qindra ngjyra dhe buçkani me këmbë dhije
I fryn bririt e nxjerr tinguj të ngjirur, vërshëllyes.
Çembal, tambure bien. Shikojmë e dëgjojmë mermerin.
Zogj fluturakë, fruti sa tepër u shijon në sqepe!
Ju s'ju tremb asnjë zhurmë, aq më pak ju tremb dashuria,
Që mes rrëmujës shfaqet me një vravashkë krejt papritmas.
Kështu ngadhnon mbi vdekjen kamja, dhe hiri brenda arkës,
Në qark të qetë, ngjan se jetës ende i gëzohet.
Kështu rrethojnë pas vdekjes sarkofagun e poetit
Këto vëllime plot pamje të shumëllojta jete!

2.
Sa vërejta në qiellin që bëhej më i kaltër diellin,
Dhe degët plot të kulprës të varen nëpër faqe shkëmbi.
Dhe vreshtarin e zellshëm që përmbi plep hidhte hardhinë,
Mbi djepin e Virgjilit më përkëdheli erë e vakët,
Dhe menjëherë muzat erdhën tek unë dhe bisedës
Së shkëputur ia nisëm, siç i pëlqen kaq fort shtegtarit!

3.
Ja pra dhe Italia që po lë. Plot pluhur udhët
Edhe i huaji ripet, sido që të sillet,
Rregullin gjerman më kot e kërkon në çdo qoshe.
Jetë e lëvizje ka, por as disiplinë e as rregull.
Gjithkush mendon për vete, për tjetrin fare s'çan kokën.
Madje dhe burrat e shtetit për veten përkujdesen.
I bukur vendi, por më Faustinën këtu s'e gjen.
Kjo s'është më Italia, që dikur braktisa me dhimbje!

4.
Në gondolë qëndroja i shtrirë dhe çaja mes anijesh,
Që në Kanal të Madh të shumta rrinin plot ngarkesë.
Mallëra të çdo lloji këtu mund të gjesh,
Drithëra dhe verëra, perime dhe stiva drurësh.

5.
Kaloja me nxitim, kur më fshiku një degëz dafine
Mbi mollëza pak ashpër. "Ti, Dafnë, më qëllon, kur prisja
Nga ti shpërblim!" Ma kthen duke qeshur nimfa: "Poetët
Nuk mëkatojnë rëndë. I lehtë ish ndëshkimi. Mbathja!"

6.
Kisha një të dashur, më ish më e shtrenjtë se gjithçka!
Por nuk e kam më. Pra hesht edhe përball humbjen!

7.
Me djepin që lëkundet e krahasoj këtë gondolë.
Arka që i rri sipër më ngjan si një qivur i madh.
Po, po kështu! Mes djepit e qivurit tundemi pezull
Mbi Kanalin e Madh, pa një mendim e shtyjmë jetën!

8.
Plot krenari bri Dozhës shikojmë sesi ecën Nuncio,
Përcjellin në varr Zotin, dhe një nga të dy vulos gurin.
Ç'mendon Dozha s'e di, po tjetri heshtas qesh patjetër
Nga rëndësi e kotë e kësaj parade pompoze!

9.
Përse po zien populli edhe thërret? Kërkon të hajë,
Të mundet të rrisë edhe të mbajë sa më mirë fëmijët.
Vërej ti, o shtegtar, edhe kështu bëj kur të kthehesh,
Sepse nga lart s'të vjen asgjë, sado që të rropatesh!

10.
Ç'u bien priftërinjtë kambanave. Të ngeshëm janë!
Ja erdhën dhe ia nisën dhe sot si dje të dërrdëllijnë.
Për ta ti mos më fol! Ia njoh njeriut çdo nevojë.
I lumtur është kush dhe nesër dërrdëllin si sot!

11.
Bëhet i bindur shkollari si rëra në det. Rëra – rërë!
Porse ti, miku im i zgjuar, për mua ji një perlë!

12.
E bukur në pranverë me këmbë tërfilin e njomë
Dhe leshin e qingjave me dorë butësisht ta çikësh.
E bukur të vështrosh zgjimin e degëve plot lule
E vajzën plot ngjallim me sy plot mall ta përkëdhelësh,
Por më e bukura gjirin bareshës t'ia stolisësh.
Ç'lumturi shumëfishe, veç më mungon vrull i majit!

13.
Vendin përngjas me kudhrën edhe sovranin me çekanin
Dhe popullin me petën e hekurit që mes tyre
Lakohet. Ç'më vjen keq për të! Goditje të pasakta
E rrahin. Dhe kurrë kusia nuk arrin të bëhet.

14.
Mjaft dishepuj bën fanatiku dhe turma mallëngjehet,
Ndërsa njeriu i zgjuar ka veç ca miq të rrallë,
Tablotë plot art për mjaft janë piktura të rëndomta,
Nuk janë për këdo veprat e mendjes e të shpirtit.

15
Sundimtar bëhet ai që çmon epërsitë e veta,
Por, ne të zgjedhim atë që çmon epërsitë tona!

16
Në thuhet se mjerimi të lutesh të mëson, të vijë
Në Itali, në do! Mjerimin gjeti rob i huaj!

19
Çdo fisnik në Venedik mund të bëhet dozh, kjo mendjen
Ia fryn, e bën të rëndë, plot krenari si fëmijë.
Prandaj kaq të shijshme ostet janë në vendet katolike,
Por po prej të njëjtit brumë prifti shenjtëron Zotin.

21
Me nxitim rend shtegtari. Do mund ta gjejë shenjtorin?
Do ta dëgjojë e shohë atë që bëri çudira?
Koha e flaku tej, veç kockat mund t'ia gjesh gjëkundi,
Një kafkë e ca kokalla që s'i blojti ende dheu.
Shtegtarë jemi të gjithë ne që në Itali kërkojmë,
Veç një skelet të prishur, por të nderuar nga marria!

22
Jupiter Pluvius sot porsi një demon mik m'u shfaqe
Dhe për një çast më fale një dhuratë shumëfishe.
Venedikut jepi të pijë, gjersa shkretirat t'i blerohen,
Dhe këtij libri fali ti disa poezi të shkurtra!

23
Pra derdhe, le të dehen bretkët[1] me mantel ngjyrë alle,
Ngope fushën e etur, gjersa lakra taje[2] të mbijnë,
Por këtë libër mos ma lag. Për mua shishe araks[3]
Dhe ponçin le ta bëjë kushdo pas qejfit e midesë!

24
Shën Johan në batak quhet një kishë. Venedik,
Me arsye dyfishe të quaj Shën Mark në batak!

25
Nëse ke njohur gjirin, ke njohur detin dhe peshqit.
Ja Venediku, njih, pra, edhe llucën edhe bretkët!

26
"Akoma fle?" Mbyll gojën, lemë pakëz që të prehem!
Pse duhet të rri zgjuar? I gjerë e i zbrazët shtrati.
Sardenjë është kudo ku dergjesh dhe fle i vetëm,
Edhe Tivol kudo, ku vajzë e dashur vjen të zgjuan!

---

*1) Bretkët përdoret nga poeti për banorët e Venedikut*
*2) Një lloj lakre, që quhet dhe lakra e Brukselit*
*3) Një lloj vere e zgjedhur, me prejardhje arabe, arak.*

27
Të nëntat muza shpesh ma bënë mua me shenja,
S'ua vura veshin, të dashurën mbaja në prehër.
Pastaj kur mikja iku, më lanë mua edhe muzat,
Kërkova, shpirthelmuar, mos gjeja thikë dhe litar!
Por plot me zotër është Olimpi dhe drejt meje erdhe
Mërzi, ti nënë muzash, ndaj plot me mall të ngjatjetoj!

28
Cilën nga vajzat do? Më pyesni ju. E kam një
E më pëlqen, dhe kjo më duket tepër e mjaftueshme.
Buzës së detit brodha dhe kërkova për guacka,
Në njërën perlën gjeta, e mbaj tani këtu në zemër!

29
Mjaft gjëra kam provuar, vizatova, gdhenda në bakër,
Pikturova, diçka me argjil e kam plazmuar.
Megjithëse pa ngulm, asgjë s'mësova e s'krijova,
Veç një art kam mundur të nxë mjaft afër mjeshtërisë,
Të shkruaj gjermanisht. Kështu unë, poeti i mjerë,
Në një punë të rëndë harxhoj krejt jetën edhe artin.

30.
Fëmijë të bukur mbani dhe fytyrëmbuluar lypni.
Kjo do të thotë zemrës së burrit me forcë t'i flasësh.
Gjithkush do një fëmijë si këta vocërrakë të mjerë,
Dhe një mike si kjo që nën tis heshtaz e mendon!

31
Nuk është pjella jote kjo për të cilin ti lyp,
Megjithatë më prek! Por sa do të më prekë mua
Ajo që një ditë do më sjellë fëmijën tim.

32
Përse i lëpin buzët, kur me nxitim befas më ndesh?
Gjuha jote më thotë sa llapazane ti qenke!

33
Gjermani gjithë artet i nxe e i ushtron, talentin
Në secilën e shfaq, në u kushtohet tërësisht.
Veç një art e ushtron pa e mësuar, poezinë,
Prandaj kaq keq e shkruan. Për këtë miq, kemi përvojë!

34
Shpesh ju, zotër, u shfaqët si miq besnikë të poetit,
Jepni pra ç'ka lipset, pak ju kërkon, aq sa i duhet.
Së pari një shtëpi të mirë, pastaj haje e pije
Të mjaftueshme, gjermani e do si doni ju nektarin.
Pastaj veshje të hijshme dhe miq me të cilët të flasë,
Dhe për natën një mike, ashtu siç ia do vetë zemra.
Këto të pesta gjërat e zakonshme mbi gjithçka i dua.
Pastaj më fal ti gjuhët, gjuhët e vjetra dhe të reja,
Punët dhe historitë njerëzimit t'ia deshifroj.
Ndijim të hollë falmë, si ai që mbrujtet nga arti;
Prestigj para popullit, influencë tek të fuqishmit,
Edhe gjithçka, gjithçka ç'i duhet njeriut në jetë!
Bukur!... Ju përgëzoj, zotër! Ju më bëtë më të lumin
Njeri, sepse më dhatë mjaft nga këto të gjitha!

35
I vogël princi im në mes të princave gjermanë,
E pakët, e varfër toka, i kufizuar pushteti,
Por si t'i drejtosh nga brenda, si t'i drejtosh nga jashtë forcat,
Gjithnjë ke ngazëllim se gjerman mes gjermanësh ndihesh.
Mua ai më ka falur çka të mëdhenjtë falin rrallë,

Simpati, besim, kohë, ara, kopsht edhe shtëpi.
Askujt s'i jam mirënjohës veç atij, se nevoja
Kisha boll, dhe si poet, kuptohet, s'di si të fitoj.
Më ka lëvduar Evropa, por çfarë më ka dhënë?
Asgjë! Sa shtrenjtë i kam paguar vargjet e mia!
Në Gjermani më imituan, më lexuan në Francë.
Me ç'dashuri, Angli, e prite mikun tënd të krisur!
Më ç'mund të kërkoni prej meje, kur edhe kinezi
Në xham me dorë pikturon Verterin dhe Loten?
Asnjë perandor për mua s'pyeti, dhe asnjë mbret
S'e çau kokën. Ai m'u bë August e Mecenat!

36
Ç'është jetë e një njeriu? Megjithatë mijëra njerëz,
Për të mundet të flasim ç'ka bëri e sesi e bëri!
Më e vogël poezia! Megjithatë mjaft ngazëllon
E mjaft e shajnë. O mik, jeto edhe vazhdo thur vargje!

37
Lodhem gjithnjë të njëjtat tablo e pamje duke parë,
Thesaret e artit që Venediku fort i ruan,
Se edhe kjo endje kërkon pak nge edhe pak prehje.
Një bukuri të gjallë me lakmi ma kërkon syri.
Akrobate te ti dallova shëmbëllim fëmije
Si atë që Xhovani Belini pikturoi me flatra
E Paulo Veronezi i ftoi tek "Dhëndri",
Ku miqtë e gënjyer kupa uji pinin për verë!

38
Si nga dorë u skalit pamja e së dashurës,
E brishtë e pa kocka, si një molusk që veç noton.
Gjithçka, nyje e gjymtyrë, gjithçka lëvrin plot lehtësi.

Kam njohur njerëz, kafshë, kam njohur zogj, peshq, zvarranikë
Krejtësisht të veçantë, çudira të nënës natyrë!
Dhe i shtangur, Betina, të shoh, o ç'mrekulli e ëmbël,
Ti je gjithçka kam parë, dhe për më tepër je një ëngjëll!

41
Anash përkulet qafa jote. Se ç'mrekulli! Shpeshherë
Të mban të gjithën. Je e lehtë, por e rëndë për qafën.
Mua s'më bezdis qëndrimi i shtrembët i kokës,
Nën një barrë më të bukur s'm'u përthye kurrë zverku!

42
Si na e trand me pamjet e çuditshme dhe despotike,
Vështrimin endacak skëterrori e i zymti Brygel,
Si mendjen e shëndoshë na e shkallmon Dyreri
Me trajtat apokaliptike, njerëzish e fantazmash njëherësh,
Si na i shtang poeti veshët që s'u shpëton një fjalë,
Kur nis këndon me forcë sfinksi, sirenë e çentauri,
Si e vërtit një ëndërr të paqetin, që shtrin krahët
Ta rrokë, por i shket e rish këtu i del si tjetër,
Kështu na trazon Betina, kur lëviz gjymtyrët e hijshme,
Por ç'gaz që na ka shpirti, kur shkel lehtas në tokë!

44
"Ah me këta të mjerë ç'po bën ai? Jezus Maria!
Grumbuj lëveresh, si ato që ajo mbart tek pusi.
Dhe ja, ra! S'mund ta duroj! Ta ndihim! Sa e hijshme!
Shih, u ngrit! Sa lehtë! Dhe me ç'qeshje e ç'gaz!"
Grua plakë, çuditesh me Betinën! Mua më dukesh
Më e re dhe më e bukur, tek të zbavit mikja e dashur!

45
Gjithçka tek ti me gaz e shoh, por ngazëllohem tepër,
Kur ati yt të hedh plot vrull e shkathtësi në ajër.
Fluturimthi vërtitesh e pas një kërcimi të llahtarshëm,
Në këmbë brof, merr frymë, sikur asgjë me ty s'ka ndodhur!

46
Çrrudhoset çdo fytyrë dhe zhduken brazdat e mundimit,
trishtimi, varfëria ikin. Të lumtur pres të shoh!
Nga ti lundërtari zbutet e të godet lehtas në faqe,
Dhe qesen, që me zor e zgjidh, e hap tani për ty,
Banor i Venedikut çkopsit mantelin, diçka fal,
Sikur plot zjarr të luteshe për mrekullitë e Shën Antonit,
Për pesë plagët e zotit, për zemrën e virgjëreshës,
Për mundimet e zjarrit, të cilat shpirtin dëlirin.
Çdo çunak, lundërtari, çikrrimtari e liparaku
gëzon të të ndodhet pranë e të jetë një fëmijëz si ti!

47
Të shkruash vjersha, ç'punë e bukur! veçse kushton shtrenjtë,
Se teksa libri rritet, *zekinat* nisin të mbarojnë!

48
"Ç'trill çmendurak të kapi? Nuk mundesh dot ta bëke zap?!
Do të bëhet libër vajza? Këndona diçka më të zgjuar!"
Prisni, shpejt do këndoj mbretërit, të mëdhenjtë e tokës,
Megjithëse më parë i kam kutpuar ca më shumë.
Ndërkaq për Betinën këndoj, akrobatja dhe poeti
Një gjaku janë, kërkojnë e gjejnë njëri-tjetrin!

50
E dini se si mund të shkruaj njëqind epigrame
Largomëni nga e dashura dhe gati i kini!

51
Gjithë apostujt e lirisë më ngacmojnë nervat.
Kushdo nga ta, së fundi, për vete e do sundimin.
Në do t'i çlirosh të tjerët, guxo që t'u shërbesh!
Do që ta mësosh sa e vështirë është? Provoje!

52
"Mbretërit duan të mirën, po këtë dhe demagogët!"
Kështu thonë, por gënjehen, njerëz si dhe ne janë!
Mos dilni të thoni se doni vetveten, e dimë!
Në ka ndonjë që do të mirën tonë, le ta tregojë!

53
Çdo të fantaksur tridhjetë vjeçar në kryq mbërthejeni!
E njohu botën dhe na bëhet gënjeshtar kopuku!

55
Kohë të marra rrojta, dhe nuk mungova aspak
Të çmendem edhe vetë, siç ma kërkonin kohët!

56
Thua, s'vepruam drejt? U desh ta gënjenim turmën.
Veç shihe sa e mjerë, veç shihe sa e egër!
Fatkeqë e të egër të gjithë ç'u gënjyen keqas.
Jini të ndershëm, prijeni atë në udhën e mbarë!

57
Princët i gdhendën shpesh në bakër apo në argjend
Fytyrat e veta dhe popullin gjatë e gënjyen.
Vula gjeniu i ngulën gënjeshtrës dhe absurditetit
Fanatikët. Gur prove kush nuk ka, i merr për ar safi!

58
"Të çmendur!" Kështu thatë për oratorët që në Francë
Ndër udhë e sheshe flasin. Dhe mua kështu m'u dukën.
Por në liri maksima plot mend të flet dhe një i lojtur,
Ndërsa tek skllavi goja i mbyllet keqas mençurisë!

59
Mjaft kohë të mëdhenjtë në gjuhën franceze folën
Dhe s'nderohej njeriu që nuk i rridhte nga goja.
Tani populli në frengjisht ngado belbëzon.
Mos u xhindosni, zotërinj! Ç'gjë dëshiruat, po ndodh!

60
"Kaq të paturp mos jini, epigrame!" E përse jo!
Ne vetëm tituj jemi, se botën libri ka për kapituj!

61
Si një apostull që tregon gjithandej një pëlhurë
Të pikturuar me lloj e lloj kafshësh të ndryshme,
Trego dhe ti, o libërth, të larat e të palarat!

62
A është i mirë epigrami? A mundet ta shkoqisësh?
Njeriu s'e kap kollaj se ç'fsheh në mendje qerratai!

63
Kaq fort vërdallë erdhe në zgrip të dhembjes e të zilisë!
Porse kupto më parë se ç'flet kjo grimcë poezie!

64
Betohesh, Kloe, se më do. Nuk të besoj! "Të do!" më thotë
Dikush. Po, në e besoj, gjithçka merr fund për mua!

65
Askënd nuk do, por mua më do kaq shumë, o Filarko!
A nuk ka udhë tjetër, për të më vënë kështu krrusmën!

66
Kaq e madhe e fshehta sa ç'është Njeriu, Zoti, Bota?
Jo! Por askush s'dëgjon, prandaj mbetet gjithnjë e fshehtë!

67
Mjaft gjëra i duroj. Madje dhe gjëra mjaft të rënda,
U bëj ballë me durim edhe pa nxjerrë zë ankimi,
Por pak gjëra si helmin e gjarprit i urrej për vdekje.
Katër: tymin e duhanit, çimkat, hudhrën edhe kryqin!

68
Prej kohësh do të kisha folur për këto kafshëza të vockla,
Që me nxitim e hir ngasin këtu edhe atje.
U ngjajnë gjarpërinjve, por rendim me të katra këmbët,
Zvarrisen, edhe rrëshqasin dhe lehtas pas tërheqin bishtin.
Shiko, këtu, atje! Tani u zhdukën! Ku u futën?
Ç'plasë, ç'bar i strehon këto gjallesa endacake?
Dhe tani këto kafshëza, do t'i thërras me emër, hardhucka!
Akoma dhe tani më duken si imazh i hijshëm!

69
Hardhuckat, kush ka parë vajzat e hijshme, mundet lehtë
T'i përfytyrojë të enden këtu edhe atje ndër sheshe,
Të shpejta dhe të gjalla, vrik shkasin, ndalen, çuçurisin,
Edhe tek rendin prapa u fëshfërin rrobja që mbajnë.
Këtu dhe atje. Nëse s'i ndjek me sy një herë,
Të humbasin sërisht kaq shpejt ato s'të shfaqen.
Po s'të trembën qoshet, rrugët e shkallët e përpjeta,
Shkoju nga pas, të grishin të futesh brenda në një shpellë!

70
Si është shpella doni plot kërshëri ta dini? Ja,
Sa për fjalor më shërben ky libër plot me epigrame.
Shtëpi e errët, udhët e ngushta mjaft, për në kafe
Të prin e bukura, plot përkujdesje ajo, jo ti!

71
Këto të dy hardhucka gjithnjë plot gaz rrijnë së bashku.
Tepër e gjatë njëra, ndërsa tjetra tepër e shkurtër.
I sheh edhe mendon, aspak nuk shkojnë me njera-tjetrën.
Gjithkush peshon pas vetes, e tija i ngjan më e bukur!

72
Thonë, shenjtorët duan veçanërisht fort mëkatarin
Dhe mëkataren. Ndodhtë kjo mrekulli edhe me mua!

73
"Po të isha grua shtëpie e të kisha ç'më duhet,
Do të isha besnike, plot ledhatim do ta prisja burrin!"
Kështu në mes kaq këngësh më këndonte një vajzë e varfër
Në Venedik. Një lutje kaq të devotshme s'kam dëgjuar!

74
Nuk çuditem aspak se njerëzit i duan qentë.
Bredharak dhe i mjerë si njeriu është edhe qeni!

75
Krenar u bëra. S'është ndonjë çudi! Dijeni, zotër,
Dhe jo veç ju, dhe unë besnik jam dhe i devotshëm!

76
E njeh ti shoqërinë e mirë? Librin tënd ua tregon
Veç turmës dhe xhonglerëve. A ka gjë më të ulët?!

Të mirën shoqëri e njoh, sundon veç harmonia,
Nëse një vjershë dhe e vogël, nuk bëhet shkas ngacmimi!

77
Ç'do kishte bërë prej meje fati? E guximshme
Të pyesësh. Nga shumë s'ia ka qejfi të bëjë shumë.
Një poet prej meje bëri, ndoshta ky mendim i lindi
Nga që gjuha s'iu duk dhe aq tepër e pabindur!

78
Me botanikë merresh! Me optikë? Po ç'bën kështu?!
Nuk është ndonjë gjë e vështirë të prekësh zemrën e njomë!
Zemrat e njoma i prek kollaj dhe një dërrdëllitës rrugësh,
Gëzimi im i vetëm, me ty të merrem, o Natyrë!

79
Nga të gjitha ngjyrat të bardhën bëri Njutoni.
Dhe të bardhë e kujtuan gjithçka, pothuaj një shekull!

80
"Gjithçka ma the mjaft qartë!" kështu më thosh një nxënës,
"Çdo teori që ne na e mësoi mësuesi i ditur!"
Nëse një kryq prej druri e gdhendim me mjeshtëri,
Dijeni se një njeri i gjallë atje do të ndëshkohet!

81
Kur udhëve me dredha djaloshi tek mikja vinte,
Në dorë mbante këtë libër, ngushullim edhe joshje!
Dhe kur një ditë mikja me gaz e priste, librin
Ajo sërisht e mbante, e hidhte kur s'ish i nevojshëm!

82
Si shenjat e një vajze, që tek ikën me nxitim,
Fshehtas e miqësisht më godet në krahë,
Kështu, muza, pranojani udhëtarit poezinë
Dhe ruani për mikun një të mirë më të madhe!

83
Kur re e avuj diellin e zënë, ç'orë të zymta
Na fal, sa fort të heshtur bredhim shtigjeve të shkreta!
Kur shiu rreh shtegtarin, një strehë mu në mes të fushës
Ç'e dashur, ç'prehje për trupin mes natës me shtrëngatë!
Por Febi kthehet prapë dhe dëbon larg mjegullën
Nga balli pa një njollë, njëlloj si nëna Natyrë!

84
Në do t'ia ndiesh vërtet gëzimin e vrullshëm dashurisë,
Largo nga vetja jote zymtësinë dhe krenarinë.
Se ta pranojë do njëra e tjetra ta dëbojë,
Me këto kundërshtare qesh hidhtaz Zot i egër!

85
Më kot, Morfe hyjnor, i trazon ti këto lulëkuqe,
Se syri më rri zgjuar, gjersa ta mbyllë dashuria!

86
Dashuri dhe lakmi më zgjoje, ta ndieja dhe digjesha,
Tani, fisnike, zgjo tek unë veç besnikëri!

87
Ah, të njoh, dashuri, më fort se kushdo. Ja ti po mban
Pishtarin dhe pishtari feks para nesh në terr.
Po ti na fut ndër udhë pa krye. Arrijmë ta kapim
Pishtarin, por ajmé, ai nuk bën më fare dritë!

88
Vetëm një natë pranë zemrës sate! Të tjerat kryhen
Vetë. Amori na ndan ende në natë e mjegull.
Po, do ta rroj ditën, kur agimi i gjen dashnorët
Gjoks mbi gjoks shtrënguar e kur Febi vjen e të zgjon!

89
Në e ke me tërë mend, mos e zgjat! Bëmë të lumtur!
Kërkon të luash?! E dashur mjaft, u ngopa me shakara!

90
Nuk të pëlqen që hesht? Ç'të them tjetër? Ti s'e vëren
Gjuhën e psherëtimave, gjuhën e syve shkrepëtitës.
Vetëm një Zot mundet të t'i zgjidhë buzët e kyçura,
Vetëm agimi, po qe se do të më zgjojë pranë teje!
Prandaj himne plot zjarr u ngrej zotërve të mëngjesit,
Ashtu porsi shtatorja *e Menonës*[1] këndon të fshehtat!

91
Se ç'lojë mjaft e bukur! Drejt fillit rishtas vërtitet disku,
Që sapo vrik më shkau nga dora duke çarë ajrin.
Kështu më ngjan dhe zemra. Tani mbi një të bukur sulet,
Dhe sapo kthehet, e gatshme rri të sulet mbi tjetrën!

92
Ah, me ç'mall e kam pritur ardhjen e stinëve të vitit,
Përshëndesja pranverën dhe zemra më digjej për vjeshtën.
Por s'ka më verë e dimër që kur më mbuloi me flatra,
Të lumin, dashuria, ka veç pranverë të përjetshme!

---

*1) Menona një orakull si i Delfit.*

93
Thuaj si e çon? Rroj! Dhe sikur qindra mote njeriu
Të rronte, të nesërmen po kaq fort si sot do ta doja!

94
Zotër, si t'ju falënderoj! Gjithçka më dhatë mua.
Gjithçka që një tjetër kaq fort do ta dëshironte,
Veçse sipas rregullit, kjo, pothuaj, s'është asgjë!

95
Në mug mëngjesi ngjitesha në majën më të lartë,
Si mushtullak të ditës të përshëndesja, o yll mik!
Me padurim vështrimi priste të shfaqej mbreti i qiellit,
O vrulle djaloshare sa shpesh më grishët jashtë shtëpisë natën!
Tani si lajmëtarë të ditës më ndrijnë sytë
E mikes dhe tek unë më herët zbardh agimi!

96
Çuditesh dhe më tregon detin, duket sikur digjet.
Si i sulet dallgë e përflakur vrulltas natën anijes!
Nuk çuditem nga kjo, deti lindi Afërditën,
Dhe prej saj a nuk brofi drejt nesh një flakë, i biri?!

97
Shikoj si shkëlqen deti dhe llamburitin ëmbël valët!
Shpejt nga era e mbarë rrëshqasin tej varkat me vela.
Asnjë mall nuk më ndien zemra. Prapa më kthehet syri
Im i dëshëruar, nga dëbora e maleve.
Në Jug ka mjaft thesare. Por sërishmi për nga Veriu
Më tërheq një magnet, me forcë që s'i bëj dot ballë!

98
Ah, po më niset mikja! Hipi në anije! Imzot,
Eol, prijës i fuqishëm, mbaje, mbaje shtrëngatën!
"I çmendur! ma kthen ai. – Mos të të tremb shtrëngata,
Trembju flladit që fryn, kur dashuria lëviz flatrat"!

99
Shpeshherë e kam humbur e shpeshherë e kam gjetur dashurinë,
Por asnjëherë më të lumtur. Kjo vajzë – lumturia!
Në dhe kjo është zhgënjim, zotër që jeni më të zgjuar,
Më merrni e më lini atje në bregun e ftohtë!

100
I trishtuar, Mida, fati yt në duart që të dridhen,
Plak i uritur, ndien peshë hajesh që tjetërsohet.
Mua, në rast të ngjashëm, por më me gaz më iknin orët,
Çdo gjë që prek me dorë më kthehet në poezi.
Muza, s'ju kundërshtoj veç nga shkaku se të dashurën
Teksa e mbaj në gji, s'ma ktheni befas në përrallë!

101
"Ah, ç'm'u enjt pakëz qafa!" më ankohet plot ankth e dashura.
Hesht, fëmijëz, hesht dhe dëgjoni këto fjalë:
Ty të ka prekur me dorë Venusi e nën zë të bëzën,
Se shpejt do të shëmtohet shtati i hedhur dhe gjoksi i hijshëm.
Por qetësohu! Lulet që bien kopështarin e lajmërojnë
Se fruti do të piqet në vjeshtë plot lëng në pemë!

102
E këndshme të mbash miken në krahët dëshirake,
Kur zemra që rreh për së pari rrëfen dashurinë,
Por më e këndshme përpëlitja e qenies që lind,

Që mbi prehërin e dashur mëkohet e lëvrin.
Tani ajo po provon sulmet e rinisë së vrullshme,
Plot padurim rreh e psherëtin nën dritën e qiellit.
Prit edhe pakëz! Nëpër të gjitha shtigjet e jetës
Hijerëndat Orë do të prijnë pas urdhërit të fatit.
Ti e kupton se ç'do, o qenie e dashur që rritesh.
Dashuria të formon, dashurinë paç në short!

103
Kështu vija vërdallë, i ndarë nga gjithë miqtë,
Në qytet të Neptunit, duke harxhuar ditët e orët.
Ç'provoja, aromën e vet u jepte kujtimi,
Por ato të shpresës janë më të dashurat aroma!

104
E çlirove popullin tënd mes dhimbjes e mrekullisë
Nazaren! Për ku po ikën turma jote, për ku?
Megjithëse duhet të rrojë e të lindë fëmijë,
Joshjes së hershme i sherben risht dora dëmsjellëse!
Nëse i riu e mposht të keqen, pa prishur veten,
Lais silli atij mundimin zhuritës për endje!
Zbrit dhe një herë, Zot, që krijove njerinë,
Zbrit dhe popullin çliroje mes dhimbjes së dyfishtë!
Bëj thagmën, pastro gurrën e gëzimit dhe të jetës,
Për ty Shën Pavli bëhem, Shën Stefan, si të urdhërosh!

108
Gaforret bythëzbuluar guaska boshe kërkojnë,
Futen dhe kujtojnë se janë në shtëpi të tyre!
Ji imja krijesë e rrallë, ji e zgjuar siç duhet!
Diçka më erdhi në mendje, kur atë në breg pashë.
Krishti dhe njeriu – një! – the Lavater. E drejtë. Të krishterët
Me mençuri njeriu rrahin të maskojnë trupin!

109
Me një teatër kukullash u dashurova që i vogël.
Mjaft kohë më joshi, por më së fundi e shkatërrova.
Kështu Lavateri u kap pas kukullës në kryq.
E mikloi atë i rrejtur, gjersa i doli fryma!

110
"Të mirë!" shkroi e besoi se gjindja do të bëhej e mirë,
Se këtë dëshmi abstrakte do mundet ta kuptojë.
"Të mençur!" mendoi të shkruante, gjëkund nuk shoh të mençur:
Në qënka mençuri, me qejf them, o Zot, se jam i marrë!

111
Të gënjen burri i shtetit, prifti dhe moralisti,
Dhe kjo gjethe tërfili, që ti i lutesh, o turmë.
Sa keq që s'më lenë të them se çka është e drejtë,
Që ta damkos këtë shtet, perënditë dhe moralin!

112
Ç'bënë heronjtë, ç'na mësojnë të urtët, e përbuz
Krenaria krishtere bri mrekullisë së Zotit.
Por ajo stolis veten dhe çlironjësin cullak
Me mbeturinat që nga vetja i flakën paganët.
Kështu prifti mbledh mbeturinat e qirinjve që digjen
Rreth bukës së meshës, që Zotit t'ia blatojnë!

113
Mjaft të ndoqën e të besuan dhe rrugën e jetës
E ngatërruan, siç e ngatërrove dhe e humbe dhe ti.
Ty pas nuk do të të ndjek! Të mundem gjer në fund të ditëve
Të mbetem burrë pa mend, i dashuruar pas gëzimit.
Megjithatë sot të dëgjova dhe zgjodha shtegun e malit,
Por mos të ta marrë mendja, mbret judejsh, se t'u nënshtrova!

114
Qënka hapur varri! Ç'mrekulli e madhërishme! Zoti
U ringjall! – Kush ju beson! Maskarenj, shporruni këtej!

115
Ç'ka vlen për krishtërimin, vlen dhe për stoikët! I lirë
njeri mos iu nënshtro atyre, kushdo ata na qofshin!

116
"Çifut e pagan përjashta!" – bërtet një i krishter.
"Krishter e pagan dëboni" – murmurin një çifut.
"Të krishterin në hell dhe çifutin mes prushit të zjarrit!"
- Këndon një çunak turk mjaft hidhur duke i tallur.
Kush është më i zgjuar? Hajt, zgjidhe! Këta të marrë
Le të rrijnë në pallatin tënd, Zot, unë iki tutje!

117
Hije të skëterrës jeni ju dhe jo të krishterë,
O tellallë që gjumin nga sytë e mi ma trembët.
Përse prifti bëri mijëra lëvizje e gjeste
Dhe s'ju trembi që të shkonit në skëterrë përsëri?

118
Kur një gjellbërës i zoti gatit një gosti të mirë,
Në të fut dhe përzien lloj e lloj gjërash njëherësh.
Kështu ju shijon ky libërth dhe mezi do të dalloni
Nga të gjitha, ç'ju pëlqen. E merrni, ju bëftë mirë!

119
Thomëni kujt t'ia hap librin? Princeshës që qejfin mua
Ma ka treguar, që si Itali po bën Gjermaninë?!

120
"Guxo gjermanisht të shkruash për gjëra të pahijshme!"
- Miku im, gjermanishtja e këtij qoshku të vogël
Mundohet dhe rropatet të jetë greqishtja e botës!

121
Nga një shije e pështirë u dogj Nauger Marciali.
E flake argjendin tutje se nuk është ar? Ç'pedant!

123
Sikur bota të hapi sytë! Sikur të mund të ndodhë!
Më mirë të rëmosh vetveten dhe të gjesh ç'të takon!

124
Ç'bretkoca të mjera, ju që banoni në Venedik!
Dilni nga uji përjashta dhe hidhuni mbi shkëmb!

125
Një kafaz të bukur vështroj, që prapa hekurave
Lëvizin dhe këndojnë ëmbël vajzat e hijshme.
Vajzat s'dinë veç si të na mundojnë, (Venedik
Qofsh lavduar, që i rrit!) dhe si të na përtërijnë!

126
Të ka ndjekur Himeni? I je shtangur atij? - Ç'po them?
Himeni! Ç'gjë e çmuar, por sa serioz qe për mua!
Të fshehtat e shtratit s'tregohen, por poetët llapin,
Dashuria u zgjidh gjuhën edhe u rrit guximin!

127
Moj vajzë i them një çupe, e ke tët zot në shtëpi?
Ajo s'më dëgjon, thirrja ime s'arrin në vesh!

128
Katër fëmijë të këndshëm i mëson për akrobatë,
Mjeshtri plak, dhe i dërgon tek ne të mbledhin para.
Pasurinë time e mbart me vete! thotë i urti,
Pasurinë time, thua ti, e krijoj me duar vetë!

129
Amerikane e quan bijën tënde, o i fantaksur
Plak, por a s'e mbrujte atë këtu në Evropë?

130
Me ju këshillohem! Jini të zotë, thua ti,
Dhe më zgjat mua pjatëzën, buzëqesh e plot hir
Më falënderon. Ah, mjaft, mjaft më me këshillme!
Sikur të ishte më i vjetër, do deshnim të ishim më të zotë,
Dhe do të rrinim zgjuar gjersa të këndonte gjeli!

131
Mos u zemëroni, gra, se ne na pëlqejnë vajzat,
Gëzim na falni, natën, ato në mbrëmje na ngacmojnë!

132
I huaj, imzot? Banon në Venedik? Kështu pyesin
Dy hardhucka që më joshin brenda në tavernë.
Fol! Je francez apo napolitan? Ato dërdëllijnë
Herë pas here dhe rufisin kafen me të shpejtë.
Bënë diçka! Thotë më e bukura dhe e lë tasin
Poshtë, teksa ndiej, sakaq, dorën e saj të zellshme,
Plot butësi ia kap, ia shtrëngoj dhe e dyta gishtat
E brishtë i zgjat, por asaj ia prapësoj dorën.
Ah, je i huaj, thërrasin të dyja dhe tallen,
Dhe më zhvasin dhurata që i jap me kursime.

Pastaj më tregojnë banesën e largët të tyre,
Ku do të lodrojmë gjer në orët e vona të natës.
Por këto dijnë, sakaq, të huajit të mos i jepen,
Ah, kështu i përvidheni ju venecianit të zbehtë!

133
Të gjithë, o çunak, më thonë, se mua ti më mashtron,
Oh, më gënje, më gënje gjithnjë edhe më tepër!

134
Ç'shpresë kam? Vetëm këtë që sot më zotëron,
Nesër të shoh miken, kam tetë ditë pa e parë!

135
Gjithçka ç'kini dashur, ua kam plotësuar gjithmonë,
Moj mike, por të fle i vetëm, këtë nuk e durokam!

136
Nuk do të shtrihesh pranë meje e zhveshur, e dashur?
Turpi të shtrëngon të rrish me rroba e mbështjellë.
T'u kem lakmi rrobave? Mos ta dua kurmin e bukur?
Vetë trupi është një rrobe! Mes nesh krejt e tepërt!

137
Një dashuri kërkova, por s'gjeta asgjëkundi.
Dëshira s'më ka ikur, por ta fitosh s'është lehtë!

138
Mos u tremb, mike e dhëmbshur, në gjarpëri do të të dalë!
Eva s'u tremb, pyete priftin, po deshe, fëmijëz!

140
E bukur dhe e gjerë bota, por e bekoj qiellin
Se më dha këtë kopësht të pakët, që e kam timin!
Kthemëni në shtëpi! Ç'i duhen kopshtarit udhëtimet?
Nder dhe gëzim i jep atij që për të përkujdeset.

141
Ah, e vari kryet gonxhja e hijshme, kush i hedh
Me zell në rrënjët e saj ujin gjithçkapërtëritës?
Të çeli plot gaz, duhet orët plot hir të lulëzimit
Kaq shpejtas mos vrapojnë, që të mund të piqet fruti!
Por dhe mua më var kryet plot halle e mundime
Vajza e dashur! Një kupë verë që shkumëzon, sillni!

# Elementet

Pa me ç'elemente vallë
Ta mëkoj, ah, këngën time,
Turmë e verbër mos më tallë,
Mjeshtërve t'u fal gëzime!

Dashuria mbi çdo tjetër
Kryetema që këndojmë,
Prek të ri e prek të vjetër,
Kur plot vrull vargjet kumbojnë!

Tinguj gotash, krejt të çlirë,
Perla vere magjiplotë!
Çdo dashnor e çdo i pirë
Fort na josh në këtë botë!

Pastaj vringëllima shpate,
Gjëmim briri e trumpete!
Kush marshon përball shtrëngate
Ndjell lavdinë pas me vete!

Pastaj s'është e palejuar
Mos urrej plot mllef poeti
Ç'do të keqe e të shëmtuar
Që njollos dhe hone deti!

Dhe mëso si për t'i shkrirë
Në një lëndë, pa u lodhur,
Si Hafizi shpirtdëlirë
Do të mbetesh ti në popull!

# Pakufishmëri

Çka dot s'mbaron ,të bën të madh e burrë,
Dhe fati yt fillim që nuk nis kurrë,
Dhe kënga një kube e yllëzuar,
Fillimi e mbarimi të njësuar,
Dhe kur në mes arrin krejt është shqim
Çka mbet në fund apo çka nis shtegtim!

Je gurrë ngazëllimesh poetike,
Që derdhen ëmbël rrjedhave magjike.
Për puthje gojë që rri pret,
Një këngë që gufon nga malli,
Për pije grykë plot me rreshk,
Dhe zemër që s'njeh llum moçali!

Le të gremiset botë e mjerë!
Hafiz, me ty të jem kam mall
Në garë! Gaze e dhimbje mal
Të shkulen, ne u bëjmë ballë!
Të dua e të pi ngaherë
Si ti, se ç'krenari e rrallë!

Pra merrja këngës me zjarr ti,
I vjetër je e risht i ri!

# Pohim

Ç'është e vështirë që të fshihet? Zjarri!
Mes ditës një rremb tymi e tradhton
E natës flaka, ç'përbindësh llahtari!
Larg zor të fshihet malli që mundon,
Dhe pse rri heshtas dhe i qetë
Nga sytë e dallon qartë e lehtë!
Më të vështirë s'ka se poezia
Atë s'e fsheh sënduku, as qelia!
Sa del nga buzët e poetit,
Vrapon me vrap tek zemra e rrëmetit,
Dhe sa u hodh plot prush në letër
Ky dhé e do mbi çdo gjë tjetër!
Kushdo me gaz zë e lexon,
Dhe në mundon a në gëzon!

# Kufizim

S'e di se çfarë më pëlqen
Në këtë dhé, kur s'ke nga vjen,
Me lak magjik keq më mbërthen!
Dhe dua të harroj, për pak,
Si po më sjell fati vërdallë,
Dhe ndiej nga afër e nga larg
Diçka si mbruhet pa u ndalë.
Sikur të mund të gjendej masë e drejtë!
S'mbetet për mua tjetër gjë,
Veç plot me forca e gjithnjë
Të ardhmen të shpresoj dhe në të sotmen e qetë!

# Katër dhuratat

Allah i madh e fuqiplot,
Shkretirash të pamata,
Arabit na i dha për short
Këto katër dhurata:

Një çallmë që më bukur ndrin
Se çdo kurorë mbreti,
Një çadër që e mban mbi shpinë,
Nën të pushoi e fjeti.

Një shpatë që më tepër mbron
Se shkëmbi e se muri,
Një këngë që shpirti e këndon,
Kur vajza çel si nuri!

# Malli i lumtur

Mos ua thuaj, veç mendtarit,
Sepse turma keqas tallet!
Himn i ngre kujt përmes zjarrit
Vdekjeprurës vetë kallet!

Në fllad netësh dashurie,
Që të lindën, ndjen tek gjiri
Dallgë malli, çmendurie,
Tek shkëlqen heshtas qiriri!

Dhe nuk mbetesh i ngujuar
Brenda territ, shtang e mpirë,
Tek shtyn mall i përvëluar,
Për t'u shkrirë e përtërirë!

Nuk të trembin largësia,
As pengesa, as llahtare,
Dritën do, nga dashuria
Porsi flutur digjesh fare!

Dhe po s'ndjeve nëpër jetë
Mall të vdesësh, të ringjallesh,
Mysafir i zymtë, i zbehtë,
Je në tokën plot me halle!

# Jehona

Tingëllon bukur, kur në dell poeti
Diellin që ndrin me mbretin krahason,
Por shpejt fshihet pas shkrepit a tej deti
E nëpër natë e terr shket e lëngon.

Mbërthyer keq porsi në burg nga retë
Humb nëpër natë qielli blu-smerald,
Më liget e më tretet faqja e zbehtë,
Pikon nga dhimbje loti si kristal.

Mos më lë vetëm nëpër zi e natë
Ti pishtarmbartës, pamje si agim,
O ti kandil, ti dritë jetëgjatë,
Ti dielli im e ti gëzimi im!

# Pamje malore

Ky diell i ndritur, i gëzuar,
Çan udhë qiellit pa përtim,
Krejt botën për ta pushtuar,
Vështron ngado pa një ndalim!

Shih, perëndesha[1)] po derdh lotë,
Kjo motër resh e bijëz qielli,
Ndaj do t'ja falë i prekur fort,
Veçse asaj çdo rreze dielli!

Dhe ka kaq dhimbje e fërgëllime,
Përgjon si loti rrjedh rrëke,
Ç'pasion i zgjojnë kaq trishtime,
Ç'e puth çdo pikë që shket përdhé!

Ajo vështrimin e paskajë
E kap e sheh në lartësi.
Çdo perlë do atij t'i ngjajë,
Çdo perlë mban pamjen e tij!

Plot ngjyra e nën hark të ndritur
I çel fytyra gëzimplot,
Drejt tij vërsulet shpirtzhuritur,
Por ah, atë s'e kapka dot!

---

*1) Nënkupto ylberi.*

Kështu dhe mua, ç'fat i vrazhdë,
Prej meje, mike, ikën, shkon!
Dhe po të jem si diell i artë,
Ky më jep ç'më duhet, ç'më ndihmon?!

# Gëzim dhe dhimbje

Poezia se ç'guxim!
Kundër më del kush?
Kërkon vrull, edhe trazim,
Gjak që ndizet – prush!

Dhe sikur çdó orë vrer
Të më sjell' gjithnjë,
Do ta ndrydh dhimbjen që ther,
Pa ankim, pa zë!

Thjeshtësia ç'ar, ç'shkëlqim,
Flet një plak, usta,
Që kaq mote pa përtim
Më mësoi gjithçka!

Murg që s'mban kapuç e zhgun[1)],
Dërrdëllin më kot!
Ti më vret, por nuk ma shkul
Thjeshtësinë dot!

Frazën tënde kallp e bosh
Nëpër udhë boll
E kam shkelur, ta mësosh,
Nën thundra, nën shollë!

---

*1) Gëtja sulmon kritikët moralizonjës që i sulen asaj poezie që nuk i nënshtrohet urdhrave të kanuneve zyrtare, dhe ndëshkon e fshikullon gënjeshtrën e jetën boshe të shtresave të pasura në fuqi.*

Në punon mokra gjithnjë,[1)]
Gjë atë s'e ndal!
Kush dikur na kuptoi ne,
Ne me gaz na fal!

---

*1) Poeti e krahason procesin krijues poetik me punën e një mulliri.*

# Timuri dhe dimri

Kështu i rrethoi dimri
Me tërbim të egër. Derdhi
Mbi gjithçka frymën e akullt.
Erëra të ndryshme yshti
E mbi ta keq i përplasi.
Dhe pushtet i dha murlanit
Me thëllim e cingërima.
Te Këshilli i Timurit[1)]
Zbriti, shfryu e kanosi:
"Ec ngadalë, mor i mjerë,
O tirani i së keqes!
Duhet më t'i përcëllojnë
Zemrat flakët që ti kalle?!
Në ti je një shpirt i nëmur,
Tjetri unë jam, pra dije!
Ti je plak, plak jam dhe unë,
Tok ne ngrijmë dhé e njerëz.
Ti je Mars, unë Saturn,
Yje që sjellin veç vdekje.
Në bashkimin më të tmerrshëm
Ti vret shpirtin e ftoh ajrin,
Fryma ime më e ftohtë
Është nga ç'mund të jesh ti!
Gjindjes rreth e qark ushtritë
I shkaktojnë mjaft mundime.
Por mes ditëve të mia
Më e keqja do të gjendet!

Nga kjo ty s'do të fal gjë.
Dhe dëgjo se ç'po të them:
Plak nga ftohtësi e vdekjes
S'do të munden të të mbrojnë
As thëngjijtë prush të vatrës
E as zjarret e dhjetorit!"

---

*1) Timur Lengu prijës ushtarak, pushtues e tiran mongol, në fillim të shekullit XV.*

# Nga erdha?...

Nga erdha? Çështje mjaft e ngatërruar!
Udhën nga shkela, thuaj, s'e njoh hiç.
Po sot edhe këtu, ç'ditë e bekuar,
Gëzim e dhimbje u ndeshën si miq!
O ç'fat, kur tok ata kështu bashkohen!
I vetëm, kush s'qan dot e kush s'gëzohet!

# Dhe në një mijë forma

Dhe në një mijë forma po të fshihesh,
Moj, Gjithedashura, rish të shoh ty!
Edhe në tis magjik po të mbështillesh,
Moj, Gjithepritura, rish të shoh ty!

Në shtat të qiparizit të dëlirë,
Gjithkunderritura, rish të shoh ty!
Në valët e rrëkesë si safirë,
Gjithkundmiklonjësja, rish të shoh ty!

Kur shatrivani çurkë ngre përpjetë,
Gjithlodërtarja rish, po të shoh ty!
Kur vend e pamje na këmbejnë retë,
Moj, Pamjeshumta, rish po të shoh ty!

Nëpër qilim plot lule të luadhit,
Moj, Gjithehijshmja, rish po të shoh ty,
Dhe në një shall që tundet lehtas flladit,
Gjithkundendodhura, rish të shoh ty!

Kur mali nga agimi ndizet flakë,
Moj, Gjithendritura, rish të shoh ty!
Dhe kur mbi mua qielli vjen përqark,
Gjithkund e endura, rish të shoh ty!

Çka ndiej nga jashtë e çka ndiej përbrenda,
Moj, Gjithkahnxëna, e njoh drejt nga ty!
Dhe në i jap Allahut qindra emra,
Çdo emër tingëllon vetëm për ty!

# Shah Behramguri

Shah Behramguri  e zbuloi rimën
Dhe vrull i shpirtit në të gjeti shteg.
E dashura iu gjegj shpejt, për një grimë,
Me fjalë plot kumbim, pa salltanet!

Kështu dhe ti, e dashur, nis m'i thua
Se ç'rima gjen me gaz e lehtësi.
Si shahut, Sasanidi edhe mua
I tërë më përket, ç'ta kem zili!

Më shkundën këngët mike, që më fale,
Ndaj jam plot gaz, t'i them këto plot shpirt!
Si syri syrit i flet qindra fjalë,
Kështu na flasin tingujt, melodité!

Sërish nga ti, dhe larg nëpër shtegtime
Fjala arrin. Dhe pse s'ka harmoni
Në të nuk shuhen  yjet plot shkëlqime,
Në të sa malle mbart kjo gjithësi!

# Zulejka

Ç'kuptim ka, mik, kjo fërgëllimë,
Mos sjell lindja lajm të mirë?
Krah i saj plot fërfëllimë
Më freskon zemrën e nxirë!

Lot me pluhur e me fletë,
I ndjek retë bredharake,
Shtyn drejt pjergullës përpjetë
Kaq shumë kandra zhurmërake!

Ia zbut diellit përvëlimin,
Më freskon gushën e nxehtë,
Puth hardhinë tek merr shtegtimin,
Shfryn tek kodra, tek rrëketë!

Dhe më sjell me fëshfërime,
Që nga miku kaq të fala,
Pa u errur kodra mirë
Sjell të puthura të vala!

Mund të çash ndër kaq rrafshira,
Ndihmo miq e të munduar,
Nëpër muret, tek rrëpira,
Pret djalosh i dashuruar!

Ah, se lajmin kaq të shtrenjtë,
Ku freskohet dashuria,
Ma flet gojë e tij vetë,
Ma fal buza si qershia!

# Ribashkimi

... ... ... ...

Kështu dheu i flinte gjumë
Në gjoks Zotit rrezear,
Por mes vrullesh det e lumë
Urdhër dha zëbuçimtar.
Dhe "Të bëhet!" tha një fjalë,
Që jehoi me vrap kudo!
Edhe lindi si e gjallë
Gjithësia, pa shiko!

Dhe shpërtheu ngado drita,
Dridhej terri keq prej saj,
Dhe të shfaqej i erdh dita
Çdo gjallimi skaj më skaj.
Hapësira e paanë
Plot me ëndrra e turbullim
Shkundi gjumin anembanë,
S'kish një mall, një tingëllim.

Gjithçka heshtte, ish shkretirë,
Zoti ish krejt fillikat.
Krijoi agun ndjellamirë,
Që ndriçon mbi lug e shpat.
E dëboi turbullirën,
Me kaq ngjyra rreth e qark;
E gjithkush mundej dëshirën
Ta përmbushte, s'kish një cak!

Me një rrekje që s'njeh frerë,
Duam ne se ç'na përket,
Në këtë jetë pa fund, të gjerë,
Syri, zemra fort na flet!
Kemi gaz a hidhërime,
Veç të jemi tok gjithnjë,
Zoti s'bën më dot krijime,
Vetë ta ndërtojmë çdo gjë!

Si me flatra, ara, pyje
Çaj e vij tek ti me gaz,
Dhe nata me qindra yje
Lidhjen tonë vulos çdo ças.
Le të jemi tok përherë,
Burrërisht në gaz e zi,
Dhe "Të bëhet" asnjëherë
Mos më ndajë dot nga ti!

# Kënga e Muhametit

Shihni krojin që del nga shkëmbi
Gëzimkulluar,
Si një vështrim yllor;
Frymërat e mira
Përmbi re
Mëkuan rininë e tij,
Mes shkarrëzimesh e kaçubesh!

Plot rini
Hidhet nga reja
Mbi shkëmbinjtë e mermertë tatëpjetë,
Dhe brohoret përsëri
Drejt qiellit!

Mes grykash thepa-thepa
Sulet pas guralecëve laramanë
Dhe me hap të shpejtë
I rrëmben pas vetes
Krojet, vëllezërit e tij!
Ajte poshtë në luginë
Nën këmbë i çelin lule,
Dhe livadhi
Prej frymës së tij gjallon e bleron.

Megjithatë s'e ndalon as hija e luginës
Dhe asnjë lule,
Që i pushton gjunjët

Dhe e përkëdhel me vështrimin plot dashuri.
Drejt fushës sulet hapi i tij,
Duke dredhuar si gjarpër!

Përrenjt i ngjeshen
Ndër bri. Ai shket tani,
Duke shëndritur si argjendi në fushë,
Dhe fusha shkëlqen me të,
Dhe lumenjtë e fushës
E përrenjtë e malit
I brohorasin me ngazëllim e i thonë: Vëlla!
Vëlla, merrna me vete,
Merrna për tek ati yt i plakur,
Tek i përjetshmi oqean,
Që krahëhapur
Na pret,
Ah, më kot hapen krahët,
Për të pushtuar ato që i dëshëron shpirti,
Se ne na gëlltit në shkretëtirën përvëluese
Rëra lakmitare, dhe dielli lart
Na thith gjakun, dhe një kodër
Na pengon të shkojmë tek liqeni! Vëlla,
Merr me vete vëllezërit prej fushës,
Merr me vete vëllezërit prej malit
E të shkojmë tek ati yt i thinjur!" –

- "Ejani të gjithë!"-
Dhe fryhet
Më madhërishëm, një gjeneratë e tërë
E ndjek princin për në lartësi!

Dhe në gumëzhitësin ngadhnjim e triumf
U jep vendeve emra, dhe nën këmbë
I ngrihen kaq qytete!

I papërmbajtur sulet më tej,
Lë prapa majat e përflakura të pirgjeve,
Shtëpitë prej mermeri, një krijim
I vetë plotësisë së vet.
Shtëpi prej kedri mban Atllasi
Në shpatullat gjigande, mbi krye
Duke fëshfëritur i valaviten
Nëpër erë, mijëra flamuj,
Dëshmi e së tijës madhështi!

Dhe kështu ai ia dërgon vëllezërit,
Thesaret dhe fëmijët e tij,
Prindit mallzhuritur,
Plot shpërthime ngazëllimi në zemër!

# I perëndishmi

Fisnik të jetë njeriu,
I gatshëm për ndihmë dhe i mirë!
Vetëm kjo e dallon
Nga të gjitha qeniet,
Që ne njohim!

Lavdi qenieve të larta,
Të panjohura,
Që i marrim me mendje!
Atyre t'u ngjasojë njeriu;
Shembulla e tij të na shtyjë,
Që ato t'i besojmë!

Krejt e pandieshme
Është natyra:
Dielli ndriçon
Dhe mbi të ligun, dhe mbi të mirin,
Dhe për keqbërësin
Dhe për zemërfloririn, shkëlqejnë.
Hëna dhe yjet!

Erë dhe lumenj,
Gjëmim dhe breshër,
Shungullojnë dhe shpërthejnë,
Dhe duke ikur rrëmbimthi
Ato kapin
Herë njërin e herë tjetrin!

Kështu vepron edhe fati,
I verbër çapitet mes turmës,
Dhe herë godet pafajsinë
Flokëdrudhe të çunakut,
Dhe herë çaçkën e kokës
Të shogët të mëkatarit!

Pas ligjeve të fuqishme,
Të nderuara e të përjetshme,
Ne që të gjithë
Duhet të përmbushim
Qarkun e rrojtjes sonë!
Vetëm njeriu
Mundet të bëjë të pamundurën.
Ai shkoqit edhe peshon,
Zgjedh edhe gjykon,
Vetëm ai mund ta bëjë çastin
Të zgjatet në pambarim!*)

Vetëm ai ka mundësi
Të shpërblejë të mirën,
Të ndëshkojë të ligën,
Të shërojë e të shpëtojë,
Dhe të bashkojë për dobi
Gjithçka të përhumbur e të hallakatur!

---

*) *Përjetësia arrihet përmes artit. (Shënim në origjinal)*

Dhe ne i nderojmë
Të pavdekshmit,
Sikur të ishin njerëz,
Sikur të bënin në përmasa të mëdha,
Atë që më i miri nga ne, në kut të vogël,
Ka bërë apo do të deshte të bënte!

Fisnik të jetë njeriu,
I gatshëm për ndihmë dhe i mirë!
Pa u lodhur të farkëtojë
Të dobishmen dhe të drejtën,
Dhe të jetë një shëmbëllesë
E qenieve që ëndërrojnë!

# Ganimedi

Si më flakëron rreth e qark
Me shkëlqimin e mëngjesit
Pranverë, o dashuri!
Me kënaqësi njëmijëfishe dashurie
Më sulmon zemrën
Ngrohtësia e përjetshme
E ndjenjës sate të shenjtë,
Bukuri e pafund!

Sikur të mundja të të pushtoja
Me krahë!

Ah, në gjirin tënd
Dergjem e lëngoj
Dhe lulet e tua e bari yt
Më sulmojnë zemrën!
Ti, erë e dashur e mëngjesit,
Zhuritësen etje të gjoksit
Ma fresko lehtas!

Thërret bilbili plot mall
Nga lugina me mjegull, pas meje.
Po vij! Ja erdha!
Për ku? Ah, për ku?

Lart! Për lart synimi!
Shtegtojnë retë
Lart dhe i nënshtrohen
Mollplotes dashuri!
Mua! Mua!
Në prehërin tuaj
Lart!
Duke pushuar i pushtuar!
Në gjirin tënd drejt lartësisë,
O gjithdashuronjësi atë!

# Në një flutur

Në një flutur si një yll
Do të bredh, kur të kem vdekur,
Nëpër vendet që i dua,
Do shoh gaz sërish i etur,
Ndër luadhe, në çdo krua,
Në çdo kodër, në çdo pyll!

Do përgjoj një çift të ri,
Kur mbi vajzën si vetë jeta
Do të shoh plot mall përtokë,
Ah, gjithçka ç'më mori vdekja
Do ta gjej në këtë tokë.
Do ndiej vrull e gjallëri!

E pushton mikun plot gaz,
Edhe goja ndezur shpuzë
Shijon gazin e bekuar,
Hidhem përmbi gjoks e buzë
E nga faqet përmbi duar
Vij rreth tyre në çdo ças!

Mua fluturën më sheh
Edhe dridhet nga dëshira,
Brof e unë iki tutje.
"Mik, pa ngjitu tek rrëpira
Dhe ma kap, mos prit më lutje,
Gjënë e vogël, ja, atje!"

# Johana Sebus

*(Për kujtim të 17 vjeçares së bukur dhe shpirtmirë nga fshati Brienen, që u mbyt më 13 janar 1809, për të shpëtuar të tjerët gjatë akujve të Rinit dhe gjatë këputjes së digës së Kleverhamit).*

Këputet diga, fusha rënkon,
Ujët vërshon e vala gjëmon.
"Të marr, moj nënë, përmbi krah,
S'është aq thellë, çahet në vah!"
"Mendo dhe për mua me këta të tre
Fëmijë, bri teje banojmë, s'na njeh?
Nuk kam më fuqi... Po ikën, pra, ti?" –
Mban nënën ajo e çan me furi.
"Vraponi dhe prisni te kodra përqark,
Shpëtuat të gjithë, do kthehem për pak!"
"Akoma e thatë kjo çukë përbri,
Ma merrni dhe mua atje këtë dhi!"

Shkallmohet diga, fusha rënkon,
Vërsulet ujët, vala gjëmon,
Në vend të sigurtë nënën e nxjerr
Dhe kthehet Suzana mes dallgësh plot tmerr.
"Ku vete? Ku vete? Mjaft ujët u fry!
Gjëmojnë dallgët, s'i sheh dot me sy,
Të çash thellësirat kërkon me guxim!"
"Po duhet dhe mundet të gjejnë shpëtim!"

U zhduk diga krejt nga deti buçet,
Kodrina e vogël nën ujë humbet.
Hap gojën, tjerr shtjella gremina për tmerr,
Fëmijë e grua mes shkulmesh i merr.
Tani brirët dhisë këtej s'ia sheh më,
Gjithçka krejt u zhduk e humbi pa zë.
Suzana e bukur qëndron e lufton.
Fisniken e re kush vallë e shpëton?!
Suzana si ylli mes dallgësh në varg,
Për çdo shpëtimtar ajo ndodhet larg.
Buçet përqark uji që s'njeh asnjë skaj,
Asnjë lundërtar nuk sulet drejt saj.
Vështron dhe njëherë në qiellin që nxin
Plot afsh, përkëdhelje kjo valë e përpin.

S'ka digë, s'ka fushë!... Atje e këtu
Për vendin tregon një pirg e një dru.
Përmbytja mbuloi gjithçka, pa shiko,
Imazh i Suzanës po endet ngado!
Ja, uji, po ulet, del tokë e hendek,
Suzanën e qajnë me vaj në çdo breg.
Kush nuk e këndon, kush nuk e përmend,
Ndër njerëz të mirë nuk ka asnjë vend!

# Amori si piktor peizazhi

Rrija në mëngjes në majë shkëmbi,
Edhe sytë i ngulja nëpër mjegull,
Ajo ndehej si qilim i hirtë
Dhe gjithçka e fshihte poshtë e lart.
Erdhi djali, ndenji si mënjanë,
Tha: "O mik i dashur, si po mundesh,
Kaq i ngeshëm të vështrosh qilimin?
Mos ke humbur vallë përngaherë
Çdo dëshirë për të pikturuar?"

E vështrova dhe mendova fshehtas,
Dashka çuni t'ia kalojë mjeshtrit!
"Në do rrish i zymtë e papunë" –
Foli djali – "gjë s'ke për të nxjerrë!
Shih, do bëj, shpejt, një tablo të bukur,
Të mësosh si kjo ta bësh dhe vetë!"

Dhe pasi drejtoi gishtin e tij,
Që i kuq si trëndafilli ishte
Tek qilimi që shtrihej gjer larg,
Shpejt me gisht ia nisi vizatimit.
Pikturoi një diell të bukur sipër
Që më vetëtinte para syve,
Çdo qemer resh në flori e ngjyu
Dhe mes e përmes na përshkoi rrezet,
Pikturoi pastaj maja të hijshme
Pemësh plot freski, pastaj kodrinat.

Prapa nuk mungoi as ujë i kthjellë,
Mjaft natyrshëm vizatoi një lumë,
Që nën rreze dielli shkrepëtinte
E gjer larg i ndihej zhaurima.

Ah, se ç'lule kishte anës lumit
Dhe ç'ngjyra të gjalla ndër luadhe,
Ngjyrë alle, ari e të blertë,
Të smeraldta e rubin të ndezur!
Plot ndriçim e qartë e lustroi
Qiellin e përtej të kaltrat male.
Kështu me gëzim edhe mahnitje
Herë piktorin shihja, herë tablonë.

"Ja", më foli, "pra ta kam provuar
Zotësinë time mjeshtërore,
Por më e vështira vjen më prapa!"
Vizatoi një vajzë bukuroshe
Shtatselvi, me hijeshi të veshur,
Faqefreskët nën të errtat flokë,
Dhe i kishte faqet po një ngjyre
Porsi gishti që po pikturonte.

"Ore çun! – bërtita – çfarë mjeshtri
Në shkollën e vet të ka mësuar,
Që kaq shpejtas ti e kaq natyrshëm,
Kaq me mend e kaq bukur e bëre?"

Kur kështu po flisja, zu një erë
Që të fryjë e të tundë kodrën,
Ngriti valë e shkumë nëpër lumë

Dhe ia fryu së hijshmes vajzë tisin,
Dhe tani që gjithçka zu lëvizi,
Drurët, lumi, lulet dhe pëlhura,
Edhe këmbë e hijshme e bukuroshes,
A besoni se përsipër shkëmbit
Si një shkëmb i qetë, i fortë mbeta?!

# Ankime mëngjesi

O ti vajzë e hedhur, çamarroke,
Pa më thuaj, ç'faj kam para teje,
Që kaq fort mundime më shkaktove
Dhe s'e mbajte fjalën që më dhe?

Ma shtrëngove ëmbël dorën mbrëmë
E kaq dhembshurisht më pëshpërite:
"Po, do vij, do vij në mëngjes herët,
Miku im, në dhomën tënde vetë!"

Derën me kujdes lehtas e mbylla
Dhe menteshat mirë i provova,
U gëzova, ato s'zhurmëronin!

Ç'natë që kalova në përgjime!
Rrija zgjuar, syrin përmbi orë,
Dhe sa nisa të dremis për pak,
Zemra ime roje rrinte zgjuar,
Më përmendte nga gjumi i lehtë.

Po me gjithë shpirt bekoja terrin,
Që gjithçka kaq qetas kish mbuluar!
Më gëzonte qetësi e madhe
Dhe përgjoja mes heshtjes së thellë,
Oh, sa dhe një tingull nuk dëgjohej!

"Të mendonte çka mendoja unë,
Dhe të ndjente çka përbrenda ndjenja,
S'do të kishte pritur dot mëngjesin,
Do të vinte shpejt në këtë dhomë!"

Ç'brofi vrik një mace mbi mansardë,
Fërfërinë minjtë nëpër qoshe.
S'di se ç'kërcëlliti tek shtëpia,
Dhe shpresoja hapin tënd dëgjoja,
Dhe besoja ecjen tënde ndjeja.

Dhe u dergja gjatë, ah, sa gjatë,
Dhe kur dita nisi të përhiret,
Këtu dhe atje diçka kërciti!
Derë e saj? Apo mos dera ime?
Rrija në përgjim në shtrat i ngritur,
Shihja derën përgjysmë ndriçuar.
Ah, sikur ajo të futet befas!
Palëvizur rrinin dy kanatat,
Qetësisht të varur tek menteshat.

Dhe gjithnjë më dritë po merr dita,
Dhe dëgjoj si fqinji hapi derën,
Tek nxitonte të nisej në punë.
Kërkëllitën qerret e lëvizën,
Porta e qytetit u hap fare.
Mall e rraqe udhëve vërshuan,
Gumëzhiti tregu nga rrëmuja!

Dhe tani nëpër shtëpi, tek shkallët
Ngjitje, zbritje, rrapëllima dyersh,
Zhurmëronin hapat duke ecur,
Dhe nuk mundja dot nga jeta e bukur
E nga shpresa përgjithnjë të ndahem.

Më në fund kur dielli i përvëluar,
Më ndriçoi mure e dritare,
Brofa e vrapova drejt te kopshti,
Frymën e zhuritur, të përmallshme,
Ta trazoja me puhinë e freskët,
Po ti s'erdhe më tek qoshk i kopshtit,
As udhës plot blire më s'u duke!

# Musagetat

Shpesh për netët dimërore
Thirra muzat gjithë me hire,
S'vjen asnjë agim të ndrisë,
Asnjë ditë s'do të zbardhë,
Por më sillni, kur më duhet,
Dritën e së mirës llambë,
Që si Feb e Aurorë
Zellin tim të ma gjallojë.
Po në gjumë ato më lanë,
Gjumë plumb edhe të zymtë,
Dhe me një mëngjes të vonë
Kot më kot rrodhën kaq ditë!

Por tani pranvera erdhi
Dhe bilbilave u thashë:
"O bilbila, më këndoni
Fare herët në dritare,
Zgjomëni nga gjumë i rëndë,
Që kaq net më ka mbërthyer!"
Zëkristaltët këngëtarë
Natën derdhën në dritare
Melodi me ëmbëlsi,
Shpirtin tim ma mbajtën zgjuar,
Zjeu befas brenda gjoksit,
Dhe kështu më iku nata,
Dhe në gjumë më gjet dita!
Më së fundi erdhi vera,

Dhe sapo mëngjesi ndriti,
Ma prishi të ëmblin gjumë
Herët mizë e papërtuar!
Herët mizë e papërtuar
Kthehet rishtas pamëshirë,
Ndonëse gjysmë i zgjuar
E dëboj me padurim,
Pas ndjell motrat e paturpshme
Edhe nga kapak i syve
Ma largojnë gjumin fare.

Plot me vrull kërcej nga shtrati
Dhe kërkoj të mirat muza.
I gjej pyjeve me lisa,
Në mes tyre më pranojnë.
Këto kandra të bezdisshme
Grimca ari më dhurojnë.
Merrni, pra, moj të mërzitshme,
Musageta të vërteta,
Lavdërim nga vjershëtori!

---

*Musageta – prijës dhe shok i muzave, epitet i Apolonit, por dhe i Herakliut, që mori përsipër mbrojtjen e muzave tek po preheshin në Eliklonë dhe prandaj u këndua prej tyre për gjestin e vet heroik.*

# Varri i Anakreontit

Ku çel trëndafili, ku hardhia i ngjitet dafinës?
Ku turtulli josh dhe bulkthi prehet e ngazëllehet,
Ç'varr fshihet këtu që gjithë jetës perënditë
E stolisin me lule? – Varri i Anakreontit!
Poeti i lumtur shijon pranverën, verën, vjeshtën,
Edhe më së fundi ky shpat e mbron atë nga dimri!

# Qëndrim në ndryshim

Sikur ky shpërthim blerimi
Ah, një çast të kish qëndrim!
Por nga erë perëndimi
Bie krejt ky lulëzim!
Ta uroj gjethin e blertë
Që kaq hije më blaton?
Por, ja, fryn një shqotë e rreptë,
Afsh vjeshtak gjithçka përshkon!

Do t'i hash frutat e mira,
Shpejtas merr ç'të ra për fat!
Këto pemë – të arrira,
Këto sapo hodhën shtat!
Pas çdo shiu dhe më shumë
Lug i bukur nis ndërron.
Ah, dhe në gjithë atë lumë
Për së dyti dot s'noton!

Po ti vetë! Aty ku pate
Gur të fortë e shkëmb plot re,
Mure sheh e sheh pallate,
Që me tjetër sy i sheh.
Iku buza prush e nxehtë,
Që kaq puthje ty të dha,
Këmba që mbi shkëmb të mprehtë
Porsi dhi u ngjit, vëlla!

Ajo dorë ledhatare
Mirësi më dha gjithnjë.
Kjo krijesë aq mitare
Tani është tjetër gjë!
Dhe çka shoh në breg e mal
E thërras me emrin tënd,
Këtej ik shpejt si një valë
Dhe nxiton në element!

Zanafillën edhe fundin
Le ta shohim tok në një!
Më shpejt nga çdo send gjëkundi
Ik me vrap, shpejt, përgjithnjë!
Merr nga muzë e papërtuar
Të pavdekshmin ti premtim:
Rrok përmbajtjen në krahruar,
Edhe formën në mendim!

# Udhëtim dimëror në Harc

Si qifti
Që duke u mbështetur në krahët e buta
Rri pezull mbi retë e rënda të mëngjezit
Dhe përgjon prejën,
Kështu qëndron dhe kënga ime!

Se një zot
I ka përcaktuar
Secilit udhën,
Nëpër të cilën i lumturi
Sulet plot gaz
Drejt synimit të vet,
Ndërsa ai,
Që fatkeqësia
Ia ndrydh zemrën,
Më kot përplaset
Përkundrejt mureve
Të fillit të hekurt,
Që gërshëra e hidhur
E pret vetëm një herë!

Në shkurret e tmerrshme
Struken egërsirat
Dhe tok me harabelat e ngordhur
Janë fundosur ndër ujërat e kënetës
Të pasurit!

Është e lehtë të ndjekësh karrocën,
Që e drejton *Fortuna*
Si ecja çapngadalë e shpurës
Nëpër udhët e shtruara,
Pas princit që hyn në qytet!

Por kush është ai, që rri mënjanë?
Nëpër shkurre i humbet shtegu,
Prapa tij mbyllen
Kaçubet së bashku,
Bari ngre sërish kryet,
Dhe shkretëtira atë e përpin!

Ah, kush i shëron dhimbjet
E atij që ballsami i bëhet helm?
E atij që urrejtjen e njerëzve
Gëlltit në mes ngazëllimit të dashurisë?
Në fillim i përbuzur, tani përbuzës
Fshehtazi bren
Vlerën e vetëvetes
Mes egoizmit të pangopur!

Në psaltirin tënd,
O atë i dashurisë ka një melodi
Të kapshme për veshët e atij,
Prandaj ringjallja zemrën!
Nxirri përpara syrit të mjegulluar
Të të djegurit nga etja
Mijëra burime në mes të shkretëtirës!

Ti që krijon gëzime,
Dhe secilit ia blaton në masë të bollshme,
Beko vëllezërit e gjahut,
Që ndjekin egërsirat,

Me gëzim rinor,
Plot etje për kërdira,
Hakmarrës të vonuar të prapësive,
Nga të cilat më kot prej motesh
Me shkopinj mbrohej bujku!

Por të vetmuarin mbështille
Në renë tënde të artë!
Rrethoja me blerime dimërore,
Gjersa të çelin sërish trëndafilat,
Flokët e lagura,
Poetit tënd, dashuri!

Me vravashkën që nxjerr tym
Ndriçoji atij
Përmes vaheve të natës,
Nëpër udhët pa mbarim
Të fushave të shkreta;
Me mëngjeset mijërangjyrëshe
Buzëqeshi në zemër;
Me shtrëngatën therëse
Mbarte nëpër lartësira!

Rrëketë dimërore derdhen nga shkëmbi
Në psalmen e tij,
Dhe altar për falënderimet e dashura

I bëhen majat e frikshme
Të kreshtave të mbuluara nga dëbora,
Të cilat me një vargan fantazmash
I kanë kurorëzuar popujt e lashtë!

Ti[1)] ngrihesh me gjoksin e pazhbirueshëm,
Me fshehtësi e ballëhapët
Mbi botën e çuditur
Dhe vështron prej reve
Mbretëritë dhe madhështinë e saj,
Që me damarët e vëllezërve të tu
Bri teje i ujit!

---

*1) Kupto vargmalet e Harcit, të pasura me minerale e plot miniera.*

# Karrocieri Kronos

Shpejt, pra, o Kronos!
Trokthi kuajt të vërsulen!
Rrëpirave rrëshqet dheu.
Dhe mendja më vjen rrotull,
Sa herë ngurron e s'rend.
Udhë e sheshtë a me gropa,
Trokth mbi rrënjë e mbi gurë,
Jetës futju ti përbrenda!

Dhe tani sërish
Me çapin që gulçon
Ngjitju malit të mundimshëm!
Hë, pra, pa vonim,
Plot synim e shpresë, përpjetë!

E madhërishme e plot gjerësi
Pamja e jetës përreth.
Nga mali në mal
Enden shpirtrat e pavdekshëm,
Të jetës së përjetshme – shëmbëllim!

Ja, anash hija e një strehe
Të thërret,
Vështrimi i freskët i një vajze
Të ndjell nga pragu pranë.
Këndo – "Dhe mua, moj vajzë, më fal

Këtë kupë që shkumëzon,
Këtë shikim që shëron!"

Lëshohu tani tatëpjetë.
Shih, dielli po perëndon!
Po para se të shuhet e mua plakun
Të më mbështjellë mjegull e kënetës
E nofulla pa dhëmbë të dërrdëllisë
E mos më binden më kokallat,
Dehur nga rrezet e fundit,
Merrmë, teksa një det plot zjarr
Më shkumëzon ndër sy,
Në derën natore të skëterrës!

Ti bririt bjeri, karrocier,
Më shpejt kuajt, me trokth,
Që të kuptojë se po vijmë Orku
Edhe tek pragu i portës
Hanxhiu të na presë plot gëzim!

# Kënga e udhëtarit në shtrëngatë

Kë ti s'e braktis, o Genius,
As dhe shiu, as shtrëngata
S'mund t'i kallin tmerr në zemër.
Kë ti s'e braktis, o Genius,
Ballë reve plot me shira,
Ballë breshërit të dendur
Ia merr këngës si lauresha,
Porsi ti mbi re!

Kë ti s'e braktis, o Genius,
E ngre lart udhës plot baltë,
Përmbi flatrat plot me flakë;
Si mes lulesh
Ai çan
Lymërat e Deukalionit,
Vret Pitoni, i lehtë, i madhërishëm,
Apoloni i Pitisë!

Kë ti s'e braktis, o Genius,
Pupla leshi shtron nën vete,
Kur në shkëmb e mbërthen gjumi,
Dhe me krahët si mburojë
E mbulon në pyll mes natës!

Kë ti s'e braktis, o Genius,
Në mes shqotës së dëborës,

E mbështjell me ngrohtësi!
Ngrohtësia i josh Muzat,
Ngrohtësia josh dhe Hiret!

Përmbi mua fluturoni,
Ju, o Muza e ju, o Hire,
Ky është uji e kjo toka,
Biri i ujit dhe i tokës
Ec mbi to
Si vetë zotat!

Të pastër si zemra e ujit,
Të pastër si palca e tokës,
Suleni mbi mua edhe sulem
Përmbi ujë e përmbi tokë
Porsi zotat!

Duhet të kthehem në kasollen
Plot tym e të ngrohtë?
Duhet të kthehem e të pres,
Veç dhuratën tënde, ati Bromius,
Zjarrin që digjet qartë e na ngroh?
Apo të kthehem me guxim?
Dhe unë, që më shoqëruat,
Të gjitha ju, o Muza, dhe ju, o Hire,
Që prita gjithçka ç'ishte juaja,
Juaja, o Muza, dhe, o Hire,
Që kurorëzuar nga lumturia
Lavdi i thurët jetës,
A duhet që t'ia mbath si burracak?

Derdh një rrëkezë përbri,
Që rrjedh në mes të të ngeshmëve,
Që rrjedh në mes të të vdekshmëve të lumtur,
Pakëz mënjanë nga ti,
Nga ti që mua më çik duke më mbrojtur,
O Jupiter Pluvius!

Jo tek pema e vidhit
Ti e vizitove atë,
Që mbante një çift pëllumbash
Në pëllëmbët ledhatare,
Që ia kurorëzonin ballin trëndafila të freskët,
Dhe s'lodrove me të, të lumturin në mes lulesh,
Anakreontin,
O perëndi që zgjon stuhi!

As në pyllin me plepa
Në brigjet e Sibarit,
As në ballin diellndriçuar
Të vargmaleve
Ti s'e preke atë,
Këngëtarin e luleve,
Fjalëmjaltin,
Që të bënte shenja miqësisht,
Të ëmblin Teokrit!

Ati Bromius,
Ti je Gjeniu,
Gjeniu i shekullit!
Je ç'ishte zjarri i brendshëm

Për Pindarin,
Ç'ishte për botën
Feb Apoloni!

Ah, ah, zjarri i brendshëm,
Zjarri i shpirtit,
Qendra e gjithçkaje!
Ndizu përballë
Feb Apolonit,
Ndryshe i ftohtë
Shikimi i tij sovran
Mbi ty do të rrëshqasë,
Dhe me zili do të ndalet
Në forcën mugullonjëse të kedrit,
Që për t'i çelur sythat e blertë
Atë nuk e prek!

Përse kënga ime të fundit të thirr
Ty nga i cili ajo ka mbarimin,
Ty nga i cili ajo rrjedh,
Jupiter Pluvius?
Ti, veç gurgullon nëpër këngën time,
Dhe burimi i Kastalisë,
Kur karrocat iknin e rrapëllinin
E rrota ndiqte rrotën me vertik
Nëpër të caktuarën tragë,
Kur të ndezur nga gazi i ngadhnjimit
Djelmoshat vërshëllenin kamzhikët,
Teksa pluhuri ngrihej duman e binte

Siç bie nga kreshtat e malit
Në luginë breshëri i furishëm,
Të ndizte kanosja e rrezikut, Pindar,
Në shpirt guximin. Të ndizte?
Zemër e gjorë!
Atje në kodrinë
Ç'pushtet i madhërishëm!
Më jep vetëm pakëz zjarr,
Më duhet të kapërcej vahun.
Se atje më pret kasollja ime!

# Ilmenau[1)]

Luginë e hijshme, pyll gjithnjë i blertë,
Ju ngjatjeton kjo zemër e malluar!
Shtromëni degë e bisqe papushuar,
Si mik më prisni në hijen e qetë!
Nga kreshtat derdhmëni, në ditë gazi e malli,
Ballsam në gjoksin tim e erë mali!

Sa shpesh t'u ktheva me një fat krejt tjetër,
Te këmbët mal, o miku im i vjetër!
Oh, lemë që të shoh në lartësinë
Eden të ri, ç'më dehin bukuritë!
E meritoj si ti çdo gjë të mirë,
I qetë ti, i qetë unë, i lirë!
Dhe bëmë të harroj sesi kjo botë
Edhe këtu, ndër hallka na mban fortë.
Si bujku farën hedh në dhe të shkrifët për të mbirë,
Dhe lakra mbjell në shpat e në rrëpirë,
Si honeve nxjerr bukën minatori,
Dhe qymyrxhiu rrojtjen shtyn me zori,.
Ma ktheni ju rininë si kaq herë,
Të nis jetë të re edhe një herë!

---

*1) Ilmenau – Kjo poezi, shkruar me rastin e ditëlindjes së dukës Karl Augustit, përmban në vetvete një sërë aluzionesh për rrethana që njiheshin vetën në rrethin e ngushtë të Gëtes dhe të dukës. Në fillim i këndon Ilmenaut si një vend i gostive në vitet e para të jetës në Vajmar, pastaj si një vend i punës së madhe që bëhet në minierat, për rimëkëmbjen e të cilave ishte përpjekur shumë në atë kohë. Kështu Ilmenau bëhet simbol i kalimit të tij nga vrulli i periudhës "Stuhi dhe vrull" te puna dhe te krijimi.*

Ç'hove fisnike, ç'gaz e ëndërrime
Më zgjojnë rimat plot me tingëllime,
Dhe vetëm, larg nga turma zhurmëtare,
Bëj banjo mes aromash freskimtare!

Me ç'melodi fërrmon i larti bredh,
Me ç'melodi ujvara rrjedh mbi ledh,
Zbret reja, mjegulla e mbyll luginën,
Sa s'dallon muzgun dot nga errësirën!
Në pyll të zymtë, nën yjet e ndritur,
Ku ndodhet shtegu që humba papritur?!
Ç'zëra të rrallë po dëgjoj që larg.
Ç'kumbojnë ndryshe tek shkëmbi i lartë!
Të shoh ç'po ndodh, nxitoj e rend pareshtur,
Si pas thirrjes së drerit gjahtari ec i heshtur!

Ku jam? Mos jam në vendin e magjive?
Ç'gosti nate plot gaz tek muri i shkëmbinjve!
Përbri kolibes plot degë e fletë
Vështroj si flaka ndrin e merr përpjetë.
Mes bredhave vjen gjer këtu shkëlqimi;
Në vatrat varfanjake zjen ushqimi,
Ata gajasen dhe sapllaket zbrazen,
Sërishmi kthehen plot radhë pas radhe!

Me ç'mund ta krahasoj dot këtë zhgan?
Nga erdhi e nga ikën si tufan?
Pse plot dallim e trille ka gjithçka?
T'i përshëndes apo t'ia mbath nga ta?
Mos shpirtrat e gjahtarëve të vdekur?
Mos xhuxhmaxhuxhat që ndjellin magji?
Nëpër shkorrete ç'zjarre rrijnë ndezur,

Kam ngjethje, por këtu guxoj të rri.
Fushim ciganësh që i bien defit
A princ i arratisur në pyllin e Ardenit?
A duhet të humbas ndër gërxhe e tërthore
E shpirtrat shekspirianë t'i gjej të mishëruar?
Ke ky mendim më prijnë udhës së drejtë.
Ata apo një fis me ta i njëjtë
Tek ta dëfren e ç'sjellje kaq nazike,
Mes vrazhdësisë ç'zakone fisnike!
Kush është ai atje kaq shpatullgjerë,
Që supet i lakon, pa mburrje, herë herë,
Dhe ulet anës zjarrit i harruar,
Një gjak nga fis heronjsh të lashtë, të dëgjuar.
Plot ëndje ai thith llullën e gjatë,
Dhe ngjitet tymi përmbi ballë, lartë!
Me ç'maturi t'u ndezë di gëzimin
Përreth, ku befas nis shpërthimin.
Kur me pamje serioze flet, se ç'det
Dialektesh, gjuhësh rrjedh nga goja vet!

Kush është ai tjetri përmbi shkarpa,
Që në një trung mbështetur rri mënjanë,
Gjymtyrët majft të hijshme e të gjata
Me ngathtësi i nder nëpër çdo anë
E pa u ndier nga tjerët, sulet prore.
Mbi flatra shpirti ngjitet gjer tek retë
E nga një valle sferash qiellore
Nis ia merr këngës mallshëm, prush i nxehtë!
Megjithatë këtu mungon diçka,
Dëgjoj sesi nën zë flasin ata,
Mos shqetësojnë djalin. Ç'heshtje ra!
Ku mbyllet lugu, atje poshtë tek fundi,

Në një kasolle ngritur lehtë,
Nën flakën e një zjarri që ndrin gjithnjë më zbehtë,
Nën zhurmën e ujvarës dremit porsi pëllumbi.

Zemra më shtyn të endem mbi gremina,
Të bredh mbi to me gaz, nga tjerët larg ca grima.
Të përshëndes ty që gjer natën vonë
Me shqetësim në prak përgjon gjithmonë.
Pse rri larg çdo gëzimi e dëfrimi?
Më ngjan gjëra të thella po mendon.
Pse humbe në mendime kaq të thella
Dhe zjarrin s'e trazon që s'bën më dredha?!

"O mos më pyet se nuk mundem dot
Të huajit t'ia shuaj çdo kureshtje.
Të lutem, dhe pse shpirtin e kam plot:
Kjo kohë veç për vuajtje dhe heshtje!
Ku jam e ç'gjë më josh për këtej mua,
Një fjalë goja s'thotë, ah, se ç'plasa,
Këtu nga ç'dhera të tjera u përplasa,
Këtu ku miqësia u farkëtua.

Kush veten njeh? Kush ç'do të bëjë e di?
I druhet trimi udhës baltë e shira?
Veç dita tjetër thotë ç'bëre ti,
A të këqija, a të mira!

S'e zbriti përmbi tokë të ngrirë e kallkan
Nga qielli zjarrin Prometeu vetë?
Dhe ç'gjë më rrjedh ndër rremba kaq vrulltas e revan,
Veç gjakut tokësor plot jetë?
Zjarr tjetër për altar sjell me vërtik.
Ç'ka digjej nuk kish flakë të dëlirë.

Duhia duhmën rrit e çdo rrezik,
S'lëkundem as në cikmë e errësirë.
Guximit dhe lirisë u thur këngë,
Dhe nderit dhe lirisë pa pengore,
Besimit, gazit që dërrmon çdo brengë,
Ngadhnjimeve të zemrës njerëzore.

Por ah, një zot s'ma fali këtë art,
Të shtirjes e të marrjes me të lutur.
Dhe jam këtu, njëherësh në baltë e kokëlartë,
Pafaj dhe i ndëshkuar, fajtor e fort i lumtur.
Më fol pse nën këtë çati çdo ditë
Pushon çdo gjë e mirë dhe e ligë:
Një zemër kaq besnike që në udhë
E shoqëron një fat i vrazhdë,
Që plot me parandjenja, qesh, merr rrudhë,
Lufton keqas me veten, me hijet e çdo nate.
Me mund e djersë rreket të fitojë,
As dhe një fjalë s'mundet dot shpirtin t'ia mbështjellë,
Dhe asnjë këngë dallgët t'ia fashitë.

Për fshikëzën kush mund të bëjë fjalë,
Kur vemja zvarrë ec mbi degë?
Dhe krizalidës në dhe e në moçal
Ç'i ndih ta grisë cipëzën më lehtë?
Por koha vjen, çlirohet, cipa plas,
Drejt trëndafilit flatrat rreh flutura me gaz.
Kuptohet, motet na i falin,
Për forcat një drejtim të drejtë,
Dhe pse tek e vërteta drejton çapin,
Gënjeshtra shpesh të ndjell, të fut në rrjetë.

Kureshtja të tërheq pas vetes,
S'të tremb i mprehti shkëmb, i ngushti shteg.
E keqja të përgjon bri jetës
E ç'barra të ngarkon mbi zverk!
Dhe vrull i shpirtit kaq fort të trazuar
Të shtyn tani këtu, tani atje.
Në çdo lëvizje, i shqetësuar,
Në çdo pushim, prehje nuk njeh.
Plot zi në ditën e kulluar,
Pa pranga, po pa gaz,
Dhe fle me shpirt e trup të shkallmuar,
Nën shtrojet që bën vetë çdo ças.
Ndërsa këtu i heshtur e pa pengime
Sytë vërtis në yjet plot liri,
Dhe pezull nëpër zgjim e ëndërrime
Nga dallgë vegimesh mbrohem mezi!

M'u tretni ëndrra! Ju falem, ju, o Muza,
Që sot në këtë shteg më jeni dukur,
Vetëm një fjalë lehtas thotë buza
Dhe vendi ndrin si dita më e bukur!
Po ikin retë, mjegulla po tretet,
Ia mbathën hijet. Zotër, që nga më erdh ky fat?!
Mua më qeshi dielli i vërtetë,
Një botë e bukur krahët zgjat,
Vegimet – angushti në ajër treten shpejt,
Një jetë e re prej kohësh po merr jetë.

Dhe shoh tek kthehem te shtëpia e heshtur
Një popull që me zell edhe pareshtur
Merr nga natyra ç'fal me bujari.
Vërtitet filli në suvajkë

Drejt në pëlhurë me vërtik,
Dhe kova e litari që mblidhet në çikrik
Anës së pusit nuk rrinë pa punë gjatë,
Mashtrimi u zbulua, zot rregulli i plotë,
Ja mbrothësia dhe fati mbi tokë!

Një shëmbëllim të ditëve plot dritë
E bëre, princ, ti këtë vend.
Detyrat njohe nga dita në ditë
Dhe fre i vure shpirtit tënd.
Njeriu mund të përmbushë mjaft dëshira,
Nëse për veten sheh edhe mendon,
Veç kush të tjerët prin nga çel e mira
Veteveten nga këto e mënjanon.

Shpërblimi s'do mungojë, ec kështu,
Mos u lëkund porsi ky bujk këtu,
Që farën ndodh që kuturu e hedh
Herë mbi gjemb, mbi udhë a mbi ledh.
Shpërnda me mençuri me dorën plot guxim
Mbi dhe të mira e bekim,
Pastaj pusho! Ky dhe do të prodhojë,
Ty edhe ne do të na lumturojë.

# Trilogjia e pasionit

## *2. Elegji*

Ç'duhet të pres nga ora e takimit
E kësaj dite, trëndafil që s'çeli?
Parajsën, ferrin, dhimbjen e zhgënjimit
A këtë gjëmë që më bren së thelli?
Asnjë dyshim! Tek derë e qiellit vetë
Ajo zgjat krahët të të ngrejë përpjetë.

Kështu u fute në parajsë brenda
E denjë rrojtjesh ditësh më të mira,
Nuk ka dëshira, nuk ka shpresë e brenga
Në këtë cak synimesh të dëlira.
Në pamjen e krejt kësaj bukurie
Shterr gurrë e lotit si prej një çudie.

Dita këtu s'ka flatra fluturake,
Grimë e minutës ngathtazi zvarriset,
Puthja e mbrëmjes si një re rudake
Mbetet dhe kur në qiell rish dielli ngjitet.
Orët porsi të hijshme udhëtare,
Edhe pse motra, nuk ngjasojnë fare.

E fundit puthje ç'mjaltë e ç'llum farmaku,
Shprish lakun që dashnorët kishte kapur.
Këmba nxiton, ndalon e ik nga pragu
Si ndjekur *kerubini* të përflakur.

Vështrimin ngul në udhën që po erret,
Nga prapa shoh, u mbyll porta, më s'çelet.

Dhe mbyllet në vetvete sikur kurrë
S'ish hapur e s'kish ndier fllade gëzimi,
Kjo zemër djegur edhe bërë zhurë,
Që hahej me çdo yll për nga shkëlqimi.
Pendim, qortim e re zëndan mërzie
Mbi të rëndojnë si afsh zagushie.

Nga bota s'mbetet gjë! Mure shkëmbore
S'rrethohen më prej hijeve të shenjta!
S'piqen të lashtat! Rrip i blertë toke
S'rend bri lumenjsh, në pyll a tek këneta!
Dhe si lakohet krejt ky qiell gjithmonë,
Herë plot forma, hera pa një formë!

Sa lehtë e hijshme, dritë e ajër endur,
Vozit mes reve porsi *serafinat,*
Nëpër eter të kaltër e të dendur
Një pamje përmbi lugjet e lëndinat!
Kështu ti pe në vallen e gëzuar
Të bukurën mes kaq yjesh rrethuar.

Të mund ta zotëroja për një grimë
Ajroren pamje me kaq drita e ngjyra,
Në zemër atje rri e ngre selinë,
Duke ndërruar trajta e fytyra.
Gjithnjë po një mes formash kaq me hirë,
Gjithnjë e më e dashur, më e mirë!
Të më takojë, rri më pret tek dera,
Na prin nëpër kaq shkallë që s'mbarojnë,

Sa behin puthjet flakë e zjarr si vera,
Puthje të tjera gojën ma mbulojnë.
Plot jetë e hir të mbeti pamja mike,
Me gjurma flakësh në zemrën besnike.

Kjo zemër, mur i lartë me bedena,
Ta mbroj atë, rri e përgjon e qetë,
Veç nga ajo gëzon, mban fllade brenda,
Veç nga ajo zbulon se ç'ka të fshehtë.
E lirë ndihet nëpër leqe malli
E për gjithçka plot gaz rrahjet t'i fali.

Nevojë e dashurisë brenda meje,
Sikur më ish platitur, më ish fikur.
Po ç'shpresa, ç'ëndrra, ç'shkrepje prej rrufeje.
Ç'mendime, ç'sulme marrin hov papritur!
Në tek ndonjë Amori ndezi zjarre,
Tek unë erdh si flladet ledhatare.

Ajo – gjithçka! Se ç'vorbull shqetësimesh
Në shpirt edhe në trup, ç'lëngim e ç'barrë!
Vështrimin e rrethojnë re vegimesh,
Në hon të zemrës që pshon si e vrarë.
Po shpresa agullon edhe shkrep prore,
Ajo më josh në mes dritës diellore.

Paqen e zotërve më të bekuar
Sesa arsyeja, si flet kjo letër,
E krahasoj me paqën e kulluar,
Kur jam me çka dua mbi gjithçka tjetër.
Më prehet zerma, s'mund ta turbullojë
Asnjë rrebesh që ndjenja ta pushtojë.

Në gjoksin tonë kryet ngre synimi
Për të panjohurën kaq të dëlirë.
Me dashje flakim nxitje ngazëllimi,
Që të zbulojmë ç'na fsheh kjo rrafshirë.
Thërrasim: "Qofsh i lumtur!" Lumturinë
E ndiej kur pranë kam vashën gjeraqinë.

Në sytë e saj një diell plot rreze drite,
Tek frymë e saj – dihatja e pranverës,
Kaq blloqe akujsh shkëmb, kallkan ndër vite,
Ndër zgavra shpirti shkrihen menjëherësh.
Kapriçot, egoizmat që keq ngjiten,
Përpara saj si mjegull davariten.

Ngjan se më thotë: "Orë e pas ore
Gjithnjë më e gëzuar bëhet jeta.
E shkuara lë pas një fjollë bore,
Të ardhmes nuk i dihet ç'ka të fshehta.
Por mbrëmja kur na ngrysej kishe frikë.
Ja dielli iku, gazi s'na u fik.

Vepro si unë, shih plot gaz e shije
Çdo çast në sy, pa një ngurrim e smbrapsje!
Çdo punë e çdo orë dashurie
Ti prite pa dyshim e zemërplasje!
Vetëm po qe gjithnjë porsi fëmija,
S'do të të zbehet kurrë madhështia!"

Ti mirë fole, shoqe, pranë meje
Ty të të kem, favor si ky kush pati.
Dhe cilido, që t'u ndodh përkrah teje
Një çast, ndjeu se i zgjedhur ish nga fati.

Në më largon nga ti, më tremb çdo erë.
Ç'mund të më ndih' kjo çmenduri aherë?!

Tani jam larg. Në çastet e tanishme
Ç'ka mund të pres? Nuk mund të them një fjalë.
Të mirën mbart në udhën e mundimshme,
Që bukuria mua ma ka falë.
Më sjell përqark dëshira kot së koti,
S'më mbetet tjetër veç kjo çurkë loti.

Pra rridhni me rrëmbim porsi rrëketë,
Zjarrin që djeg nuk mund ta dobësojnë.
Më çfryn e mënt më çahet gjoks i shkretë,
Ku vdekja e jeta egërsisht luftojnë.
Ka bar që kurmit i pushon çdo dhimbje,
Po shpirti nuk përfill vullnet, vendime.

Më bren mendimi: ç'gaz ka pa të jeta?
Dhe pamjen zë ia shfaq me qindra herë.
Tani ngurron, tani ik si shigjeta,
Tani e turbullt, tani dritë e erë.
Po ç'ngushullim mund të më sjellë mua
Kjo vajtje-ardhje që s'resht si përrua?!

Më lini, miq besnikë, vetëm fare,
Në këtë shkëmb e myshk, këtë moçal!
Ikni më tej, për ju bota bujare,
Dheu i pafund e qielli i madh, kristal!
Po brofni të kërkoni nëpër jetë
Natyrës t'i zbuloni çdo të fshehtë!

Dhe mua gjithësia (si në erë
Unë, që plot me gaz më qeshi fati,)

Më vu në provë dhe më dha shpirtgjerë,
Dhe shqotë, por edhe fllade që kush s'pati.
Më puthi fort me buzët plot çudira,
Pastaj më shtyu në hon e ndër rrëpira.

## *3. Pajtimi*

Pasionet sjellin brenga. Ç'mundet vallë
Ta prehë zemrën që kaq shumë humbi?
Ku janë orët që shkanë si valë,
Më kot erdh dashuria si pëllumbi?
I zymtë shpirti, plumb e helm fillimi,
Për ndjenjat botës iu zbeh krejt ngjyrimi.

Por befas erdh mbi flatrat engjëllore
Këtu ç'muzikë e me ç'melodira.
Futet gjer thellë qenies njerëzore
E mbush me bukuri e harmonira!
U njomën sytë në hovin e lartë,
Hyjnorë tingujt si lotët e qartë.

Dhe zemra që u ndrit fort nga gëzimi,
Që ende rron e rreh në kraharuar,
Do të flijohej pa fije ngurrimi,
T'i kthehej ky blatim kaq i kulluar.
Dhe ajo ndjen - (të mbetej, ah, çdo moti!) –
Këtë gëzim dyfish, tingujsh e loti!

# Në mesnatë

Në mesnatë vija në strehën time
Përmes varrezës me frikë në gji.
Shkëlqenin yjet gjithë vezullime
Në qiell të kaltër gjer në largësi,
  Në mesnatë!

Pastaj më vonë kur tek mikja e shtrenjtë
Nxitoja zemërndezur e me mall,
Me një ndriçim Veriu yjet kaq netë
Luftonin përmbi mua pa u ndalë,
  Në mesnatë!

Dhe më pastaj, kur futej hënë e plotë
Nëpër dritare krejt shkëlqim e ar,
Mendimi sulej, s'ndalej nga asnjë shqotë,
Në atë që shkoj, në atë që vjen tinëzar,
  Në mesnatë!

# Shpirti i gjithësisë

Shpërndahuni ju shpejtas anembanë
Tani nga kjo gosti,
Duke përshkuar këtë qark kaq pranë
Vërsuluni në gjithësi!

Përkundni lart, përtej ndër lartësira
Ju ëndrrat si elmaz,
Si yjet ndritni nëpër hapësira
Përplot me drita e gaz!

Pastaj vërtituni porsi kometë
Ndër qiejet e pafund,
Ku labirint plot yje e planetë
Shtron udhë për ju gjithkund!

Dhe rrokni dheun që ende s'ka formë
Plot forca e rini,
Se jetë të re merrni gjithmonë
Në vrull e maturi!

Dhe mirrni gjithandej udhës ajrore
Kaq lule me ngjyrim,
Dhe lini thellë zgavravet shkëmbore
Ju trajtën pa ndërrim!

Gjithçka me një guxim të madh, të marrë.
Rropatet të jetojë.
Çdo grimcë pluhur rreh jetë të marrë,
Rreh uji të blerojë!

Kështu shtyni me luftë të pareshtur
Tej terrin akullor,
Dhe rrezëllin me një ndriçim të heshtur
Krejt rrafshi parajsor!...

Ju shpon të shiheni fort një dëshirë,
Me mall e dashuri,
Dhe mirrni jetë nëpër hapësirë
Plot hir, që rrjedh në gjithësi!

# Kënaqësi e vërtetë

Më kot kërkon sundim mbi zemër,
Me qese ari e argjendi!
Princ, që të jepet ty një femër,
Duhet ta duash përnjëmend!
Paraja blen gjuhë zuzari,
Por asnjë zemër s'e blen dot.
Ti do virtyt, s'të vlen gjë ari,
Shko fale zemrën, mos prit kot!

Ç'është ky gaz, që në nevojë
Një vajzë e mjerë fal shpirtfarmak?
Për vaj je ti, ndjen helm në gojë,
Vepron kaq keq si torollak!
Ajo të puth me vrull të shtirë,
Dhe ndrin, kur ar vështron me sy.
Ky s'është mall që s'njeh të vdirë,
Por as dhe epsh nuk është ky!

Je pa virtyt, por si i pirë
Mos e njollos emrin njeri!
Se epshe ndjen çdo egërsirë,
Njeriu i jep fisnikëri!
Mos ki bezdi ti nga këshilla,
Që s'të pengojnë, princ, aspak,
Mëso nga to se ç'është e mira,
Që bota të të çmojë pak!

Dhe mos u lidh nga hallkë e shenjtë,
As mos hazdis fare pa cak,
I lirë rro në këtë jetë,
Po jo pa mend e harrakat.
Dhe për ndonjërën dashuria,
Le të të ndezë në çdo hap,
Le të të lidhë brishtësia,
Teksa detyra s'të bën zap.

Mos ki ngurrim dhe zgjidh një mike,
Që mall të ndjejë dhe ajo,
Me trup të bukur e fisnike,
Edhe i lumtur qofsh kudo!
Këtë e di, aq sa kam mundur,
Një vazjë të dashur mbaj në krah,
Por që të ndihet çifti i lumtur,
Bekim prej prifit ende s'ka!

Për gazin tim mendon parreshtur,
Për mua çel e skuqet prush,
Gëzim ndaj meje ndjen e heshtur,
E urtë, siç e sheh gjithkush!
Pasionin s'na e shuan koha,
As ligji frymën nuk ia merr,
S'e ngrin murrlani, s'e ndyn lloha,
Dhe për këtë ia di për nder!

Dhe kam kaq vrull e përmallime,
Kur ajo ëmbël nis më qesh,
Kur më rri pranë tavoline

E këmbën lehtazi ma ngjesh;
Kur më zgjat mollën e kafshuar
A kupën që s'e piu krejt,
Dhe ma zbulon gjinë e mbuluar,
Teksa e puth si me zor shpejt;

Kur nëpër orë miqësie
Për dashuri flet me gazmend,
Fjalët plot musht pavdekësie
Kërkoj, puthja s'më vjen ndër mend.
Dhe nga ky shkak mikja gëzohet,
Me hir të ri nis më mbështjell,
Ka mall e ndizet, përvëlohet
Si yll plot gaz shpirti i çel.

Tek këmbë e saj më hedh respekti,
Dhe malli drejt gjoksit rinor.
Vështro, djalosh princ, mendjeshkreti,
Këtë kërko dhe mos ki zor!
Bri saj të më rrëmbejë vdekja,
Një këngë e lashtë flet kështu,
Bri saj çdo gaz që na ka jeta,
Kupto këtë, mos rri kërcu!

# Shpjegim për një gravurë të vjetër në dru, që sqaron misionin poetik të Hans Saksit

Të dielën në punishte rri
Që herët mjeshtri shpirtflori,
E heq përparësen e ndytë,
Jelekun vesh, i ndrisin sytë,
Lë pe, çekiç edhe fyndyll,
Brenda një arkëze i mbyll,
Edhe pushon ditën e shtatë,
Pas kaq andrallash ditë e natë!

Sa dielli pranveror i ndrit,
Pushimi rish për punë e nxit,
Një botë e tërë plot me jetë
Në tru të tij nis e hap fletë,
Nis të vërtitet, të gjallojë,
Ndër vargje rreh që të kumbojë!

Ka sy të zgjuar, të dëlirë,
Dhe ka një mall e një dëshirë,
Kudo të shohë qartësi,
Gjithçka ta mbrujë përsëri!
Nga gjuhë e tij pa u ndalë
Plot hir e lehtë rrjedh çdo fjalë.
Kjo muzat shumë i gëzon,
Ndaj mjeshtër këngëtar i thonë!

Dhe brenda hyn një vajzë e re,
Me gjoks të fryrë e sypërdhe,
Në këmbë rri me madhështi,
Fisnike ec përpara tij.
Ajo s'bën poza gjithë mburrje,
Vështrimin s'rrotullon me ngutje!
Një metër dorës si fildish,
Dhe rripi i saj prej ari ish.
Mbi krye një kurorë nga kallinjtë,
Shkëlqimnë e ditës syt e saj plot dritë!
Emrin e kishte Ndershmëri,
Fisnikëri e Drejtësi!

Zë përshëndet e futet brenda,
Atij s'i dridhej fare zemra.
Siç ish plot hir, mjaft vjet më parë,
I dukej sikur e kish parë!

Ajo i flet: "Veç ty të zgjodha
Nga mjaft krijesa që ka bota,
Prandaj ti ki mendim të qartë,
Mos çap me ndrojtje e i ngathtë.
Kur tjerët sulen në rrëmujë,
Shih ç'fsheh kjo bujë e rrokopujë;
Kur tjerët qahen me ankesë,
Misionin mbarte pa rëndesë!
Lart mbaje nderin dhe të drejtën,
I thjeshtë qofsh ti gjithë jetën!
Virtytin çmoje, ngrije lart,
Të ligës shfryji në surrat,
Asgjë mos e zbut e mos e përqesh,
Mos zbukuro, as bëj përshesh!

Botën ta shohësh, or vëlla,
Albreht Dyreri si e pa!
Jetën e saj dhe burrërinë,
Forcat pafund, qëndrueshmërinë,
Natyra të të marrë prej dore
Nëpër çdo udhë e bregore,
Të të tregojë ty gjithçka,
Endjen e njerëzve, pa pra,
Rrëmujën, shtysat e përpjekjet,
Përplasjet, vrullet edhe ndjekjet,
Si shkenca rritet e forcohet,
Si turma turmës i lëshohet.
Këto t'i shprehi krejt açik,
Siç shihen në një xham magjik,
Shkruaj për njerëzit në tokë,
T'u lehtësosh dhimbje e lotë!"
Ajo i hapi një dritare,
I tregon turmën laramane,
Nën këtë qiell gjithëfarësoj gjëra,
Që nëpër shkrime ia lexoni të tëra!
Edhe rri kaq i gëzuar,
Para natyrës mrekulluar,
Shikoi ai në anën tjetër
Si po i vjen një zonjë e vjetër!
Ajo na qenka Historia,
Fabula dhe Mitologjia.
Tërhiqte çapakalamendur
Pas një tabelë prej druri gdhendur.
Atje ju shihni me mëngore
Të madhin Zot që ju mëson prore,
Evë e Adam, parajsën, gjarprin e nëmur,
Sodomën e Gomorrën të shembur,

Dymbëdhjetë gratë e ndritshme plot gaz në fytyrë,
Që shihen në të nderit pasqyrë,
Pastaj çdo lloj xhelati, vrasje e kobi,
Dymbëdhjetë tiranët e turpëruar e si korbi,
Shën Pjetrin me kamxhik e buzënxirë,
Nga bota mjaft e pezmatuar,
Që Zoti rëndë e ka dënuar!
Ish pikturuar kaq e gjallë
Çdo pjesë e veshjes, çdo kind e çdo palë,
Virtyti edhe vesi i pështirë!

E sheh ky mjeshtër gjithçka mirë,
Nga kjo gëzohet, mrekullohet,
Se punë e tij prej saj ndihmohet!
Ai përpara sysh na nxjerrr
Një shembull a mësim me vlerë
Dhe na tregon me saktësi,
Si t'i kish parë vetë ai.
Dhe shpirti i shtegton mjaft larg,
Asnjë shikim nuk hedh përqark,
Dhe nuk dëgjon sesi pas shpine
Ndihen daulle edhe zile!

Dhe ndjen sesi vjen një tutkun,
Kërcen si cjap e si majmun,
Edhe për të, gjithë shaka
Një intermexo gati ka.
Tërheq pas vetes në litar,
Të madh, të vogël, çdo trutharë,
Trashan, hajthak, lastar, shtrembak,
Dhe hokatar, dhe torollak!
Me një kërbaç prej bisht mëzati

Na i bën zap përmes inati.
U përtall trajta edhe forma,
Në banjë i shtyn, u shkund krimba e morra,
Dhe u ngarkon mbi zverk ngarkesë,
Që na e mbajnë pa ankesë!

Dhe si vështron afër e larg,
E përcjell kryet rreth e qark,
Po ku t'i gjejë dot kaq fjalë,
Si mund t'i mbajë këto valë,
Si mund t'u bëjë ballë, thuaj,
Si t'i këndojë, si t'i përshkruajë?
Dhe nga një cep reje shtegtare
Zbret dhe i hyn nëpër dritare
Një muzë, ngjan kaq fort e shenjtë
Si pamja e grave tona vetë!

Dhe e qarkon me qartësi,
Dhe e vërteta merr fuqi,
I flet: "Afrohu, me gëzim,
Ty ta blatoj bekimin tim!
I shenjti zjarr që tek ti fle,
Do bëj të ndizet përgjithnjë!
Jeta që zjen në dej të tu,
S'do të përderdhet kuturu!
Për shpirtin tënd të lartë kam
Ushqim të zgjedhur e ballsam,
Që të të çelë, përngaherë
Si gonxhe plot me vesë e erë!"

Dhe i tregon prapa shtëpisë,
Fshehtas mes derës së avllisë,

Në kopshtin rreth e qark me gardh,
Një vajzë që e pret me mall,
Anës përroit, nëpër shtog,
Me krye edhe sy përtokë!
Qëndron ku hije hedh një mollë,
Për rreth s'ndjen ç'bëhet kjo meshollë.
Plot trëndafila ka në tufë
Dhe një kurorë thur me ngut.
Me këto gonxhe, këto fletë,
Për kë kurorën do ta ketë?
Kështu në pritje po qëndron,
Nga shpresa gjoksi i gufon.
Ka kaq ngurrime e hamendje,
Dhe s'di çka do e për çka endje,
Dhe nga kaq trille që fund s'kanë
Nga buzët nxjerr lehtas ofshamë!
Përse e dashur, t'u vrenjt balli?
Kush të shtrëngon kaq fort nga malli?
Ka plot gëzim e lumturi,
Një fat të lum të bën gati!
Nga shumë fate nëpër botë
Vështrimi yt mbettë gazplotë!
Përmes kaq puthjesh zjarr e flakë
Ai do të rilindet prapë!

Sa kurmin ta pushton në dehje,
Pas mjaft mundimeve gjen prehje!
Sa bie në krahët e shtrenjtë,
Fuqi pa fund thëthin e jetë!
I kthehet rish rini e zjarrtë,
Humor i mprehtë e shakatë.
Me qesëndisje e ngacmime

Ti i fal brerje dhe gëzime!
Mos njohtë plakje dashuria,
As bardi ç'është akullsia!

Tek dehej fort nga lumturia,
Mes resh shkëlqeu nga bukuria
Kurorë lisi, gjetheblertë,
Mbi kokë e ardhmja ia ve vetë!
Do të përhumbë në batak
Kush s'e përfill mjeshtrin pak!

# Vdekja e Midingut

Ç'rrëmujë ke, Thali moj, në shtëpi?
Pse hyn dhe del me nxit kaq mizëri?
Ndër dhoga rreh sqepar edhe tokmak,
As dhe të dielën s'ka pushim ndopak!
Pse mendjen kaq e vret ky zdrukthëtar,
Të shpikë e veç në punë gjen karar?
Shoh Hauenshildin që mendon e s'qesh,
Pagan a turk njeriu që po vesh?!
Plot gaz Shumani, sikur merr para,
Po pikturon me krejt ngjyrat që ka,
Ndjek çapin e Tilenit, kurreshtar,
Më gaz po ka kur qep e pret astar,
Elkan çifuti me diçka shpejt rend,
Kjo gjullurdi për festë lajmon, s'do mend!

Por nga këto që unë ju kam treguar,
S'përmenda atë që kurrë s'ka munguar,
Atë që plot me dhimbje mu në gji
Listelat lidhi shpejt me shkathtësi.
Sot skela, ku s'ec më ky truplastar,
Lëkundet si skeleti mbi litar.
Ku është ai? E deshi artin fort,
Koliti, kolla nuk e ndalën dot!
"Po dergjet i sëmurë, krejt u zbeh!"
Ah, miq, sa keq! Rrezikun ndjej për të!
Sëmundja e gozhdoi a brengë e mekur?!
Sëmurë s'është, jo, or miq! Ka vdekur!

"Midingu vdiq?" jehon gjer në pullaz,
Shtëpia bosh e kthen jehonën pas,
Ndërpritet puna, s'bindet më ky krah,
Tutkalli ngrin dhe ngjyra s'rrjedh, u tha,
Sikush i mpirë rri në vend të tij,
Veç të mërkurën puna nis mezi!

Midingu vdiq, e shtini ju në dhe,
Jo, mospërfillës, i rëndomtë s'qe!
Hapni qivurin, mblidhuni këtu,
Qani çdo burrë që jetoi kështu,
Dhe lini, tek po heshtni përmbi varr,
Të shfrejë dhimbja që dërrmon, kall zjarr!

Vajmar, të ra një i veçantë fat,
Je si Betlemi, i vogël, i madh!
Evropa në mes çmendjes të përmend,
Për shkak të mendjes e humorit tënd!
Njeriu i urtë sheh e nuk mban anë,
Për dy ekstremet që janë kaq pranë!
Ti që ia ndjeve jetës fort çdo gaz,
Hap gjoksin për trazimin plot tallaz!

O muzë, thirr si me gjëmime resh
Emrin e atij që na mëson tek hesht!
Edhe si mjaft të tjerë që i mban
Larg territ të përjetshëm e kallkan,
Edhe Midingut emrin mos ia humb,
Në horizont të ngrihet si pëllumb!

Ja thuaj botës që me zell gjithnjë,
I shërben fatit, dhe beson mbi të,

Sundon si Zot dhe kohën më kot
Rropatet ta ndalojë e se ndal dot!

Ku çdo njeri veçse për vete heq,
Tek fqinji mendja rrallë i shkon, për dreq,
Por viseve të largta i merr vrap
Dhe me të huajt ndan gaz e farmak!
Shpalle këtë me zë-kaba kudo:
Ku ra dikush, tjetri dhembjen të shohë!

Afrohu, burrë shteti! Ky njeri
Të rëndë e kish punën sa dhe ti!
Më fort punoi për qejf se për para,
Dhe skelës lehtazi me këmbë i ra!
Mu në ndërtesën që nga jashtë mahnit,
Një magjistar u rras në qoshk e s'ik!
Ai që pa ngurrim kaq ditë bori,
Që fort e desh autori e aktori,
Dhe më në fund, kur çast i provës qe,
Suksesi i pjesës varej në një pe!

Dhe sapo brenda hyri parësia,
Shenja u dha, filloi simfonia.
Ai veç ngjitej, kish listela, shkop,
Litarin ndukte, gozhdë ngulte një hop,
I qeshte fati dhe në hon rreziku,
Dhe në gabonte, nuk zverdhej, lum miku!

Kush mund ta çmojë dorën e atij,
Kur mbledh litarët me aq mençuri,
Kur në listela ngul karton e shfryn,
Dhe në cilindër lidh, tek karron shtyn,

Mëndafshe, teneqe, letra e xham,
Dhe duke qeshur del e rri mënjanë!
Kështu kaq fort i lidhur pas zanatit
Ishte ai që heroin e barinë e fshatit
Krijoi. Sa fort në shpirt na mallëngjeu!
Me saktësi e hir ç'gjë nuk shkërbeu[1)]!

Blerimi, ujëvara e argjendtë,
Dhe kënga e zogut, bubullimë e tmerrtë,
Dhe hija e kopshtit, dritë e zbehtë e hënës,
Madje as dhe përbindshat marramendës,
Më trembën. Dhe ashtu porsi natyra,
Që forcat kundërshtare, mërifryra,
I shtyn që të bashkohen, po kështu
Sundoi zanat, qëllim, s'e s'ishte hu!
Dhe bota e poetit plot shkëlqim
Me urdhër të këtij dha tingëllim!
Kjo shtyu muzat që plot gaz në kor,
T'i thonë: I natyrës je drejtor!

Kush veç atij kaq me guxim e mend
Mjaft frerë në një dorë i mbërthen?
Këtu ku çan sikush udhës së vet,
Ku dhe një shërbëtor detyrën pret,
Ku dhe poeti vetë në nevojë
Të skenës drita duhet t'i pastrojë!

Mjaft njerëz vdekja e tij i ka brengosur,
Ku gjen njeri gazplot, kaq të përsosur,
Edhe mendon njeriu që ka nder:
Bukën e ha, por s'kam si ai vlerë!

---

*1) Shkërbeu – imitoi*

Çuditeni? Shikoni se ç'qivur,
Sa pak e ndjekin, s'ka stoli, as nur!
"Si!" britni ju "kush ishte kaq artist,
Duhej pas vdekjes pasuri të kish!
Shkëlqimnë e zisë pse s'ia bëjnë, pse,
Që mirësjellje edhe nder veç shpreh?!"

Jo shpejt, por fati njësh bën pa dallim
Përtac, të zellshëm, skamës dhe zengjin!
Nuk kish mani të grumbullonte mall,
Përtypte çka fitoi me mund e hall!
T'u vijë keq, krijoi gjer në varr,
Ç'ish e dobishme me pasion e zjarr,
Gjithnjë edhe më pak nxori para,
I ngushulluar rroi, me shpresë u nda!

Këmbanat të buçasin me gjëmim,
Në dhe ta shtrijmë, miq, me hidhërim!
Kush e lëvdoi atë tani këtu?!

Ju, motra, që mes lolosh plot poterë,
Në karron [1] e tërhequr nga gomerë,
Pa mbrojtje nga uria, turpi e fati,
Që bridhni për t'u shitur mes çdo fshati,
Mes njerëzve e gjeni mirësinë,
Se bota di ta çmojë madhështinë!
Mes jush rrallë ka kurnacë e shpirtgur,
Ejani, hidhni lule mbi qivur!

Pa hapuni, një hap bëni, o miq!
Shihni kush vjen me hap kaq solemnisht!

---

*1) Karro e Thespit, krijuesit të tragjedive.*

Është ajo vetë, s'na mungon e mira,
Na e dërguan muzat flatralira!
E njihni, se gjithnjë ju ka pëlqyer,
Si lule botës i është rrëfyer;
Porsi model ngrihet portreti i bukur,
Përpara jush qëndron e s'rri e strukur!
I falën muzat çdo ndjesi e hir,
Në të u mbrujt ky art që s'ka të vdirë!
Pa mblodhi kaq fort joshje e aroma,
Dhe vetë emri të stolis, Korona!
Ajo po hyn. Shikoni sa shtatlartë!
Pa një qëllim, por me synim të qartë!
Vështroni tek ajo një ideal,
Që shfaqet tek artistët shpirtkristal!

Me hir e lehtazi po mban në dorë
Mes dhembjes më të bukurën kurorë.
Ti trëndafil plot gaz që flakërit,
Ti manushaqe, ti narciz që ndrit,
Ti karafil, ti tulipan me vesë,
Nga dorë vajze mbledhur pa përtesë,
Rrethuar e stolisur me mersinë,
Ju ka bashkuar arti tok me zinë!
Nga një shirit i zi, i lidhur lehtë,
Dafina e nxjerr kryet pak përpjetë!

Gjindja po hesht. Ajo vështrimmenduar
I hedh mbi varr kurorën e bleruar.
I çelet buza e kaq ëmbël rrjedh
Një ligjërim që zemrat i rrëqeth,
I flet: "Për ç'bëre, të faleminderit,
Pranoje, ti që ik prej nesh mes territ!

I miri dhe i ligu rrahin mjaft,
Por nga qëllimi të dy mbeten larg!
Ty të dha Zoti forcë dhe mend,
Pasion që s'shuhet i dha artit tënd!
Të mbrojti muza kohësh të këqija,
Me të, ndër ethe, lojte si fëmija!
Nga buzë e saj një qeshje çel pa zë,
Në krah e lodhur koka jote fle!
Kujtdo natyra po një gjë i dha,
Shiko pa qarje varrin tënd, vëlla!
Qivuri rri e hesht si gur gjithnjë.
Me dhe të shkrifët mbuloni atë!
Më e lehtë sesa jeta e dëlirë,
Të qoftë barrë e varrit, mik i mirë!

# Epilog për "Kambanën" e Shilerit

*"Ç'gaz qyteti, ç'bukuri,*
*Paqja qoftë kumbim i tij!"*

Ndodhi kështu! Prej tingush paqësorë
Kumbonte, tundej vendi, se ç'shkëlqim!
Fisnikun çift të ri e princëror
Me këngë e ngjatjetonim me gëzim!
Lëvizte turma, çdo grimë e çdo orë,
Zhurmonte, shtyhej, zjente papushim.
E tek çdo shkallë që stolisur ishte
"I artit adhuronjës" ne na grishte!

Por befas në mes natës fort gjëmoi
E rëndë, e mbytur një këmbanë zie!
E mundur? Miku që na zotëroi
Çdo lloj dëshire edhe hov rinie?
A mundet vdekja jetën ta sundojë?
Ah, sa trullos kjo gjëmë lemerie!
Ah, sa shkallmon kjo humbje, sa më s'mbajmë!
Sot bota qan, a mund ne të mos qajmë?

Dhe yni ish! Ah, burrin mendjelartë
Ç'të afërt e tregonte ditë e mirë!
Me ç'ngulm, me ç'shpirt të dashur e të zjarrtë
Nëpër biseda futej me dëshirë,
Me ç'frymëzim kuptimin fare qartë
Çdo plani jete ia nxirrte me hirë!

Në sa veprime, në sa këshillime
Ne na mësoi e na dhuroi gëzime!

Dhe yni ish! A mundet krenaria
Ta shtypë dhimbjen keq si një lastar?
Mes nesh si në një port nga ligësia
E shqota mund të mbrohej pa u ngarë,
Porse u sul ku ndriti bukuria,
Ku ndodhet e vërteta rrezear,
Dhe prapa tij – ç'na mvrejt e ç'na lidh fort,
Kjo botë boshe e mjaft e rëndomtë.

I zbukuroi të bukurat kangjella,
Nga melodi prej yjesh mbajti vesh,
Që plot me fshehtësi e krejt të kthjellta
Kumbojnë e jehojnë rrotull nesh.
Për ne, për vete në ç'ngadhnjime, ç'shtjella,
Ku kohët ngatërroheshin kaq shpesh.
Të zënë në mes punësh e takonte
Muzgu e nata që na ligështonte!

Në sytë e tij nga ngjarjet plot trazime
Pastrohej ç'ishte mburrje, ç'ishte dangë.
Ç'tiranë erdhën gjithë rrapëllime
E shfrynë përmbi botën mbytur plagë!
Në ç'lartësira e në ç'poshtërime
Jetoi me shpirt e s'u hoq kurrë zhargë.
Dhe tretej hëna, gazi të mos reshte,
Praronte dielli maja e krepa kreshte!

I skuqin faqet lulekuq të njomë
Nga një rini që shpejtas s'do mbaronte,
Nga një gëzim që herët ose vonë

Mbi plogështinë e botës do ngadhnonte,
Nga një besim që ngrihej lart gjithmonë,
Me një ngulmim që gjë s'mund ta shkallmonte!
Dhe rritej që t'i zbardhte i panxirë
Agu njeriut të ndershëm e të mirë!

Dhe pse me plot përvojë e vështrimgjerë,
Nuk e përçmoi skenën. Me ç'freski
Na pikturoi fatin që paprerë
Të dheut bosht vërtit gjithë fuqi!
Për art i denjë plot vrulle ngaherë,
Plot me mendim të thellë e fantazi
U hapi shteg synimeve të larta,
Vetë jetës në kaq pamje krejt të qarta!

E dini ju me ç'hapa prej vigani,
Na mati çdo dëshirë e çdo shtjellë,
Në ç'vende, ç'kohëra – hon oqeani –
U end e çdo gjë pa me sy të kthjellë;
Si gulçi këtë zemër prej luani
Fort e mundoi e dhimbja e shpoi thellë.
Dhe kishim mote brengash e gëzimi.
I yni ish, na ish për ne mësimi!

Atë që pas çdo dhimbje e lëngate
I ndrinin rishtas sytë e shihte larg,
Nga dallgët e së sotmes si terr nate
Rropateshim ta lehtësonim pak.
Në art që kish dhe zjarr, dhe shfrim shtrëngate
I rritej shpirti që nuk njihte cak,
Dhe kur në muzg të ditës u afrua,
Prej tij ne morëm gazin që s'iu shua!
Që herët ai mirë kish kuptuar,

Që vuajtjet dhe vdekjen kish për short,
Dhe ikte tej me shpirt të patrazuar,
Dhe ne na trembte ç'na mundoi kaq mot.
Kur poshtë pa, e shqoi më të kthjelluar
Të veten çështje që e ndezi fort.
Por çka bashkëkohësit në të qortuan,
Vdekja e tij e koha e shfajësuan!

Dhe ata shpirtra që me të luftuan,
Pa qejf ia njohën çdo shërbim e mund.
Nga forcë e tij e ndien se u gozhduan,
Në qark të tij u lidhën gjer në fund.
Për lart u sul ai dhe u rinua
Me gjithçka që ne çmojmë e na përkund,
Atë që s'kryen shpirtra kaq titanë
Mjaft breza duhet që t'ia dalin mbanë!

Tek neve mbet edhe pse ranë kaq shira,
Plot dhjetë vjetë që nuk është më,
Prej tij mësuam kaq gjëra të mira
Dhe botë e  tërë ia di për nder këtë.
Ndër njerëz u shpërnda, në ç'hapësira,
Ajo që kishte zot vetëm atë,
Shëndriti para nesh si një kometë,
Në dritën e pafund rron dritë e vet!

# Vuajtjet e djaloshit Verter

Kështu të dashurojë do çdo djalë,
Çdo vajzë do ta duan po kështu!
Pse ndjenja më e shenjtë e më e valë
Mbaron kaq keq dhe në kallkan këtu?

Ti qan e dashuron, njeri i shtrenjtë,
Nga turpi e shpëto kujtimnë e tij!
Shih, shenjë po të bën nga varr i shkretë:
Merr zemër e mos bëj si mua ti!

# Shkatërrimi i Magdenburgut*

O Magdenburg, ç'qytet,
Me vajza-yll e plot lezet,
Me gra e vajza plot lezet,
O Magdenburg, ç'qytet!

Gjithçka po ndrin krejt nur,
Vjen Tili zemërgur:
Mes kopshtesh, fushash dritë e nur,
Vjen Tili zemërgur!

Rreth muresh Tili rri,
Ç'i mbron qytet, shtëpi?
"Nga dera dil, o pëllmumb ti,
Lufto me trimëri!"

"Ç'e lodh mendjen, s'ia vlen,
Fort le të lehë ky qen!
Më le ta puth faqen, ç'shkëlqen!
Ç'e lodh mendjen, s'ia vlen!"

"Moj nënë jepmë bukë pak!
Babai mos vdiq në prak?
Moj nënë jepmë bukë pak,
Se ç'hall i madh, ç'farmak!"

"Yt atë mbet këtu,
Mjaft ikën kuturu!
Ndër udhë gjaku gjer në gju,
Për ku t'ia mbathim, ku?"

Rrëzohen kishat, ç'tmerr!
Shtëpitë digjen, ç'ferr!
Kërcet çatia, flakë nxjerr,
Ndër udhë ç'terr e ç'vrer!

Ah, nuk ka më shpëtim,
Ushtria bën kërdinë!
Shkallmon me zjarr e me tërbim,
Ah, nuk ka më shpëtim!

Shtëpi shemben ngado,
Tënden e timen s'i shoh!
Kjo bohçe s'është e jotja, jo.
Moj vajzë ik dhe mos ndalo!

---

**) Kjo poezi e mori lëndën nga shënimet historike të Shilerit për Luftën 30-vjeçare. Ajo ishte menduar si fillim për tragjedinë "Kampi i Valenshtajnit" të Shilerit, por u zëvendësua nga "Kënga e ushtarëve", po e Gëtes. Pas një rrethimi të gjatë e të mundimshëm, më 20 maj 1631, qyteti i Magdenburgut u shkatërrua dhe u shkretua nga ushtritë perandorake nën komandën e komandantit të përgjithshëm gjakpirës Johan Cerklaes Tili.*

# Tjerrësja

Tek po tirrja pa pushim
Heshtas e pa fjalë,
Erdh tek furka me gëzim
Një i bukur djalë!

Më lëvdoi, s'di sesi,
Ç'ish për t'u lëvduar,
Flokun tim, flokun si li,
Si fijet ndër duar!

S'ndenj i qetë e me kujdes,
Sikur ca më parë,
M'u këput fija në mes
Që e ruajta gjatë.

Peshë e lirit nga dje sot
Bëhej më e rëndë.
Për këtë nuk mundja dot
Që të shisja mend!

Kur tek endësi me zor
Shkova, ç'më lëvriu!
Zemra fort në kraharor
Rrahu e psherëtiu!

Dhe tani kur dielli djeg
E nxjerr për ta larë,
Me mundim ulem në pellg,
Shpirt e kyçe vrarë!

Çka në dhomë ditë e net
Qetazi kam tjerrë,
Do ta nxjerr në dritë shpejt
Nëpër qiell e erë!

# Maj

Nëpërmes grurit si ar,
Nëpër pemë e nëpër bar
Nëpër gardh e nëpër gjemb,
Ku më shkove?
Fol, në ç'vend?

S'ishte mikja
Në shtëpi,
Mund fisnikja
Bredh tani,
Ç'det blerimi
Ka në maj!
Nga gëzimi
Shkel çdo skaj!

Pranë lumit, tek një shkëmb,
Se ç'të putha, e mban mend?
Por tani në bar, dëgjo,
Diçka shoh!
Është ajo?

# Këngë maji

Me ç'madhështi
Natyra ndrin,
Si shkrep ky qiell,
Fushës ç'blerim!

Përplot me lule
Çdo degë u mbush.
Se ç'zëra, ç'tinguj
Në çdo gëmushë!

Ç'gëzim e ç'dehje
Nëpër çdo gji!
O dhe, o diell,
O lumturi!

O dashuri
Ndrit porsi ar,
Si re mëngjesi
Qiellit kristal!

Bekon me gaz
Fushën pa skaj.
Botën e dehur,
Lulet në maj!

O vashë, o vashë,
Syri ç'të ndrit.
Sa fort të dua,
Ç'më do me shpirt!

Si do lauresha
Këngë e liri,
Lulja e mëngjesit
Fllad e freski,

Të dua ty
Me afsh, me zjarr.
Në shpirt më zgjon
Vrull guximtar!

Për këngë e valle
Më fal plot gaz
E lumtur, qofsh,
Që më do kaq!

# Ndjenjë njerëzore

Ah, zotër! Zotër të mëdhenj,
Që rrini në qiell atje lart,
Na jepni ne që jetojmë në tokë
Mendje të thellë dhe kurajo,
Dhe ne do t'ua lemë, o zotër,
Qiellin tuaj pafund atje lart!

# Djali me fyell

Nëpër mjaft vende brodha unë,
Dhe fyellin pas meje,
Ngado ku qesh e pata punë
Ky fyell gjithë pas meje,
Edhe gjithnjë, edhe kudo,
Ky fyell pranë meje!

Të pasur zotër pashë unë,
Dhe fyellin pas meje,
M'u çel kjo ditë a pat furtunë,
Ky fyell gjithë pas meje.
Edhe gjithnjë, edhe kudo,
Ky fyell pranë meje!

Vajza plot hir ngado takova,
Dhe fyellin pas meje,
I ndeza prush e i gëzova,
Ky fyell, gjithë pas meje,
Edhe gjithnjë, edhe kudo,
Ky fyell pranë meje!

Më hedhin groshë për çdo këngë,
Dhe fyellin pas meje,
Ha, pi, këndoj, dëboj çdo brengë,
Ky fyell gjithë pas meje,
Edhe gjithnjë, edhe kudo,
Ky fyell pranë meje!

# Natë me hënë të plotë

Zonjë, ç'thotë kjo pëshpërima?
Ç't'i lëviz të tuat buzë?
Pëshpërin sikur ngaherë
Gëlltit verë që ndrin si shpuzë!
Mos kujton se ç'mërmërima,
Tek luhatesh si në erë!

"Puthje, puthje falmë mua!"

Pa vështro, në errësirë
Ndrin çdo degë e çdo fletë
Yll me yll lozin përdhe!
Ç'gurë smeraldi ndër shkorrete
Shkrepin porsi xhevahire!
Por pse hesht, e s'nxjerr një zë?!

"Puthje, puthje falmë mua!"

Miku yt ku po bredh vallë,
Kaq i lumtur, pa lëngatë,
Tek pi mjaltë edhe farmak
Nën këtë hënë të artë,
Mos sjell kënd ndërmend me mall!
Çast i lumtur erdh në prak!

"Puthje, puthje falmë mua!"

# Çifuti shtegtar[1)]

Në mes të natës, s'di se si,
Nga shtrati hidhem si i çmendur,
Më gufon gjoksi papandehur,
Që të këndoj atë njeri,
Që udhëtoi, pa plot çudi,
Që, me gjith talljet tërë llohë,
U gjend tek Zoti në çdo kohë.
Atë s'e kap kjo mendje dot!
Dhe pse s'i kisha për natyrë
Rimat rrëshqitëse, çaplehta,
S'u bëra bisht, me mund i gjeta,
Se kisha vrull e një detyrë,
Meqë lexonjës të njoh ty,
Vëlla të kam, ta them në sy,
Mëkate do, je ca avdall,
Shko, gjej një kalë plak gërdall,
Pa kil[2)], mes natës nëpër det,
Tek një shkop fshese kapem shpejt!
Prandaj dëgjo, në të pëlqen,
Çapraz çka shpirti më rrëfen!

Nëpër të gjithë Judenë mbarë,
I njohur ish një këpucar
Për zemrën e devotshmërinë.
Kish marrë kisha rrokullinë.
Ish dhe *esen* dhe *metodist,*
*Herrhunter,* dhe *separatist*[3)]

Dhe hiqte mjaft mundim e hall,
Sepse na ish origjinal.
Dhe për këtë ky, përnjëmend,
I lojtur ishte krejt nga mend!

Kjo priftëri motesh ka qenë,
Sikur ka qenë denbabaden,
Dhe, kur ndonjëri më në fund,
Një punë zyre gjen gjëkund,
Si mizë hidhet, zhuzhurin,
Si gjarpër shket e fërshëllin,
Mbërthyer nën një jakë a zhgun
Në fron pushon si firaun!
Dhe po të bëj be e rrufe,
Sikur Shën Pjetri, lart mbi re,
Diku t'i japë peshkopatë,
Dhe ky do bënte mjaft shamatë!

Ky këpucar dhe soji i tij
Për ditë deshnin një çudi,
Ndonjë na lutej për para,
Kështu një djall i fryu e i tha.
E varnin kryet krejt mendim,
Përmbi Sionim në lëngim,
Dhe në altar, kançeleri,
Nuk kish Aron e as Mojsi,
T'i bënte Zotit një shërbim,
Si çdo shërbim krejt pa qëllim.
Rreth e përqark botës u end,
I plakur në një prag u shemb.

"O ç'tmerr e ç'zi, Babiloni!
Nga dheu fshije, perëndi!

Lëre të digjet në batak,
Fronin e saj e kemi hak!"
Kështu këndonte shpirtzhuritur,
Duke u zvarritur e pëllitur,
Guakja turmë me mërzi,
Si në çdo tempull e qeli.
Dhe më e bukura na ish,
Sepse çdokush radhën e kish.
Si shoku i tij kot e më kot
Dhe tjetri shfrynte, ngjirej fort.
Në kishë fjala i ndrin ar,
Kujt në psalltir, si një gomar,
Pëllet, krekoset, si plot mend,
Kujt shpejt na lidh, na zgjidh në vend,
Dhe mëkatar është si ne,
Por ah, sagllam kurrë s'na qe!

Edhe u jepet dhe tani,
Që të kuptojë çdo njeri,
Sikur pikasin ç'verë ka,
Kur shtrohen dhe bëjnë shaka!

Kjo priftëri ngjiret, bërtet,
Se fund i botës erdh, medet!
Ndaj, mëkatar, përmendu pak!
Çifuti flet: "Nuk më tremb kjo!
Që çilimi m'u tha kudo!
O mik, njeriu qenka budalla,
Kujton se Zotin fis të tij e ka!

Babai rri në fron të vet,
Edhe të birin e thërret.
Thërret dy herë e tri herë,

Dhe biri vjen i zbehur dyll,
Penguar, ishte tek çdo yll.
I tha: Përse po urdhëron?
Babai i tha: - O bir, nga qe!
"Lart tek një yll që ndrin atje!
Atje ndihmova ca një grua,
Që një fëmijë ka me mua!"
U err i ati, u xhindos,
Ia ktheu: - Qënke fare lloz!
Shiko përposh në dhe një herë,
Si ndrin e qesh rreth e përqark!
Për njerëz ki merak ndopak,
Dhe ndihi turmës fatemjerë!"

... ... ... ... ... ... ... ... ...

Kur erdh më poshtë fluturim,
Edhe më pranë tokën pa,
Kur pa luadhe, det e vah,
Iu zgjua befas një kujtim,
S'e kishte ndjerë tash sa vjet,
Ia ngrohu shpirtin, e thërret.
Në këtë mal, në këtë shpat,
Ish ulur, ja, kështu dikur
Satani, mik të tij e pat,
Ia pikturoi botën plot nur,
Çdo madhështi, gëzim e fat!

Si gjindja pas një vajze ik,
Që na mundon e na sfilit,
Iku prej tij, ç'zhgënjim në gji!
Ndjeu si ajri frushullon,
Që tokën rreth e qark rrethon,

Ndjeu se çdo gëzim mbi dhe
Një parandjenjë dhimbjesh fsheh,
Edhe mendoi gjithë gaz,
Kur do të shoh të fundit çast,
Nga mal i dhimbjeve përdhe,
Do nis të flas kështu, për be:
"O dhe, ky shpirt të ngjatjeton!
Vëllezër, po ju puth bekimi!
Kjo zemër çel e lulëzon
Pas qindra motesh nga gëzimi!
Edhe sërish më rrjedhin lotë
Nga sytë e mi, valë të ngrohtë!
Njerëz, sa ëndërroj për ju!
Dhe ju plot zjarr e përdëllime
Për mua luteni këtu.
Po vij, për ju qan zemra ime!
O botë plot rrëmujë e çudi,
Plot rregullsi e çrregullsi,
Ti, hallkë brengash e gëzimi,
Ti, nënë që më linde të vdes,
Krijesa jote jam e do të mbes,
Dhe pse gjithçka s'ma kap kuptimi!"

... ... ... ... ... ... ... ...

Vikat shërbyesi: Ç'u bë
Drita, që rrodh nga fjala ime?!
Ah, fillin syri kund s'ma sheh,
Në qiell e enda me mundime!
Dëshmitë ku më humbën, ku?!
M'i mbajti në çdo gulfë gjaku!
Edhe ky shpirt nga shkoi kështu?!
Të linte gjurmëzat së paku!

S'rend me lakminë e pashuar,
Me dorë vjedhësi gati,
Ijesh të thara i mallkuar,
Cinguni plot ngut e zili?
Ia çart gëzimin e dëlirë
Fqinjit që veç arën lëron,
Dhe vjen përplaset pa mëshirë
Mbi dejtë e jetës që gjallon.
Nga qetësia gjithë trille,
Fuqi e burrit larg e grish,
Përlan, gëlltit si i pangirë
Ushqim e verë një qind fish!
Nën emrin tim i fryhet barku
Atij që foshnjeve ua merr,
Më nëm ndër zorrë mes farmaku
Çdo shenjë e brengës që më ther! –

I lodhur nga çdo vis që pa,
Kur robi mjaft andralla ka,
Por për mundim të zotit Krisht,
Të tijin hall e lë në bisht.
Erdh këtu pranë, në një vend,
Si flamur kishe shpejt u gjend.
Nuk kish si ky shumë atje,
Ndaj ish si Zot në atë dhe!
Iu lutën që tharmin e shtrenjtë
Kudo ta ndante me të drejtë,
Dhe frikë kish mos bukë e mirë,
I mbetej brumë qull, i ngrirë!
Dhe për këtë një oshënar
I foli udhës me pak bar.
I tha, në shtrat lëngon një e përdalë,
Që ka fëmijë e borxhe për të larë

E Zoti lart në qiell pushon,
Diçka të bëjë po mendon.
Dhe Zoti rreh që ta nuhasë,
Për Krishtin nis me hov t'i flasë:
Turma do kish më fort respekt,
Mos e mbulonte kokën e vet! –
Dhe e kuptoi menjëherë,
Se nuk e kish më zemrën sterrë,
Se çdo njeriut i rri në tru,
Porsi në mur gdhendja me dru!
Dhe po mbërrinin në qytet,
Shikonin pirgje e hendek.
"Ah, foli Krishti, shih atje,
Ç'port për dëshira e hare!
Atje shkëlqen froni qëndror,
Që drejtësi e besim prorë
Shpërndan, si ujët mineral
Ndër shishe në çdo vend e anë!"
Ato po vinin dhe më pranë,
Besimi erdhi dhe iu fik,
Porsi dikur, kur shkoi nën fik.
Megjithatë çapi më tej,
Nën degë shihte gjithandej.
Arritën, ja, nën derë sakaq,
Porsi i huaj ky iu shfaq,
Fisnik në pamje, veshur keq.
Thanë: - Kush je, a na merr vesh?
Shkronjësi: - Ç'emër na ke ti?
Përgjigjet tërë urtësi:
- Djem, bir njeriu unë jam,
Dhe qetas për matanë çan.
Fjala i kish dhe nerv, dhe gjak,
Ndaj shkronjësi mbet si guak!

Një roje ish, nuk di se si,
Askush pyetje s'i bën atij.
Përmes, serbes krisi përtej,
E sollën mendjen gjithandej,
Sikur po mbanin një raport:
Ç'gjëra do mund t'u thoshte dot?
Ç'u tha kështu tërë shpoti?
U tha: - "Jam bir nga një njeri!
E vranë mendjen boll ata,
Kur një kapter që piu ca,
Ua plas: - Ç'e zgjatni për këtë,
I ati ish njeri si ne!
Shpejt shoqëronjësit i flet
Ky Krisht: - Tek bir i Zotit drejt
Më ço, të tillë në njeh ti,
Një kryeprift i thonë atij!
I dogji priftit kjo në shpirt,
Se s'kish porsi ai ofiq.
Ah, sikur zemra rreth e qark
Të kish lëvore që aspak
Mos ndiente. Ish sa një bizele,
Por, meqë s'ish akull e zhele,
Mendoj: të mblidheshin tek unë,
Kujtdo i jepja *viatikum*![4)]

Dhe i çatisën në shtëpi,
Nuk kish dikur kaq begati,
Ndryshim kish bërë në ushqim,
Përlau e zhvati pa ngurrim.
Një prift: - Për dhoma e oborr,
Një tjetër që t'i mbjell, t'i korr,
Veçse nga ai tarikat,
Që grijnë mjaft, ngërdheshen pak.

Trokitën, thirrën fort me zë,
Dhe s'dinin se ç'të bënin më,
Një gjellbërëse doli në prag,
Përdhe i ra një kokërrlakër:
Për në kuvend u nis imzot,
Me të ju s'mund të flisni sot!
- Ku ndodhet? – pyet zoti Krisht.
- S'ju ndih, s'e gjeni, sigurisht!
Ia pret ajo si me vare.
- Se asnjë shteg s'të çon atje!
Po, meqë doni me kaq ngulm,
E që t'ua fsheh më nuk po mund,
Ai ka shkuar tek një grua,
Për të dalldisi e u mallua!

---

*1) Gëtja u shqua edhe si mjeshtër i madh i satirës. Arritja më kulmore satirike e tij është poema "Çifuti shtegtar", e cila, përmes një realizmi e satire të fuqishme, godet obskurantizmin fetar, degjenerimin moral e shpirtëror të klerikëve.*

*2) Kil ose karenë e anijes*

*3) Sekte të ndryshme fetare*

*4) Viatikum (latinisht dhe në origjinal) – kungimi i fundit para vdekjes.*

# Shënime sqaruese

## Nga *"Këngët"* dhe *"Baladat"*

***Amadisi i ri.*** Amadis ishte titulli i një sërë romanesh vijuese kalorsiake dhe aventurash portugeze dhe spanjolle të shekullit XVI dhe XVII.

***Mbreti i pyllit.*** Si frymëzim shërbeu përkthimi nga Herderi i baladës popullore daneze "Bija e mbretit të pyllit". Herderi e kishte përkthyer gabimisht fjalën daneze "ellerkonge" (mbreti i xhindëve) mbreti i pyllit, prandaj Gëtja krijoi padashur një figurë poetike e joshëse.

***Peshkatari.*** Hederi e përfshiu në "Këngët popullore" të tij më 1779 dhe tha se ajo ishte model për rrugën që duhej të ndiqte poezia, për t'u bërë poezi popullore.

***Mbreti i Tulës.*** Një nga pjesët më të hershme të shkruara për "Faustin" më 1774.

***Lulja më e bukur.*** frymëzuar nga kënga popullore "Unë njoh një lulez të kaltër", shrkuar për një kont të burgosur, nga Hamburgu, që kishte jetuar në sh. XIV.

***Këngë dasme.*** Motivin e mori nga "Festë dasme e vegjëlisë" në "Përrallat gjermane" të vëllezërve Grim, 1816), Gëtja e blojti në mendje për një kohë të gjatë para se të krijonte poezinë. Më, 1823 shkruan: "Disa motive të mëdha, disa legjenda, sipas gojëdhënave të stërlashta, m'u ngulitën aq thellë në mendje, saqë unë, qysh prej dyzet a pesëdhjetë vjetësh, i kam mbajtur të gjalla përbrenda; më dukeshin si prona më e mrekullueshme, figura të vyera që përtëriheshin në fantazi e gjithnjë shndërroheshin, pa u ndryshuar dhe merrnin një

formë më të pjekur, më të qartë, më të përcaktuar, më të kristalizuar. Dua të përmend këtu vetëm "E fejuara prej Korintit", "Zoti dhe bajadera", "Konti dhe xhuxhët", "Këngëtari dhe fëmijët" etj..."

***Gërmuesi i thesarit.*** Gëtja ia dërgoi poezinë Shilerit më 23 maj 1797. Shileri iu përgjigj po atë ditë me këtë letër: "Ju falemnderit për pusullën tuaj të dashur dhe për poezinë. Kjo është çuditërisht aq e bukur dhe e përkryer, saqë unë ndjeva me të drejtë si edhe një gjë të vogël, edhe një ide e thjeshtë me një paraqitje të përsosur mund të të japë kënaqësinë e një diçkaje të lartë. Edhe për sa u përket kërkesave të vogla të metrikës, ajo është e përkryer. Veç kësaj më kënaqësi atmosfera shpirtërore që ndjeva në këtë poezi të vogël, në të cilën ju mund të jetoni, se është atmosferë e këndshme dhe ndjesore."

***Gjahtari i minjve.*** Shkruar për një balet fëmijësh dhe shfaqur në Vajmar më 1802 a më 1803. Përrallën Gëtja e kishte lexuar që kur ishte i ri.

***Tradhtia e mullinares*** – Më 31 gusht 1979, Gëtja i shkroi Shilerit nga Shtutgarti. "Pas tërë këtyre mund t'ju them se unë, në rrugë e sipër, rashë në një gjini poetike, me të cilën në të ardhmen duhet të merremi më tepër e që ndoshta në kalendarin e mëtejshëm do të sjellë dobi. *Janë biseda në këngë.* Kam nisur kështu një bisedë midis një djali që ka rënë në dashuri me mullisen dhe jazit të mullirit, dhe shpresoj ta vazhdoj më tej. Alegoria poetike bëhet me këtë kthesë më e gjallë, e sidomos kur je në rrugë e sipër, ku mund të hasësh aq shumë sende. Është një gjini e mirë."

***Ekarti besnik*** – më 17 prill 1813 Gëtja i shruante Krisianës nga Naumburgu: "Shoqëruesi im më tregoi një legjendë të vjetër me fantazma, që unë, menjëherë sapo u ndalëm në malet Ekart, e vura në vargje".

***Nata e parë e Valpurgës*** - Sipas një legjende, çdo vit, natën e 30 prillit, duke gdhirë 1 maji, shrigat mblidheshin në Broken. Gëtja e njihte prej kohësh këtë temë, dhe e shfrytëzoi te "Fausti", i shkruante Celterit: "Midis hulumtuesve të historisë ka disa, dhe janë njerëz të cilëve s'ua mohon dot vlerën, që, në çdo fabulë, në çdo gojëdhënë,

qoftë ajo fantastike dhe e pavend, kërkojnë një bazë reale dhe nën cipën e përrallës u diket se gjejnë një thelb të vërtetë. Hulumtimeve të tyre ua dimë për të mirë, se për to duhen njohuri të thella, mprehtësi, fantazi, për ta bërë kështu poezi prozën. Pra, një nga hulumtuesit e lashtësisë, udhëtimin e shtrigave dhe të djallit në malin Brokën, që përmendet që në kohët e vjetra e argumenton me një burim historik: priftërinjtë paganë gjermanë dhe etërit e lashtësisë, pasi u dëbuan nga skorretet e tyre të shenjta dhe u fut në popull krishtërimi, shkuan bashkë me ithtarët e tyre në malet e shkreta, të paarritshme të Harcit, në ditët e para të pranverës, dhe atje, sipas zakonit të vjetër, bënin lutje dhe ndiznin zjarr për nder të Zotit të padukshëm të qiellit dhe të tokës. Për të shpëtuar nga misionarët e armatosur, paganët, menduan që disa prej tyre të maskoheshin për t'i mbajtur larg kundërshtarët e tyre bestytë, dhe, të mbrojtur nga surretërit e djallit, të kryenin shërbimin ndaj Zotit. Këtë sqarim e kam gjetur, diku, sot e shumë vjet më parë, po nuk e di se cili është autori. Kjo ngjarje përrallore më pëlqeu dhe e ktheva në fabul poetike.

***E fejuara prej Korinti*** – Tema e saj rrjedh nga një histori e lashtë fantazmagorike. Gëtja bashkoi temën antike me motivin e vampirëve dhe i dha përrallës rrëqethëse përmes përqasjes helenizëm – krishtërim, aspekte botërore. Poezia bëri bujë te bashkëkohësit. Karl August Bëtigeri i shkruante Fridrih Matisonit: "Për asnjë vepër tjetër nuk janë më të ndara mendimet se sa për baladë të fuqishme të Gëtes. Ndërsa njëra palë, pala reaksionare, e quan më të neveritshmen e skenave të shthurura dhe një përdhosje të krishtërimit, pala tjetër e quan më të përkryerën e veprave të vogla artistike të Gëtes." Vilhelm fon Humboldti, i shkruante Shilerit më 7 dhjetor 1797: "Perëndia dhe bajadera" merr edhe prej meje një çmim. Por më pëlqen fort edhe "E fejuara prej Korintit" Ajo e vesh aq bukur me hirin grek edhe botën fantazmagorike të Veriut".

## *Nga "Elegjitë romane"*

Në qershor të vitit 1788 Gëtja u kthye nga Italia në Vajmar. Në korrik ai ishte njohur me Kristianë Vulpiusin. Në këtë kohë, shoku i vjetër i Gëtes Karl Ludvig fon Knebeli po merrej me përkthimin e elegjive të Propercit e po punonte tej mase. Gëtes i ngjalli interes të madh kjo punë dhe u thellua sërishmi në lirikat dashurore të poetëve romakë, Katulit, Tibulit, Propercit, Ovidit dhe Horacit që i njihte që në të ritë. Ngjarja në Itali, takimi me Kristianën, erotika antike e vonshme, të gjitha vepruan së bashku, që, prej vjeshtës së vitit 1788 gjer në pranverën e vitit 1790, Gëtja të krijonte "Elegjitë romane".

Shileri i shkruante Gëtes më 28 tetor 1794: "Për elegjitë të gjithë ju falenderojmë tepër. Në to ndihet një ngrohtësi, një ëmbëls dhe një frymë e vërtetë poetike, që të vjen mirë t'i lexosh midis krijimeve të sferës së sotme poetike". Para botimit u lëmua rrënjësisht forma e elegjive. Një ndikim vendimtar ushtroi bashkëpunimi i Gëtes dhe i Shilerit në përkthimin e Knebelit të Propercit, po edhe përkthimi përfitoi nga elegjitë e Gëtes. Elegjitë dolën më 1795 në pjesën e parë të vëllimit të dytë të "Orëve".

"Centauri" e quajtën Gëtja dhe Shileri fletoren që u përkiste "Orëve", bashkonte poezinë erotike të Gëtes dhe letrën e fundit të Shilerit "Për edukimin estetik të njeriut." Shileri i shkruante Gëtes: "Ç'kam marrë vesh për "Centaurin", është një përshtypje shumë e mirë. Për elegjitë të gjithë janë të kënaqur dhe askush nuk mendon se mund të skandalizohesh me to". Bashkëkohësit moralizues e dënuan veprën, gjoja për imoralitetin e saj.

Johan Baptist fon Alcingeri i shkruante më 25 mars 1797 Bëtingerit: "Properci mund ta thoshte me zë të lartë se kishte kaluar një natë të lumtur me miken e tij. Por kur zoti Gëte e tregon në "Orët" faqe gjithë Gjermanisë lidhjen e tij me dashnoren italiane nuk është çështja por individualiteti: është puna se këtu nuk flet poeti, por këshilltari intim, një person i caktuar, dhe duket sikur ai nuk do të na tregojë një poezi, por një histori të vërtetë".

Shileri, lidhur me këto kritika, i shkruante dukës Fridrih Kristian fon Augustenburg: "Elegjitë... ndoshta janë shkruar lirshëm e për shkak të objektit që trajtojnë, mund të shkëputeshin nga "Orët", po bukuria e lartë poetike, me të cilën janë shkruar, më rrëmbeu, prandaj them se me to nuk lëndohet ndjenja e natyrshme e turpit, por vetëm një ndjenjë formale". Dhe gjashtë vjet më vonë, më 20 shkurt 1802 admirimi i tij është shtuar edhe më. Ai i shkruan Gëtes: "Këto ditë i lexova sërish elegjitë edhe idilet tuaja, dhe s'jua shpreh dot se si, kjo frymë e vërtetë poetike ka dëpërtuar në skutat e thella e më ka flladitur dhe gjallëruar shpirtin. S'kam parë gjë të tillë, as midis veprave tuaja; më çiltërsisht e më tërësisht s'e keni shprehur në vepra të tjera individualitetin tuaj dhe botën".

*Genius.* Këtu është fjala për genius loci (lat. = engjëlli mbrojtës i një vendi).

*"Malbruh".* Mund të jetë fjala për një këngë ushtarake frënge që ka të bëjë me një kryqtar të quajtur Malbruk. Por mund të jetë edhe një poezi satirike që e hedh fjalën te Xhon Çërçilli, dukë fon Malbarë (1650-1722), i cili gjoja ka rënë në fushën e betejës.

*Gali zemërak* – Gëtja e hedh fjalën për revolucionin frëng.

*Në pyllin Ida* – Sipas gojëdhënës, Afërdita i doli përpara në malin grek Ida si bareshë bariut Ankiz. Nga dashuria e tyre lindi Enea.

Një legjendë e lashtë thotë, se perëndesha greke e hënës Selena (rom. Luna) e vuri në gjumë Endimionin, që të mund ta puthte lirisht...

*Hero... Leandër.* Dy dashnorë të famshëm të lashtësisë.

*Rea Silva* – Nënë e dy binjakëve Romuldi dhe Remi, themelues të Romës, sipas legjendës.

*Lumi Tiber* – Gëtja e quante gjithnjë lumin: Tiberi.

*Perëndive të të gjithë popujve* – Feja e romakëve bashkonte në kohën e perandorive veçoritë e kulteve më të shumta politeiste. Kështu që perënditë romake kishin marrë pjesërisht vetitë e perëndive të huaja, sidomos të grekëve. Nga kjo shpjegohet edhe këmbimi midis emrave mitologjike greke dhe romake (Jupiter-Zeus) në elegjitë.

Kulti i Isis ose Isiris kishte ndikuar që në kohët e hershme në mitologjinë romake. Gëtja kishte parë skulptura egjitpiane në koleksione romake ("Udhëtim në Itali").

*Erinitë* – Perëndi greke të hakmarrjes.

*Mbi rrotën mundimtare* – Sipas mitologjisë greke, mbreti Iksion ra në dashuri me Herën, nënën e perëndive. Kur ai zuri të mburrej që e kishte me sy të mirë perëndesha, Zeusi dha urdhër që ta lidhnin, në një rrotë zjarri rrotulluese. Prometeun, birin e Titanit, që doli kundër dëshirës së Zeusit, të mbronte njeërzit në rrezik, e mbërthyen te shkëmbi i Kaukazit.

*Proteu dhe Teti* – Perëndi e detit dhe nimfa e mitologjisë greke.

*Koha iku* – Sajim poetik për të fshehur përmbajtjen autobiografike të elegjive.

*Triumvirat* – Sundim i tre burrave në Romën e lashtë. Si "Triumviri amoris" filologu i vjetër Jozef Skaligeri quante lirikët romakë, Tibulin, Propercin dhe Katulin, poezitë e dashurive të të cilëve botoheshin shpesh të bashkuara në një vëllim.

*Prelatë* – Këtu ka dy kuptime. Edhe në kuptimin literal do të thotë: i preferuari.

*Çorape të kuqe* mbajnë kardinalët, kurse ngjyrë vjollce prelatët.

*Heba* – Perëndeshë greke e rinisë, e cila i pret mysafirët në Olimp e i gostit me nektar.

*Hermes* – Perëndi greke, i cili i përcjell të vdekurit në botën e nëndheshme.

*Çesti* – Varri i Gaius Cestius, e një tribuni të popullit romak. Pranë tij ishte, në kohën e Gëtes, varreza protestante. Më 16 shkurt 1788 Gëtja i shkruante nga Roma Fric fon Shtainit: "Para disa netësh, meqë bluaja mendime të zymta, e caktova varrin tim pranë varrit të Cestiusit..." Më 1830 në këtë vend u varros i biri.

*Heinrich* (Enriku IV), mbret i Francës.

*Lete* – Lumë i botës së nëndheshme.

*Panteon* – Tempull i të gjitha perëndive. Gëtja përmend skulptura të ndryshme perëndish. Në vegimin e poetit ato bëhen figura të gjalla të shtëpisë së tij.

*Jupiter* – Mund të jetë Jupiteri i Otrikalit.

*Febus* – Feb Apolio, këtu mund të jetë Apoloni i Belvederes. Gëtja i shkruna Sharlotë fon Shtainit: "Apoloni i Belvederes ua kalonte të gjitha skulpturave..."

*Minerva* – Perëndesha romake e tregtisë, e historisë, e arteve. Këtu mund të jetë Minerva Xhustiniana.

*Baku* – Perëndi e verës dhe e pjellorisë.

*Citera* – Emër i ngjitur Venusit. Gëtja i shkrunte Karl Augustit: "Venusi i galerisë Mediçi është shumë më e bukur nga sa mund të pritej e të besohej."

*Biri ynë*- Mund të jetë Priapi, një nga perënditë antike të pjellorisë.

*Flamina* – Rruga flamine. Gëtja banonte në Romë afër Porta del Popolo (Porta e popullit), e cila nga rruga e vjetër (Via Flamina) të çon në Kampanja (Fusha e Romës).

*Ceres... Eleusis... Demiter... Janson* – Gëtja bashkonte dhe përziente në këtë elegji motivin kryesor të kultit të Demetrës (ose Ceres), të mistereve të Eleusis dhe të legjendës së Jasonit.

*Ariana* – Sipas gojëdhënës, Arianën, të bijën e mbretit të Kretës, e rrëmbeu nga Kreta Tezeu. Pastaj Tezeu e braktisi, ndërsa ajo flinte.

*Flori* – Ael Spartani tregon këtë anekdotë në biografinë e tij për Adrianin: Poeti Flor, për perandorin Adrian që bënte udhëtime të gjata më këmbë nëpër mbretërinë e tij, kishte bërë këto vargje: "S'do të doja të isha perandor, të endesha nëpër Britani e të duroja brymën e Skitisë". Adriani iu përgjigj: "S'do të doja të isha Flor, të bridhja tavernë më tavernë, të shkoja në pijetore të këqija e të duroja pleshtat e majmë".

*Shtatë kodrat* – Roma e lashtë ishte ndërtuar mbi shtatë kodra. (Ia kishin ngjitur emrin *urbs septicollis* (lat.) qyteti i shtatë kodrave.)

*Parka* – Mitologjia romake njeh tri Parka (perëndesha të fatit); njëra tjerr fijen e jetës.

*Faustina* – Emri i dashnores romane të Gëtes vetëm këtu përmendet. Janë bërë shumë herë përpjekje të kota, për të vërtetuar marrëdhëniet e Gëtes me vejushën romane Faustina Antonini.

*Fama* – perëndesha e namit, e legjendës.

*Ngadhnjimtari i amazonave* – Fitorja mbi amazonat është një nga heroizmat më të njohbura të Herakliut.

*Nën pushtetin e mrekullueshëm...* Sipas mitologjisë antike Herakliun (Herkuli), për ta shpërblyer që shëroi nga çmenduria mbretëresha lidiane Omfale, e vunë të punonte si shërbëtor. Midis punëve të tjera endte edhe stof për petka. Gëtja e lidh këtë gojëdhënë me legjendën, sipas së cilës Afërdita, e shoqja e Hefesit (perëndi e zjarrit dhe e farkës) dashuroi perëndinë e luftës, Aresin dhe Hefesti i lidhi në shtrat të dy dashnorët me rripa hekuri të rrahur. Historinë e fundit e përktheu Gëtja nga "Odiseja" e Homerit.

*Lida* – Apoloni, sipas legjendës, bëri që mbretit Mida të Frigisë t'i rriteshin veshët sa të gomarit, për dënim, sepse ai përlqeu më tepër fyellin prej bariut të Panit sesa lirën e Apolonit. Mida u përpoq t'i fshihte veshët nën shapkën frigiane, mirëpo berberi i zbuloi. Berberi u përpoq ta hiqte qafe këtë të fshehtë. E vuri të fshehtën në vargje dhe e groposi në dhe. Ky variant e mbyll elegjinë.

*Kuiritët* – Është fjala për bashkëqytetarët vajmaras të Gëtes.

***Aleksi dhe Dora*** – Gëtja ia dërgoi Shilerit më 14 qershor 1796 dhe Shileri iu përgjigj më 18 qershor: "Kur e lexova për herë të dytë idilin më la mbresë e më mallëngjeu më tepër se në leximin e parë. Sigurisht, është më i bukuri nga ato që keni bërë, është plot thjeshtësi, megjithëse është nxjerrë nga një thellësi e pamatur e ndjenjës".

***Eufrosina*** – Në ditarin e Gëtes është shënuar "vdiq një aktor i vyer, *Noimani* dhe la një vajzë katërmbëdhjetëvjeçare, vasha më e dashur e me talentin më të natyrshëm që bëhet. Për të m'u lutën ta mësoja për teatër... "Mbreti Johan"... i Shekspirit ka qenë suksesi ynë më i madh... Kristiana Noiman në rolin e Arturit, që ia mësova unë, luajti për mrekulli". Kristiana Noiman pesëmbëdhjetë vjeçe u martua me aktorin e ri Beker e më 1797 vdiq.

Titulli është emri i njërës prej tri të bukurave të mitologjisë. Gëtja bën aluzion për njërën prej roleve të fundit të Kristiana Beker Noimanit, për Eufrosinën.

*Mësuesin, mikun, atin.* Ngjashmëri me lidhjen e Minjonës me Vilhelm Maisterin.

*Artur* – Figurë nga "Mbreti Johan" i Shekspirit. Gjatë provave e kishte luajtur vetë Gëtja rolin e kryeintendentit të pallatit. Arturi vdes, pasi hidhet nga dritarja.

*Persefoni* – Perëndeshë greke e botës së nëndheshme (Ferrit) e mbretërisë së të vdekurve të mitologjisë së lashtë. Ajo ishte bija e Demetrës (perëndeshë e pjellorisë) dhe atë e rrëmbeu Hadi.

*Penelopa* – Më besnikja e grave, sepse gjatë mungesës së të shoqit, Odiseut, i refuzoi të gjithë ata që e kërkuan për grua.

*Eudna* – U hodh në flakët që të vdiste pranë kufomës së të shoqit, heroit grek, Kapaneut.

*Antigona* – E varrosi vëllaun e saj, Polinikun, kundër urdhërit të mbretit Kreon, e për dënim u varros e gjallë.

*Poliksena* - E fejuara e Akilit, e flijuan në varrin e të fejuarit.

***Nikias*** – Ndikimi i lirikëve romakë dhe pjesëmarrja e Gëtes në përkthimin e Knebelit të Propercit ndikoi edhe një kohë të gjatë në krijimin e elegjive. Emrat Amintë dhe Nikias i njihte nga idilet e Teokritit.

## *"Epigramet Veneciane"*

Pas një udhëtimi prej tri javësh Gëtja erdhi në Venedik, që të shoqëronte nënën e dukës, dukeshë Ana Amalia, kur të kthehej nga Italia në Vajmar. Ana Amalia erdhi në Venedik më vonë nga sa ishte parashikuar dhe Gëtja ndenji vetëm në qytet gjer më 6 maj. Gjatë udhëtimit të parë në Itali kishte vizituar Venedikun në vjeshtën e vitit 1786 dhe ishte kënaqur atje. Kurse kësaj herë ishet mërzitur se iu desh të linte në Vajmar Kristina Vulpiusin dhe të birin, Augustin që i kishte lindur më 25 dhjetor 1789. Edhe punimet e tij poetike dhe të shkencave natyrore u ndërprenë. Gëtes iu desh të vizitonte qytete të tjera italiane. Në këtë periudhë ai ishet mërzitur për gjithçka dhe mërzia ia mprehte vështrimin kritik. Kjo gjendje shpirtërore

formoi thelbin e një numri të madh epigramesh të përmbledhjes së ardshme që i kishte krijuar në Itali. Me gjithë mprehtësinë therëse të kritikës për situatat në Itali e që shprehet në epigramet, prapë këto nuk ishin fjala e fundit e Gëtes për Italinë.

Krahas epigrameve, në të cilat sulmon sidomos kishën, politikën, bestytninë, janë edhe epigramet që pasqyrojnë qëndrimin e Gëtes ndaj revolucionit frëng, polemikën me Njutonin dhe marrëdhëniet e tij me Kristianën.

*Djepi i Virgjilit* – Vendlindja e Virgjilit, Andeu, pranë Mantovës.

*Dafne* – emri i një nimfe greke, të cilën, i ati, Peneiosi, perëndi e lumit, e ktheu në një shkurre dafine, që t'u shpëtonte ndjekjeve të Apolonit.

*Kërkova një dashuri*- S'mund të vërtetohet, nëse epigrama ka të bëjë me një figurë gruaje të caktuar. S'është çudi që Gëtes i qan zemra që iu zhduk dashuria për Italinë.

*Nunci* (lat.) lajmëtar – Ambasador i papës pranë një qeverie laike.

*Jupiter Pluvius* – Jupiteri si perëndi e shiut.

*Bretkët me mantel ngjyrë alli* – Aluzion për veshjen venedikase. Gëtja i shkruan Karl Augustit: "Tani jam midis amfibëve (njerëz me dy faqe), por do të mësohem së shpejti me ta.

*Mjaft gjëra kam provuar...* - Gjuha gjermane i duket këtu Gëtes si "lënda më e keqe" në krahasim me italishten, që është më e zhdërvjellët dhe poeti mund ta trajtojë më lehtë. Ky ankim tregon atë përpjekjen, mundimin e poetit për të përdorur në poezinë gjermane metrikën e vargut antik.

*I vogël princi im...*- Epigrami u krijua para udhëtimit të dytë në Itali. Më 10 maj 1789 i shkruante Karl Augustit që ndodhej pranë regjimentit prusian: "Qofshi mirë me shëndet dhe kujtomëni nën armë. Po iu bëj një ditiramb, në një vend, që as mund ta mermi me mend, e ju lutem të më falni".

*"Vuajtjet e të riut Verter"* – u botua më 1774 i përkthyer në frëngjisht, më 1776 në holandisht, më 1779 në anglisht, më 1781, në italisht, më 1783 në suedisht, më 1788 në rusisht.

Piktura kineze në xham me motive të romanit u bënë të njohura në Gjermani.

*Augusti e Mecena* – Duke marrë shkas nga emri i dukës, Gëtja e lavdëron si perandorin August. Perandorin e ngrinin në qiell për shpirtmadhësinë e tij.

*Xhiovani Belini* – piktor italian nga Venediku.

*Dhëndri* – Tablo e Paolo Veronezes "Dasma në Kan" (Testamenti i ri).

*Ganimedi* - Ganimedi është kamerieri dhe kanakari i Jupiterit.

*Centauri* – Qenie përrallore, gjysmë njeriu, gjysmë kalë.

*Shën Antoni* – Shën Antoni katolik, reliket e tij gjoja çudibërëse ruhen në Padova.

*Tani populli...*- Shprehje e figurshme për të treguar nga njëra anë parapëlqimin e aristokracisë për gjuhën dhe sjelljet frënge, nga ana tjetër, përhapjen e revolucionit frëng në Gjermani.

*Apostull* – Shën Pjetri – (Testament i ri).

*Kloe* – Emër anakreontik, që s'ka të bëjë me asnjë njeri.

*Filarko* – (emër grek: ai që kërkon të sundojë). Gëtja e ktheu këtë mbiemër në emër të përveçëm të një tipi njeriu.

*Afërdita* – Perëndeshë greke e dashurisë dhe e bukurisë.

*Eoli* – Perëndi antike e erës.

*Në bregun e ftohtë* – Nën botën e nëndheshme, përtej Stiksit. Ndoshta Gëtja e lidh këtu përfytyrimin e lashtë të ujit të ftohtë akull, të lumit arkadian Stiks, me të njëjtin emër të lumit të botës së nëndheshme.

*Mida* – Një nga legjendat për mbretin frigian thotë se Mida kishte kërkuar prej Dionisit dhuratën, që gjithçka që të prekte të kthehej në flori. Kështu që edhe ushqimet që ai vinte në gojë bëheshin flori.

*Orët* – Tri perëndesha greke të ndërrimit të stinëve. Ato trupëzonin edhe rendin ligjor (eunomia), të drejtën (dike) dhe paqen (eirene).

*Lais* – Një nga kurtizanet e famshme greke.

*Shën Pavli... Shën Stefani* – Shën Pavli, nga armik i krishtërimit u kthye në një nga apostujt më aktivë. Shën Stefani – pararendësi i tij, një nga viktimat e para të ndjekjes kundër të krishterëve.

*Lavater* – Kjo epigramë drejtohet kundër teologut dhe fizionomistit nga Cyrihu, Kaspar Lavaterit.

*Nauger* – Andreas Nauger, autor epigramash veneciane, që përbuzte Marcialin. Çdo vit, në një ditë kushtuar muzave, ai digjte me mallkime vëllime të veprave të poetit romak.

*Bretkoca* – Edhe banorët e Venedikut Gëtja i quante shumë herë si "Amfibë" ose si "Bretkoca".

## *Nga "poezi të ndryshme"*

***Këngë e Muhametit*** – Poezia mund të jetë krijuar në dimrin e vitit 1772-73 bashkë me dramën e pambaruar "Muhameti".

*Shtëpi prej kedri* – anije të ndërtuara me dru kedri.

***Këngë të shpirtrave mbi ujërat*** - Për krijimin e kësaj poezie u bë shkas admirimi i Gëtes për peizazhet e bukura që shihte i mrekulluar gjatë udhëtimit të tij në Zvicër, e për të cilat i shkruante Sharlote fon Shtajnit.

***Udhëtim dimëror në Harc*** – Që më 29 nëntor gjer më 19 dhjetor Gëtja bëri udhëtimin e tij, të parë me kalë në Harc, ku, insepktimi dhe studimi i minierave i hëngrën një pjesë të madhe të udhëtimit. Gjatë udhëtimit u frymëzua dhe shkroi poezinë që është himni i fundit me ritme të lira nga periudha e parë në Vajmar. Ajo u botua më 1789.

*Fijet e hekurta* – Filli i jetës që e tjerr Parka dhe në çastin e vdekjes e pret.

*Psalter* – Këtu ka kuptimin instrument me tela.

***Karrocieri Kronos*** – Në të hyrë të tetorit 1744 Klopshtoku e vizitoi Gëten në Frankfurt. Gëtja e përcolli poetin e nderuar deri në Darmshtat. Kur u kthye, krijoi poezinë me titull "Karrocierit Kronos". Në titull është perëndia e kohës Kronos, të cilin e ngatërron me atin e perëndive. Perëndia Kohë nget (si karrocier) koçinë e jetës.

*Orkus* – Bota e nëndheshme, mbretëria e të vdekurve; në kuptim më të ngushtë vendqëndrim i heronjve të vdekur të lashtësisë.

*Hanxhi* – Plutoni, mbret i Ferrit.

***Kënga e udhëtarit në shtrëngatë.*** Në "Poezia dhe e vërteta" shkruan "Më shumë se kurdoherë unë ecja në botën e hapur, në natyrën e lirë. Rrugës këndoja himne të çuditshme dhe ditirambe, nga të cilat më ka mbetur vetëm njëra me titull "Këngë e udhëtarit në shtrëngatë". Unë e këndoja me pasion, kur u prish moti e më zuri rrebeshi e unë duhej të ecja në mes të shtrëngatës". Kjo poezi është më e hershmja e Gëtes me ritëm të lirë.

*Lymi i Deukalionit* – Në mitologjinë e lashtë quheshin kështu ata të vetmit që shpëtuan nga një përmbytje që shkaktoi Zeusi: Deukalioni dhe Pirha.

*Pitius Apoloni* – Sipas një himni pseudohomerik, Apoloni vrau kuçedrën Piton që kishte lindura nga balta, që kishte mbetur nga përmbytja.

*Hiret* – tri të Bukurat që ishin dashamirëse për artistët. Sipas Pindarit, në Olimp ato e kishin vendin pranë Pitius Apolonit.

*Bromius* – Zhurmuesi. Emër i ngjitur Bakut për të treguar se festat i ishin kushtuar atij.

*Pindari* – poeti më i shquar lirik i grekëve të lashtë, himnet e të cilit nderonin fituesit e lojërave olimpipke. Vepra e Pindarit kishte ndikuar fort te Gëtja. Edhe ritmi edhe hovi ditirambik i poezisë (këngë vrulli) tregojnë ndikimin e Pindarit.

*Feb Apoloni* – Apoloni si perëndi e diellit.

*Kedri* – është një dru që bleron gjithmonë.

*Jupiter Pluvius* – Jupiteri si perëndi e shiut.

*Sibarit* – Lumë në Italinë e jugut.

*Teokriti* – Krijuesi i poezisë së lashtë baritore, i idilit.

***Ganimedi*** – Nuk dihet se kur është shkruar kjo poezi. Gëtja shkroi mitin e të riut të bukur Ganimed, të cilin, një shqiponjë apo Zeusi me pamjen e një shqiponje e rrëmbeu dhe e çoi në Olimp, ku Zeusi e bëri kanakarin dhe kamerierin e perëndive.

***Parku i Lilit*** - Shkruar ose gjatë udhëtimit në Zvicër ose pas prishjes së fejesës me Lili Shënemanin.

*Park* – këtu ka kuptimin kopshti zoologjik.

*Ambrozia* – Ushqim i perëndive.

*Pipi* – Amadisi i ri.

*Oreadet* – nimfat

***Elegji*** - Elegjia u krijua që më 5 gjer më 12 shtator të vitit 1823 gjatë kthimit nga Marienbadi, pjesërisht në karrocë, pjesërisht gjatë ndalesave. Gjatë qëndrimit në Marienbad, në verën e vitit 1821, 1822, 1823, Gëtja takohej thuajse përditë me zonjën Amali fon Levecov e me vajzat e saj. Ai ra në dashuri me njërën nga vajzat, me Ulrikën dhe e kërkoi për grua[1]).

Gjatë qëndrimit të përbashkët në Karlsbad, në shtator 1823 e kërkoi për grua me ndërmjetësinë e dukës së Vajmarit Karl Augustit, por e refuzuan. Ulrika fon Levecovi shkruan në kujtimet e saj: "... ishet ai (Karl Augusti) që u tha prindërve të mi dhe mua, se unë do martohem me Gëten; në krye e morëm për shaka dhe thamë se Gëtja me siguri që nuk mendonte një gjë të tillë, por duka tha se ishte e vërtetë dhe kaq herë më përshkroi se unë do të isha në Oborr dhe në Vajmar dama kryesore, se do t'u ndërtonte prindërve të mi një shtëpi në Vajmar, që ata të mos rronin lart meje e se do të kujdesej për të ardhmen time. I tha nënës, e më vonë e dëgjova edhe unë, se ai kishte premtuar, meqë unë do të rroja më shumë se Gëtja, të më caktonte pas vdekjes së tij një pension vjetor prej 100.000 taler. Pas refuzimit të fundit, Gëtja u largua nga Karlsbadi. Ai nuk shkoi më në banjat e Karlsbadit. Në Vajmar filloi menjëherë të hidhte "elegjinë" në të pastër. Gëtja zuri ca nga ca t'ua tregonte poezinë miqve të ngushtë. Ekermani tregon për 27 tetorin e vitit 1823: "Shtadelmani solli dy qirinj, të cilët i vuri mbi tryezën e shkrimit të Gëtes. Gëtja m'u lut të zija vend pranë qirinjve, se donte të më jepte diçka për të lexuar. Dhe ç'më vuri përpara? Poezinë e tij më të re, më të dashur, "elegjinë"

---

*1) Në këtë kohë Gëtja ishte 74 vjeç.*

e tij nga Marienbadi. Këtu duhet të shënoj edhe diçka në lidhje nga banjat e Karlsbadit, u hap këtu fjala, se ai ishte njohur atje me një vashë të re, sa e bukur aq edhe e sjellshme, dhe e dashuroi me pasion. Kur ai dëgjoi në rruginën e kopshtit zërin e saj, hoqi shpejt kapelën e iu afrua me vrap. Ai s'la ditë pa ndenjur pranë saj dhe kaloi ditë të lumtura; kështu që ndarja qe për Gëten shumë e rëndë, e në këtë gjendje shpirtërore të pushtuar nga pasioni, ai bëri një poezi shumë të bukur, të cilën e shihte si një gjë të shenjtë dhe e mbante të fshehtë. I kishte shkruar vargje me dorë, me shkronja latine, në letër të hollë me kapak prej lëkure të kuqe, lidhur me një kordon të mëndafshtë, dhe dukej se këtë dorëshkrim e mbante si diçka shumë më të vyer se të tjerat".

*Kerubin* – Sipas gojëdhënës biblike kerubinët e mbronin parajsën me shpata të zjarrta, qëkur e përzunë që atje njeriun.

*Serafin* – engjëll.

***Pajtimi*** – Kjo poezi, u krijua në Marienbad në mes të gushtit 1823, domethënë para "elegjisë", e iu kushtua pianistes Maria Simanovska nga Petërburgu. Gëtja e shënoi në albumin e saj. Më 24 tetor Maria Simanovska erdhi në Vajmar dhe vinte përditë si mysafire te Gëtja e i binte pianos për të. Kujtimi i ngjarjeve të verës dhe ato lidhur me ikjen e pianistes ia ngashëryen shpirtin e i shkaktuan një sëmundje të rëndë. "Kësaj gruaje (pianistes) i detyrohemi shumë", i shkruante kancelarit Fridrih Myler. Kurse Celterit, i thotë për mbresën e fortë që i la muzika e pianistes, për forcën e madhe që ushtroi muzika në shpirtin e tij.

***Në mesnatë*** – Krijuar në Jena më 13 shkurt 1818. Gëtja shkruante "Një gjendje të çuditshme shpirtërore në dritën madhështore të hënës më krijoi këngën "Në mesnatë". Kjo më është aq më e dashur dhe më e vyer, sepse s'mund të them se nga më erdhi...". Në bisedë me Ekermanin tha se "Kjo këngë mbetet e bukur, sa herë që ta dëgjosh, ka në melodi diçka të përjetshme, të qëndrueshme... Kënga "Në mesnatë" s'e ka humbur lidhjen me mua, përmban ende një pjesë të gjallë të qenies sime dhe jeton me muia..."

*Shpirti i gjithësisë* – Këtu ideja, ndryshe nga poezia e Gëtes me të njëjtin emër, s'ka lidhje me sistemin e filozofisë së natyrës së Shelingut.

***Sqarim i një gravure të vjetër në dru që paraqet misionin poetik të Hans Saksit.*** Në pranverën e vitit 1773 Gëtja u mor me Hasn Saksin. Në shfaqjet e karnavaleve të asaj kohe ndihet ndikimi i këpucarit dhe poeit nurembergas. Edhe te poezia e Gëtes ndihet ky ndikim, sidomos te "Urfausti". Dashuria dhe respekti i Gëtes për mjeshtrin e vjetër të këngëve shprehet në poezinë e madhe, të cilën e filloi në mars 1776 gjatë një udhëtimi për në Laipcig dhe e mbaroi në prill të po atij viti në Vajmar. Para ardhjes së Gëtes në Vajmar poetët dhe amatorët e letërsisë nuk e njihnin Hans Saksin. Gëtja e nxori në pah vlerën e tij.

***Gravurë në dru*** (ksilografi). Poezia nuk mbështetet në një ksilografi të vjetër. Gëtja e përdori fantazinë krijuese si një pikënisje për figurat e poezisë. Është karakterizuar edhe vrazhdësia edhe vërtetësia e poezive të Hans Saksit.

***Vdekja e Midingut*** – Gëtja, e çmonte fort zotësinë dhe karakterin e mjeshtrit zdrukthtar të teatrit të Vajmarit, Midingut. Kur Midingur vdiq më 27 janar 1782, bëri poezinë që ia kushtoi atij.

*Shtëpia e Talies* – Talie quhet njëra nga muzat e mitologjisë së lashtë. Në fillim ka qenë muza e poezisë gazmore fshatare, pastaj e komedisë, dhe ka mbetur si mbrojtëse e teatrit.

*Hauenshildi* – rrobaqepës i teatrit.

*Shumani* – piktor i teatrit.

*Tile* – rrobaqepës oborri për dama.

*Elkani* – bankieri i oborrit.

Hedh fjalën për një festë. Pjesa e parë e poezisë përshkruan përgatitjet për të festuar ditëlindjen e dukeshës Luiza. Pak kohë para kësaj feste vdiq Midingu.

***Epilog për "Kambanën" e Shilerit*** – Më 9 maj 1805 vdiq Shileri. Askush nuk guxoi t'ia jepte lajmin Gëtes që ishte i sëmurë. Të nesërmen në mëngjes Gëtja e kuptoi se ç'kishte ndodhur. Ai humbi të vetmin njeri, të cilin e dinte të barabartë me veten. Në ditaret e tij të vitit 1825

është shprehur dhimbja e tij e thellë. Më 1 qershor 1805, Gëtja, që ishte në shërim e sipër, i shkruante Cetlerit: "Kujtoja se do të vdisja vetë, e tani humba një mik dhe me të humbas gjysmën e qenies sime". Në të njëjtën letër është fjala për një festë përkujtimore. "Më duket e ngutshme, - shkruante Gëtja – e duhet ta festojmë në skenë kujtimin e të vdekurit. Për këtë s'mund të them asgjë tjetër, por do të doja vetëm t'ju pyesja në se do donit të më ndihmonit..." Qëllimi i Gëtes që të përfundonte "Demetriusin" e Shilerit, nuk u realizua. Me teatrin e Vajmarit, Gëtja përgatiti një shfaqje dramatike të "Këngës për kambanën". Në shfaqjen "Këngë për kambanën" u përfshi "Epilogu" i Gëtes, që e kishte bërë javët e mëparshme. Epilogu ishte njëkohësisht edhe një vajtim për të vdekurin edhe një festë e pavdekësisë së mikut. Gjatë shfaqjes "Epilogu" përfshiu dhjetë stanca. Po atë vit u botua.

*Çifti i ri princëror* – Princi trashëgimtar Karl Fridrih, pas martesës së tij me të motrën e carit Aleksandër I, Maria Pavlovna erdhi në Vajmar më 9 nëntor 1804. Më 12 nëntor 1804 u bë një festë për nder të tij dhe për të Shileri kishte hartuar "Admiruesi i arteve". Kjo shfaqje festive u dha po atë ditë.

***Për vuajtjet e të riut Verter*** – Romani i Gëtes, në botimin e tij të parë, ngjalli midis të rinjve të Gjermanisë dhe të botës së jashtme një interes dhe një ngashërim të pashembullt. Shpërtheu një Verter – ethe, e si pasojë, jo vetëm romanin si vepër letrare po edhe veshjen edhe mënyrën e jetesës së tij e imituan. Për të parandaluar pasojat e fundit të imitimit të Verterit, sidomos keqkuptimin e romanit si përligjie të vetvrasjes, Gëtja, në "botimin e dytë" i hoqi të dy strofat që ndodheshin përpara, njëra në pjesën e parë, tjetra në pjesën e dytë të romanit.

# *Pasqyra e lëndës*


Parathënie ..... 3
Amadisi i ri ..... 19
Hënës ..... 21
Pranverë e parakohshme ..... 23
Në liqen ..... 25
Shpëtimi ..... 26
Bunacë ..... 28
E dashura Terezë ..... 29
Nxënësi i argjendarit ..... 30
Kam dashur, po dua tani... ..... 32
Bashkëshortë të lumtur ..... 34
Takim dhe ndarje ..... 38
Belindës ..... 40
Këngë nëntori ..... 41
Lotes ..... 42
Lundrim në det ..... 44
Si, erdhe ti? ..... 46
Këngë nate e artistit ..... 47
Shpresa ..... 48
Këngë mëngjezi e shtegtarit ..... 49
Gëzime ..... 51
Sharlota Fon Shtajn ..... 52
Minjoni ..... 54
Felina ..... 57
Harpëtari ..... 59
Natë e bukur ..... 61
Këngë nate e gjahtarit ..... 62
Nevojë dashurie ..... 63
Orakulli i pranverës ..... 64

Elegji për vdekjen e vëllait të mikut tim ..... 66
Ergo Bibamus ..... 68
Festa e epifanisë ..... 70
Djali i pabesë ..... 72
Mbreti i pyllit ..... 74
Peshkatari ..... 76
Lulja më e bukur ..... 78
Kalorësi Kurt shkon të martohet ..... 82
Këngë dasme ..... 84
Gërmuesi i thesarit ..... 87
Gjahtari i minjve ..... 89
Tradhtia e mullinares ..... 91
Kambana që ecën ..... 94
Ekarti besnik ..... 96
Nata e parë e Valpurgës ..... 99
E fejuara prej Korintit ..... 103
Elegjitë romane ..... 111

NGA "ELEGJITË" ..... 127
Aleksi dhe Dora ..... 129
Eufrosina ..... 135
Nikias ..... 140

NGA "EPIGRAMET VENECIANE" ..... 143
Epigramet veneciane ..... 145
Elementet ..... 171
Pakufishmëri ..... 173
Pohim ..... 174
Kufizim ..... 175
Katër dhuratat ..... 176
Malli i lumtur ..... 177
Jehona ..... 178
Pamje malore ..... 179
Gëzim dhe dhimbje ..... 181
Timuri dhe dimri ..... 183
Nga erdha?... ..... 185
Dhe në një mijë forma ..... 186

Shah Behramguri ..... 188
Zulejka ..... 189
Ribashkimi ..... 191
Kënga e Muhametit ..... 193
I perëndishmi ..... 196
Ganimedi ..... 199
Në një flutur ..... 201
Johana Sebus ..... 202
Amori si piktor peizazhi ..... 204
Ankime mëngjesi ..... 207
Musagetat ..... 210
Varri i Anakreontit ..... 212
Qëndrim në ndryshim ..... 213
Udhëtim dimëror në Harc ..... 215
Karrocieri Kronos ..... 219
Kënga e udhëtarit në shtrëngatë ..... 221
Ilmenau ..... 226
Trilogjia e pasionit ..... 233
Në mesnatë ..... 239
Shpirti i gjithësisë ..... 240
Kënaqësi e vërtetë ..... 242
Shpjegim për një gravurë të vjetër në dru, që sqaron misionin poetik të .
Hans Saksit ..... 245
Vdekja e Midingut ..... 252
Epilog për "Kambanën" e Shilerit ..... 259
Vuajtjet e djaloshit Verter ..... 263
Shkatërrimi i Magdenburgut ..... 264
Tjerrësja ..... 266
Maj ..... 268
Këngë maji ..... 269
Ndjenjë njerëzore ..... 271
Djali me fyell ..... 272
Natë me hënë të plotë ..... 273
Çifuti shtegtar ..... 274
Shënime sqaruese ..... 283

CIP. Katalogimi në botim - B.K. Tiranë

Goethe,Johann Wolfgang von
Kënga e udhëtarit në shtrëngatë / Johann Wolfgang von Goethe ;
përkth. Perikli Jorgoni. - Tiranë : Toena, 2003
304f. ; 20 cm.
ISBN 99927 - 1 - 684 - 3

821.112.2 - 1

Formati: 61x86/16
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (355) (4) 358 539
Tiranë, 2003

304

821.112.2-1 GOE
18362-30

Mbi mermerin klasik të veprës monumentale të Gëtes poezitë janë lule të gjalla, të shumëngjyrshme dhe plot aromë. Ato kanë aromën dhe ngjyrat e jetës, se lindin nga ngjarje të jetuara dhe gjithmonë pasqyrojnë shqetësimet e mëdha të poetit, se në to ndihet fryma e kohës që i krijoi.

PERIKLI JORGONI

ISBN 99927 1 684 3
BOTIMET TOENA

500 lekë
4,00 €